



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.67

14 maj

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 126
datë 11.5.2009

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së garancisë ndërmjet
Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për
Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për garantimin e projektit të
privatizimit të OSSH sha-së”..... 3001

LIGJ
Nr.10 126, datë 11.5.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD) PËR GARANTIMIN E PROJEKTIT TË PRIVATIZIMIT TË OSSH SHA-SË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 84 pika 4 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për garantimin e projektit të privatizimit të OSSH sha-së”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.6167, datë 13.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

MARRËVESHJE GARANCIE
(PROJEKTI I PRIVATIZIMIT I OSSH-SË) MIDIS SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

MARRËVESHJE, e lidhur më datë [] maj 2009, midis SHQIPËRISË dhe BANKËS Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka").

Ndërsa, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e Shqipërisë ("METE") ka lidhur një kontratë për blerje të aksioneve ("Kontrata për Blerjen e Aksioneve") me shoqërinë "CEZ, a.s." ("Investuesi") përmes së cilës, ndër të tjera, METE ka rënë dakord të shesë aksione dhe Investuesi ka rënë dakord të blejë aksione dhe të nënshkruajë aksione të reja, në mënyrë që Investuesi të zotërojë gjithsej shtatëdhjetëgjashtë për qind (76%) të kapitalit aksionar të shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SHA" ("OSSH" ose "Shoqëria");

Ndërsa, Qeveria e Shqipërisë, përmes Ministrisë së Financave të Shqipërisë ("MF") dhe METE-s, ka lidhur një Marrëveshje të Mbështetjes Qeveritare (sipas përkufizimit që jepet më poshtë) me OSSH-në, përmes së cilës ka rënë dakord ta kompensojë Shoqërinë me një vlerë që nuk është më e madhe se gjashtëdhjetë milion euro (60.000.000 €) në rast të humbjes së të ardhurave nga shfrytëzimi që i lind Shoqërisë brenda Periudhës së Dorëzansë (sipas përkufizimit që jepet më poshtë) sipas një Ngjarjeje të Dorëzuar (sipas përkufizimit që jepet më poshtë);

Ndërsa, Banka Lëshuese e LK-së (sipas përkufizimit që jepet më poshtë) ka lëshuar ose do të lëshojë, me kërkesë dhe për llogari të MF-së, një letër-kredi të gatshme në favor të Shoqërisë ("LK-ja e Mbështetur nga BNRZH"), e cila do të caktojë disa të drejta të Shoqërisë për të bërë tërheqje brenda LK-së të Mbështetur nga BNRZH-ja deri në shumën gjithsej prej gjashtëdhjetë milion euro (60.000.000 €) me ndodhjen e Ngjarjes së Dorëzuar;

Ndërsa, me kërkesë dhe miratim të Shqipërisë, në përputhje me një marrëveshje të lidhur më këtë datë ose rreth kësaj date midis BNRZH-së dhe Bankës Lëshuese të LK-së ("Kontrata e Dorëzansë e BNRZH-së"), BNRZH ka rënë dakord të dorëzanojë ("Dorëzania e BNRZH-së") shlyerjen e vlerës së kapitalit të kredisë deri në gjashtëdhjetë milion euro (60.000.000 €) plus interesin e lindur ("Kredia e Mbështetur nga BNRZH", ndërsa vlera gjithsej që detyrohet në një pikë kohore BNRZH-ja në lidhje me Kredinë e Mbështetur nga BNRZH "Vlera e Kredisë e Dorëzuar nga BNRZH") të bërë nga Banka Lëshuese e LK-së si rezultat i një tërheqje të kryer nga Shoqëria rregullisht brenda LK-së të Mbështetur nga BNRZH sikurse parashikohet në LK-në e Mbështetur nga BNRZH dhe në rast se MF, në përputhje me Marrëveshjen e Rimbursimit dhe Kreditimit në fjalë, të lidhur më këtë datë ose rreth kësaj date midis MF-së dhe Bankës Lëshuese të LK-së ("Marrëveshja e Rimbursimit dhe Kreditimit"), nuk e kryen shlyerjen e Vlerës së Kredisë të Dorëzuar nga BNRZH brenda periudhës së shlyerjes që kërkon Marrëveshja e Rimbursimit dhe Kreditimit;

Ndërsa, në këmbim të lidhjes nga ana e Bankës të Kontratës së Dorëzansë së BNRZH-së që dorëzanton shlyerjen e kapitalit dhe të interesit të Kredisë së Mbështetur nga BNRZH, Shqipëria i ka ndërmarrë detyrimet që ka përpara Bankës dhe që parashikohen në këtë Marrëveshje;

Atëherë, palët e kësaj Marrëveshjeje bien dakord, përmes saj, si vijon:

Neni 1
Kushtet e Përgjithshme dhe Ndryshimi i Tyre

Rubrika 1.01. (a) Dispozitat e mëposhtme të "Kushteve të Përgjithshme për Kreditë të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim", të datës 1 korrik 2005 (me shtesat dhe ndryshimet e datës 12 shkurt 2008) (të quajtura në këtë dokument "Kushtet e Përgjithshme"), me ndryshimet e parashikuara në paragrafin (b) të kësaj Rubrike 1.01, përbëjnë pjesë të pandarë të kësaj Marrëveshjeje Kompensimi:

- (i) Neni I (Dispozita Hyrëse);
- (ii) Rubrika 3.06 (Kushtet e Kredisë, Vendi i Pagesës), Rubrika 3.07 (Kushtet e Kredisë, Monedha e Pagesës), Rubrika 3.09 (Kushtet e Kredisë, Vlerësimi i Monedhës) dhe Rubrika 3.10 (Kushtet e Kredisë, Mënyra e Pagesës);
- (iii) Rubrika 5.10 (Realizimi i Projektit, Bashkëpunimi dhe Konsultimi) dhe Rubrika 5.11(a) (Realizimi i Projektit, Vizitat);
- (iv) Rubrika 6.01 (Informacioni Financiar dhe Ekonomik) dhe Rubrika 6.02(a) dhe 6.02(c) (Barra Siguruese Negative) me ndryshimet e mëposhtme;
- (v) Rubrika 8.01 (Masat Shtrënguese), Rubrika 8.03 (Mosushtimi i të Drejtave) me ndryshimet e mëposhtme, dhe Rubrika 8.04 (Arbitrazhi);
- (vi) Rubrika 9.02 (Certifikatat ose Opinionet Juridike) me ndryshimet e mëposhtme; dhe
- (vii) Neni X (Dispozita të Ndryshme) me ndryshimet e mëposhtme.
- (b) Kushtet e Përgjithshme, nëse nuk e kërkon ndryshe konteksti, ndryshojnë si vijon:
 - (i) termat “Huamarrës”, “Palë e Kredisë”, “Palë të Kredisë” dhe “Vend Anëtar”, sa herë që përdoren në Kushtet e Përgjithshme, nënkuptojnë Shqipërinë;
 - (ii) termi “Datë e Hyrjes në Fuqi”, sa herë që përdoret në Kushtet e Përgjithshme, nënkupton datën e përcaktuar në Nenin VI të kësaj Marrëveshjeje Kompensimi;
 - (iii) termat “Kredi” dhe “Pagesa të Kredisë”, sa herë që përdoret në Kushtet e Përgjithshme, nënkuptojnë vlerat e pagueshme nga ana e Shqipërisë në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Kompensimi;
 - (iv) termat “Kontratë e Kredisë” dhe “Kontratë/Kontrata Ligjore”, sa herë që përdoret në Kushtet e Përgjithshme, nënkuptojnë këtë Marrëveshje Kompensimi;
 - (v) termi “Monedha e Kredisë”, sa herë që përdoret në Kushtet e Përgjithshme, do të thotë euro;
 - (vi) termi “Projekt”, sa herë që përdoret në Kushtet e Përgjithshme, nënkupton të gjitha veprimet e ndërmarra ose që lipset të ndërmerren për zbatim, nga Shoqëria dhe Palët Qeveritare përkatëse, të të drejtave dhe detyrimeve të tyre përkatëse, në përputhje dhe sipas parashikimeve të Kontratës së Blerjes së Aksioneve;
 - (vii) Rubrika 6.02 (a) ndryshon dhe ka përmbajtjen e mëposhtme: “(a) E kërkon politika e Bankës që, kur u jep kredi ose kur jep dorëzani për kredi që u jepen anëtarëve të saj, të mos kërkojë, në kushte normale, garanci të posaçme nga anëtarë në fjalë por të sigurohet që asnjë borxh tjetër i jashtëm të mos ketë përparësi në krahasim me kreditë e saja dhe me shumat që duhet t’ia paguajë Bankës anëtarë në fjalë si pasojë e dorëzaneve të tilla, në kuadër të caktimit, realizimit apo shpërndarjes së monedhës së huaj që është nën kontrollin apo mbahet për llogari të këtij anëtarë. Për këtë qëllim, nëse vendoset ndonjë Barrë mbi ndonjë Aktiv Publik në formën e garancisë për një borxh të jashtëm, e cila do të çojë ose mund të çojë në vendosjen e përparësisë për llogari të kreditorit të borxhit të jashtëm në fjalë në caktimin, realizimin apo shpërndarjen e monedhës së huaj, kjo Barrë, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, garanton njësoj shumat e pagueshme nga Shqipëria në bazë të kësaj Marrëveshjeje Kompensimi, që, në kuptimin e kësaj Rubrike vetëm, konsiderohet se është e barabartë me Vlerën e Kredisë së Dorëzuar nga BNRZH, ndërsa Shqipëria, gjatë vendosjes ose lejimit të vendosjes së një Barre të tillë, bën parashikimin e përcaktuar shprehimisht për këtë qëllim; Megjithatë, e gjitha kjo me kusht që, nëse për një arsye kushtetuese apo arsye tjetër juridike, një parashikim i tillë nuk mund të bëhet në lidhje me Barrën e vendosur mbi aktivet e asnjërës prej nënndarjeve të veta politike apo administrative, Shqipëria i garanton, menjëherë dhe pa i shkaktuar kosto Bankës, shumat e pagueshme nga Vendi në bazë të kësaj Marrëveshjeje Kompensimi përmes një Barre të barasvlershme të vendosur mbi Aktive Publike të tjera të pranueshme për Bankën.”
 - (viii) Rubrika 9.02 ndryshon dhe ka përmbajtjen e mëposhtme: “Shqipëria i paraqet Bankës një opinion ose disa opinione të pranueshme për Bankën, në lidhje me këshilla të pranueshme për Bankën ose, nëse ia kërkon Banka, një vërtetim të pranueshëm për Bankën të një zyrtari kompetent të Shqipërisë që tregon (A) që kjo Marrëveshje Kompensimi është autorizuar ose ratifikuar

rregullisht nga Shqipëria, është përmbuar dhe realizuar në emër të Shqipërisë dhe ka fuqi detyruese ligjore mbi Shqipërinë në përputhje me kushtet e saj.”

(ix) Rubrika 10.01 ndryshon, duke hequr, në fillim të fjalisë së dytë, fjalët “Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Rubrikën 9.03(a)”.

Rubrika 1.02. Me përjashtim të rasteve kur kushtet e kërkojnë ndryshe,

a) termat e ndryshme të përkufizuar në Kushtet e Përgjithshme dhe në Hyrjen e kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet përkatëse të përcaktuar atje;

b) të gjithë termat që fillojnë me shkronja të mëdha të përdorur në këtë Marrëveshjeje dhe që përdoren edhe në Marrëveshjet e Privatizimit apo në Dokumentet e Transaksionit (sipas përkufizimit të secilit prej tyre më poshtë) kanë kuptimet që u jepen në atë dokument; dhe

c) këto terma të tjerë të mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

(i) “Njoftim-Kërkesë” është kërkesa që i paraqitet Bankës nga Banka Lëshuese e LK-së në përputhje me Nenin 5 të Kontratës së Dorëzisë së BNRZH-së dhe me përmbajtje që përputhet me formën e Lidhjes 2 të asaj Kontrate;

(ii) “ERE” është Enti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë, që është i organizuar dhe funksionon në përputhje me ligjet e Shqipërisë;

(iii) “Qeveria e Shqipërisë” ose “QSH” është autoriteti qeverisës i Shqipërisë (përfshirë edhe ERE, METE dhe MF) dhe çdo autoritet, agjenci apo ent tjetër që, në bazë të ligjeve të Shqipërisë konsiderohet se është pjesë e qeverisë;

(iv) “Palë Qeveritare” do të thotë ERE, METE dhe MF, ndërsa “Palë Qeveritare” është çdonjëra prej tyre, siç ta kërkojë konteksti;

(v) “Marrëveshja e Mbështetjes Qeveritare” është Marrëveshja e Mbështetjes Qeveritare që lidhet prej dhe midis Qeverisë së Shqipërisë, përmes METE-s dhe MF-së, dhe Shoqërisë dhe e cila i bashkëlidhet kësaj Marrëveshjeje, vetëm për qëllime informimi, si Lidhja 1;

(vi) “Ngjarja e Dorëzuar” ka kuptimin që i është caktuar në Marrëveshjen e Mbështetjes Qeveritare;

(vii) “Periudha e Dorëzisë” është periudha që fillon më Datën e Mbylljes (sipas përkufizimit në Marrëveshjen e Mbështetjes Qeveritare) dhe që përfundon më 31 dhjetor 2016;

(viii) “Marrëveshjet e BNRZH-së” janë Kontrata e Dorëzisë së BNRZH-së, LK-ja e Mbështetur nga BNRZH, Marrëveshja e Riimbursimit dhe Kreditimit, Marrëveshja e Projektit dhe kjo Marrëveshje, me gjithë ndryshimet dhe shtesat që mund t’u bëhen herë pas here;

(ix) “Tarifa e Dorëzisë e BNRZH-së” është tarifa e dorëzisë e pagueshme Bankës nga Shoqëria në përputhje me Marrëveshjen e Projektit;

(x) “Banka Lëshuese e LK-së” është banka “Citibank Europe PLC”, Dega Hungareze ose çdo pasues apo zëvendësues, siç të bihet dakord herë pas here;

(xi) “Shuma Maksimale e Dorëzuar e Kapitalit” është gjashtëdhjetë milion euro (€60.000.000);

(xii) “Marrëveshjet e Privatizimit” janë Marrëveshja e Mbështetjes Qeveritare dhe Kontrata e Blerjes së Aksioneve;

(xiii) “Veprimtari të Ndaluara” janë Praktikant Korruptive, Praktikant Mashtruese, Praktikant Konspirative, Praktikant Kanosëse apo Praktikant Penguese të lidhura në çfarëdo mënyre me Projektin, sipas përkufizimeve të secilit prej këtyre termave, të parashikuar në Aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje;

(xiv) “Marrëveshja e Projektit” është Marrëveshja e Projektit midis Shoqërisë dhe BNRZH-së lidhur më këtë datë ose rreth kësaj date; dhe

(xv) “Dokumentet e Transaksionit” janë Marrëveshjet e Privatizimit dhe Marrëveshjet e BNRZH-së, ndërsa “Dokumenti i Transaksionit” është çdonjëri prej tyre.

Neni 2
Kompensimi që i bën Shqipëria Bankës

Rubrika 2.01. Në këmbim të dhënies së Dorëzanisë së BNRZH-së nga Banka, me termat dhe kushtet e parashikuar në Kontratën e Dorëzanisë së BNRZH-së, përmes kësaj Marrëveshjeje Shqipëria bie dakord në mënyrë të pakthyeshme dhe pa kushte:

(a) ta riimburojë Bankën menjëherë, me marrjen e një kërkesë me shkrim apo përmes një udhëzimi tjetër me shkrim nga Banka, për çdo shumë që ka paguar Banka në bazë të Kontratës së Dorëzanisë së BNRZH-së, në euro, plus interesin mbi shumën në fjalë sipas përqindjes vjetore të përcaktuar nga Banka (përqindje e cila nuk e kalon normën mbizotëruese të interesit të huadhënies të Bankës për Kredi me Marzh të Ndryshueshëm të emëruar në euro, në bazë të shpalljeve në hapësirën në internet të Bankës) duke filluar nga data kur është bërë kjo pagesë nga Banka dhe deri në datën kur kjo shumë paguhet tërësisht;

(b) ta kompensojë Bankën, me marrjen e kërkesës së saj, në lidhje me të gjitha veprimet, procedurat, detyrimet, kërkesat, humbjet, dëmet, kostot dhe shpenzimet që i lindin Bankës, drejtpërdrejt apo tërthorazi, në lidhje me Kontratën e Dorëzanisë së BNRZH-së (nëse nuk parashikohet ndryshe në Rubrikën 8.04(i) të Kushteve të Përgjithshme);

(c) që (i) Banka ka lejen të përmbushë çdo Njoftim-Kërkesë që i paraqitet Bankës në bazë të Kontratës së Dorëzanisë së BNRZH-së dhe të bëjë çdo pagesë që mund t'i kërkohej Bankës të paguajë në bazë të Kontratës së Dorëzanisë së BNRZH-së (Banka e njofton menjëherë Shqipërinë për çdo kërkesë të tillë, mirëpo moskryerja e një njoftimi të tillë nuk e prek në asnjë mënyrë detyrimin e Bankës për kryerjen e pagesës në bazë të Kontratës së Dorëzanisë së BNRZH-së apo detyrimin e Shqipërisë për ta riimbursuar ose kompensuar Bankën në përputhje me këtë Kontratë); dhe (ii) mos t'i kërkojë Bankës të verifikojë nëse paraqitjet e bëra në një Njoftim-Kërkesë të tillë janë në të vërtetë të sakta apo jo; dhe

(d) që çdo Njoftim-Kërkesë që i paraqitet Bankës në përputhje me Kontratën e Dorëzanisë së Bankës quhet, në kuadër të marrëdhënies midis Shqipërisë dhe Bankës, provë përmbyllëse që kërkesa është bërë rregullisht dhe pagesa është e pagueshme rregullisht. Pas njoftimit që i bëhet Shqipërisë në lidhje me marrjen nga ana e Bankës e një Njoftim-Kërkesë, Shqipëria mund të hetojë vlefshmërinë e paraqitjeve në Njoftim-Kërkesën në fjalë dhe të marrë masat që konsideron të nevojshme Shqipëria kundrejt Shoqërisë apo Bankës Lëshuese të LK-së në lidhje me to, të gjitha këto pa zhvlerësuar detyrimet e Bankës në kuadër të Kontratës së Dorëzanisë së BNRZH-së për të kryer pagesat në lidhje Njoftim-Kërkesën në fjalë dhe as detyrimet e Shqipërisë në kuadër të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me pagesën në fjalë që bën Banka. Detyrimet e Shqipërisë që parashikohen në këtë Marrëveshje zbatohen edhe nëse Shqipëria apo një Palë Qeveritare ka kundërshtim për vlefshmërinë e një Njoftim-Kërkesë të tillë apo për saktësinë e dokumentacionit, fakteve apo shifrave të shprehura në Njoftim-Kërkesë apo mbi të cilat mbështetet Njoftim-Kërkesa.

Rubrika 2.02. (a) Detyrimet e Shqipërisë në kuadër të kësaj Marrëveshjeje janë të pakthyeshme, absolute dhe të pakushtëzuara, pavarësisht vlerës, origjinalitetit, vlefshmërisë, rregullsisë apo zbatueshmërisë së detyrimeve të MF-së në kuadër të Marrëveshjes së Riimbursimit dhe Kreditimit apo të detyrimeve të Shqipërisë ose të një Pale të Qeverisë në kuadër të Dokumenteve të Transaksionit. Detyrimet e Shqipërisë në kuadër të kësaj Marrëveshjeje përmbushen vetëm përmes realizimit të detyrimeve dhe vetëm me shkallën e këtij realizimi. Këto detyrime nuk i nënshtrohen një njoftimi paraprak, kërkesë apo veprimi kundrejt një Shoqërie, Bankës Lëshuese të LK-së ose një personi tjetër, apo një njoftimi paraprak ose kërkesë kundrejt Shqipërisë në lidhje me mosveprim nga ana e Shqipërisë apo një Pale të Qeverisë për të paguar një shumë për të cilën Bankës i është paraqitur një Njoftim-Kërkesë në përputhje me Kontratën e Dorëzanisë së BNRZH-së. Këto detyrime nuk zhvlerësohen nga asnjëra prej pikave të mëposhtmeve: (i) një zgjatje e periudhës, mos ushtrim i të drejtave, lëshim ose privilegj i dhënë Bankës, Shoqërisë, Bankës Lëshuese të LK-së apo një personi tjetër; (ii) ndryshim i Kontratës së Dorëzanisë së BNRZH-së, LK-së të Mbështetur nga BNRZH, Marrëveshjes së Riimbursimit dhe Kreditimit,

Dokumenteve të Transaksionit apo ndonjë marrëveshjeje tjetër të lidhur me këto; (iii) kërkimi, mosveprimi për të kërkuar apo vonimi në kërkimin, nga ana e palëve të një Dokumenti Transaksioni, e një të drejte, tagri apo rruge ligjore kundër Shqipërisë, Shoqërisë apo ndonjë personi tjetër apo në lidhje me ndonjë garanci për Shumën e Kredisë të Dorëzuar nga BNRZH (ose të një pjese të saj apo të interesave mbi të); ose (iv) çdo rrethanë tjetër që do të përbënte ose mund të përbënte (po të mos ishte kjo dispozitë) një çlirim, shlyerje, mbrojtje apo heqje dorë nga të drejtat për Shqipërinë.

(b) Në çdo kohë, Banka mundet që, pa i shlyer, dëmtuar apo prekur në çdo rrugë tjetër asnjë të drejtë, tagër apo rrugë ligjore të krijuar përmes kësaj Marrëveshjeje apo që ia jep kjo Marrëveshje, Dokumentet e tjera të Transaksionit, ndonjë marrëveshje tjetër e lidhur me to apo nga ligji: (i) të ofrojë ose të bjerë dakord ose të lidhë marrëveshje për zgjatjen ose ndryshimin e Kontratës së Dorëzisë së BNRZH-së, Dokumenteve të tjera të Transaksionit ose ndonjë marrëveshjeje tjetër të lidhur (me përjashtim të atyre që do t'i rrisnin në mënyrë materiale detyrimet e Shqipërisë në kuadër të kësaj Marrëveshjeje ose të ndonjë Dokumenti tjetër të Transaksionit ose marrëveshjeje të lidhur me to); dhe (ii) të ofrojë, të japë apo të bjerë dakord të japë kohë apo ndonjë privilegj tjetër një personi ose subjekti tjetër nga të cilët të mund të kërkojë riimbursim (me ligj ose ndryshe) në lidhje me shumat që paguan Banka apo detyrimet që i lindin Bankës në kuadër të Kontratës së Dorëzisë së BNRZH-së.

(c) Të drejtat që i jep Bankës kjo Marrëveshje u shtohen dhe nuk i zëvendësojnë apo anulojnë të drejtat e tjera sipas të cilave Banka mund t'i kërkojë në çdo kohë Shqipërisë, Shoqërisë apo një personi apo subjekti tjetër riimbursim ose kompensim kundrejt pagesave të bëra apo detyrimeve të lindura nga Kontrata e Dorëzisë së BNRZH-së ose në lidhje me Kontratën e Dorëzisë së BNRZH-së.

(d) Banka nuk është e detyruar përpara ose pas marrjes së hapave për të realizuar të drejtat që ia jep kjo Marrëveshje ose përpara ose pas ushtrimit të ndonjërës prej të drejtave, tagrave dhe rrugëve ligjore që ia jep Bankës kjo Marrëveshje, Kontrata e Dorëzisë së BNRZH-së, Marrëveshja e Projektit, LK-ja e Mbështetur nga BNRZH, Marrëveshja e Riimbursimit, Dokumenti i Transaksionit, çdo marrëveshje tjetër e lidhur ose ligji: (i) të veprojë apo të marrë një gjykim ose vendim në një gjykatë apo gjykatë kompetente kundrejt çdo personi tjetër (përfshirë këtu edhe personat prej të cilëve të mund të kërkojë riimbursim në lidhje me shumat e paguara apo detyrimet e lindura në përputhje me Kontratën e Dorëzisë së BNRZH-së); apo (ii) të marrë masa shtrënguese apo të kërkojë marrjen e masave shtrënguese për zbatimin e të drejtave të tjera që mund të ketë kundrejt Shqipërisë apo të drejtave të veta kundrejt garancisë që ia kanë dhënë Bankës personat e tjerë.

Rubrika 2.03. Çdo pagesë që duhet të bëjë Shqipëria në përputhje me termat e kësaj Marrëveshjeje në fillim vlen për të paguar të gjithë interesin dhe çdo tarifë tjetër kundrejt Bankës dhe pastaj, pasi të jetë paguar ky interes dhe tarifa të tjera, të paguajë të gjitha shumat e tjera që i detyrohet Bankës në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Premtimet e Lidhura me Projektin

Rubrika 3.01. Pa kufizuar asnjërin prej detyrimeve të tjera të veta në bazë të kësaj Marrëveshjeje, përmes kësaj Marrëveshjeje Shqipëria merr përsipër përpara Bankës të realizojë në kohë të gjitha detyrimet e veta në kuadër të Kontratës së Mbështetjes nga Qeveria dhe Marrëveshjeve të tjera të Privatizimit dhe Marrëveshjes së Riimbursimit dhe Kreditimit dhe të marrë masat që çdo Palë Qeveritare të realizojë në kohë të gjitha detyrimet e veta në kuadër të Marrëveshjeve përkatëse të Privatizimit apo të Dokumenteve të tjera të Transaksionit në të cilat janë palë.

Rubrika 3.02. Shqipëria nuk ndërmerr vetë dhe nuk lejon marrjen nga Palët Qeveritare e asnjë veprimi që do të pengonte apo ndërhynte në realizimin nga Pala Qeveritare përkatëse e detyrimeve në kuadër të Dokumenteve të Transaksionit. Shqipëria e njofton, dhe merr masat që secila prej Palëve Qeveritare të njoftojnë, Bankën përpara miratimit të çdo amendamenti, heqje dorë nga të drejtat, zgjidhje kontrate apo ndryshimeve të tjera dhe merr pëlqimin me shkrim nga Banka përpara miratimit të çdo amendamenti, heqje dorë nga të drejtat, zgjidhje kontrate apo ndryshimi tjetër të Dokumenteve të Transaksionit në të cilat është palë një Palë e Qeverisë, që, sipas mendimit të Bankës, mund t'i prekë ose do t'i prekte në mënyrë materiale të drejtat dhe detyrimet e Bankës (në bazë të Marrëveshjeve të BNRZH-së apo të Dokumenteve të tjera të Transaksionit), përfshirë këtu, pa kufizim, caktimin, kalimin, zëvendësimin me lidhje kontrate të re, shfuqizimin, dhënien e garancisë apo të parashikimeve të tjera për të drejtat ose detyrimet në kuadër të këtyre marrëveshjeve.

Rubrika 3.03. Shqipëria vepron vetë dhe merr masat që Palët Qeveritare të veprojnë menjëherë (i) për të njoftuar dhe për t'i dhënë Bankës kopje të njoftimeve, kërkit të të drejtave, kërkesave, riimbursimeve apo rimarrjeve në kuadër të Marrëveshjes së Mbështetjes Qeveritare, apo të kërkesave në kuadër të Marrëveshjes së Riimbursimit dhe Kreditimit që lidhen me veprimet për të vënë me forcë në zbatim Vlerën e Kredisë së Dorëzuar nga BNRZH, apo të çdo njoftimi tjetër që jep ose merr një Palë Qeveritare në kuadër të Marrëveshjeve të Privatizimit; dhe (ii) për ta njoftuar Bankën për çdo shkelje ose pretendim shkeljeje të një kompensimi të bërë nga një Palë Qeveritare në kuadër të Marrëveshjes së Mbështetjes Qeveritare apo për çdo ngjarje ose rrethanë që do të çonte apo mund të çonte në një shkelje të tillë, për çdo njoftim zgjidhjeje apo njoftim synimi për ta zgjidhur Marrëveshjen e Mbështetjes Qeveritare, ose çdo ngjarje apo rrethanë që do ta prekte ose mund ta prekte negativisht aftësinë e Shqipërisë për t'i realizuar detyrimet apo për t'i ushtruar të drejtat e veta në kuadër të Marrëveshjeve të Privatizimit apo Marrëveshjes së Riimbursimit dhe Kreditimit ose aftësinë e një Pale Qeveritare për t'i realizuar detyrimet apo për t'i ushtruar të drejtat e veta në kuadër të Marrëveshjeve të Privatizimit apo të Marrëveshjes së Riimbursimit dhe Kreditimit.

Rubrika 3.04. Shqipëria ndërmerr të gjitha veprimet brenda tagrit të vet për të ndrequr secilën prej ngjarjeve të përmendura në Rubrikën 3.03 që do të sillte ose mund të sillte shkeljen ose zgjidhjen e Marrëveshjes së Mbështetjes Qeveritare, Marrëveshjes së Riimbursimit dhe Kreditimit apo të Dokumenteve të tjera të Transaksionit.

Rubrika 3.05. Shqipëria nuk krijon dhe as lejon të ekzistojë apo të ndodhë asnjë rrethanë apo ndryshim në ligjet e Shqipërisë që do t'i bënte detyrimet në kuadër të Marrëveshjeve të Privatizimit apo të Marrëveshjes së Riimbursimit dhe Kreditimit të paligjshme, të pavlefshme, të pazbatueshme ose me vlerë apo fuqi të hequr tërësisht ose pjesërisht. Shqipëria kujdeset që Palët Qeveritare të mos krijojnë apo të mos lejojnë të ekzistojë apo të ndodhë asnjë rrethanë apo ndryshim në ligjet e Shqipërisë që do t'i bënte detyrimet në kuadër të Marrëveshjeve të Privatizimit apo të Marrëveshjes së Riimbursimit dhe Kreditimit të paligjshme, të pavlefshme, të pazbatueshme ose me vlerë apo fuqi të hequr tërësisht ose pjesërisht. Nëse ekzistojnë ose ndodhin rrethana apo ndryshime të tilla në ligjet e Shqipërisë, Shqipëria ndërmerr të gjitha veprimet brenda tagrit të vet për të ndrequr pasojën e padëshirueshme që kanë mbi Projektin këto rrethana ose ndryshime në ligjet e Shqipërisë. Shqipëria kujdeset që Palët e duhura Qeveritare të ndreqin pasojën e padëshirueshme që kanë mbi Projektin këto rrethana ose ndryshime në ligjet e Shqipërisë.

Rubrika 3.06. Shqipëria:

(a) ndërmerr të gjitha masat që janë të nevojshme nga ana e saj apo nga ana e një Pale Qeveritare për t'i dhënë mundësi Shoqërisë t'i realizojë të gjitha detyrimet e veta në kuadër të Marrëveshjes së Projektit dhe Dokumenteve të Transaksionit; dhe

(b) nuk ndërmerr asnjë veprim dhe nuk bën apo lejon që asnjë Palë Qeveritare të ndërmarrë një veprim që do të pengonte ose ndërhynte në realizimin nga Shoqëria të detyrimeve në fjalë.

Rubrika 3.07. Shqipëria: (i) i konfirmon Bankës se asnjë zyrtar ose përfaqësues i Qeverisë apo një Pale Qeveritare nuk është përfshirë në Veprimtari të Ndaluar; (ii) premton se nuk do të

angazhohet në Veprimtari të Ndaluara; dhe (iii) deklarohet angazhimin e vet për të vënë në zbatim ligjet e Shqipërisë kundër Veprimtarive të Ndaluara gjatë realizimit të çdo kontrate ose veprimtarie të lidhur me Projektin dhe në lidhje me realizimin e çdo kontrate ose veprimtarie të lidhur me Projektin.

Rubrika 3.08. Pa cenuar Rubrikat 5.10 (Bashkëpunimi dhe Konsultimi) dhe 6.01 (Informacioni Financiar dhe Ekonomik) të Kushteve të Përgjithshme, Shqipëria i jep Bankës menjëherë me kërkesën e kësaj të fundit të gjithë informacionin e nevojshëm, sipas mendimit të arsyeshëm të Bankës, në mënyrë që Banka të shqyrtojë përmbushjen nga Shqipëria të premtimeve të veta në përputhje me Rubrikat 3.06 dhe 3.07, më lart, dhe për të bërë një shqyrtim të mekanizmave dhe treguesve përkatës.

Rubrika 3.09. Jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga Data e Mbylljes, Shqipëria i paguan shoqërisë KESH një shumë që nuk është më pak se tridhjetë milion euro (30.000.000 €) dhe merr masat që KESH ta përdorë këtë shumë për të shlyer detyrimet e borxhit afatshkurtër të shoqërisë KESH (që mund të jenë kredi, linja kreditimi, financim përmes llogarive të zbuluara ose pasive të tjera financiare të tilla për të cilat KESH mund t'u detyrohet bankave të nivelit të dytë me datë maturimi më pak se dy vjet).

Rubrika 3.10 Përmes kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria i jep Bankës të drejtën për të monitoruar, shqyrtuar dhe dhënë komente për Deklaratën Rregullatore të propozuar në lidhje me tarifat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe Furnizuesit Publik të Shitjes me Pakicë të zbatueshme për periudhën rregullatore pas datës 31 dhjetor 2014 ("Deklarata Rregullatore e Ardhsme"), siç përshkruhet në rubrikën 1.4 të Deklaratës Rregullatore të miratuar nga ERE më 3 mars 2009, dhe bie dakord që marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që Banka të ketë mundësi t'i ushtrojë të drejtat e parashikuara këtu.

Neni 4

Rrugë Ligjore që mund të Ndjekë Banka

Rubrika 4.01. Në rast se: (i) Shqipëria nuk bën pagesat ose kompensimet për Bankën në përputhje me Rubrikën 2.01 të kësaj Marrëveshjeje; (ii) Shqipëria nuk përmbush realizimin e ndonjërit prej detyrimeve që ia ngarkon kjo Marrëveshje dhe një mospërmbushje e tillë vijon dhe mbetet e pandrequr sipas mendimit të Bankës për gjashtëdhjetë (60) ditë apo më shumë pas njoftimit që Banka ia jep Shqipërisë në lidhje me këtë mospërmbushje; ose (iii) deklaratimet e bëra nga Shqipëria në këtë Marrëveshje apo në bazë të kësaj Marrëveshjeje, ose deklarata e paraqitur në lidhje me këtë Marrëveshje që parashikohet të përbëjë bazën mbi të cilën të mbështetet Banka për dhënien e Dorëzansisë së BNRZH-së, sipas mendimit të Bankës janë të pasakta në aspektet me rëndësi materiale, Banka ka të drejtë, krahas të drejtave dhe masave ligjore të tjera që mund të ketë, të pezullojë apo anulojë tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Shqipërisë për të kryer tërheqje në kuadër të çdo kredie ose dorëzanie midis Bankës dhe Shqipërisë ose në kuadër të çdo kontrate kredie për zhvillim ose kontrate financimi të lidhur midis Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Shqipërisë, ose ta deklarojë kapitalin dhe interesat e çdo kredie ose huaje të tillë të pagueshëm me efekt të menjëhershëm.

Neni 5

Data e Hyrjes në Fuqi

Rubrika 5.01. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe fillon të ketë pasoja më datën e ratifikimit të saj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 6
Mëvetësia

Rubrika 6.01. Marrëveshja e Mbështetjes Qeveritare, e cila bashkëlidhet në Lidhjen 1 të kësaj Marrëveshjeje, është përfshirë vetëm me qëllim informimi dhe nuk përbën pjesë të pashkëputur të kësaj Marrëveshjeje. Nëse një gjykatë apo një gjykatë kompetente konstaton ose nëse ligji i zbatueshëm e deklaron Marrëveshjen e Mbështetjes Qeveritare si të pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk e prek në asnjë mënyrë vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje. Shtesat dhe ndryshimet në Marrëveshjen e Mbështetjes Qeveritare kanë pasoja juridike në përputhje me termat e saj.

Neni 7
Dispozita të Ndryshme

Rubrika 7.01. Me anë të kësaj Marrëveshjeje, caktohet Ministri i Financave i Shqipërisë si përfaqësues i Shqipërisë për qëllimet e Rubrikës 10.02 të Kushteve të Përgjithshme.

Rubrika 7.02. Caktohen adresat e mëposhtme për qëllimet e Rubrikës 10.01 (Njoftimet dhe Kërkesat) të Kushteve të Përgjithshme:

Për Shqipërinë:

Ministria e Financave

[] [LUTEMI PLOTËSONI INFOMACIONIN QË MUNGON]

Faksimile: [] [LUTEMI PLOTËSONI INFOMACIONIN QË MUNGON]

Për Bankën:

World Bank
1818 H Street, N.W.
Uashington, D. K. 20433
United States of America

Faksimile: (202) 522-2758

Në prani të tyre, palët e kësaj Marrëveshjeje, përmes përfaqësuesve të autorizuar rregullisht prej tyre, nënshkruajnë këtë Marrëveshje me emrat e tyre përkatës në [], më ditën dhe vitin e shkruar më lart.

SHQIPËRIA

Nga _____
Përfaqësuesi i Autorizuar

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga _____
Përfaqësuesi i Autorizuar

ANEKSI 1
UDHËZIM ANTIKORRUPSION PËR
TRANSAKSIONET E DORËZANUARA NGA BANKA BOTËRORE

Qëllimi i këtij Udhëzimi është sqarimi i kuptimit të termave “Praktika Korruptive”, “Praktika Mashtruese”, “Praktika Kanosëse”, “Praktika Konspiracioni” dhe “Praktika Penguese” në kushtet e operacioneve të Dorëzaneve (Dorëzani me Rrezik të Pjesshëm—DRRP) të Bankës Botërore, KNF-së dhe MIGA-s.

1. Praktika Korruptive

“Praktika Korruptive” është ofrimi, dhënia, marrja ose kërkimi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, i çdo gjëje me vlerë, për të ndikuar në mënyrë të parregullt në veprimet e një pale tjetër.

Interpretimi

A. Praktikave Korruptive kuptohen si ryshfeti apo pagesat e paligjshme. Veprimi në fjalë duhet medoemos të përfshijë përdorimin e mjeteve të parregullta (siç është ryshfeti) për të shkelur apo devijuar nga një detyrë që duhet të kryejë marrësi në mënyrë që paguesi të përfitojë një avantazh që nuk i takon ose të evitojë një detyrim. Antitrusti, letrat me vlerë dhe shkeljet e tjera të ligjit që nuk janë të kësaj natyre përjashtohen nga përkufizimi i praktikave korruptive.

B. Pranohet se kontratat e investimeve të huaja, kontratat e koncesioneve dhe llojet e tjera të kontratave, zakonisht, u kërkojnë investitorëve të japin kontribute në mirëbesim për qëllime të zhvillimit shoqëror apo të japin fonde për infrastruktura që nuk lidhen me projektin. Po kështu, shpesh, investitorëve u kërkohet ose pritët prej tyre të japin kontribute në mirëbesim për subjekte bamirësie në vend. Këto praktika nuk shihen si Praktika Korruptive për qëllimin e këtyre përkufizimeve, për sa kohë lejohen nga ligji i vendit dhe deklarohen tërësisht në regjistrat dhe të dhënat kontabël të paguesit. Po kështu, një investitori nuk i kërkohet llogari për praktika korruptive ose mashtruese të kryera nga subjektet që administrojnë fondet e dhëna në mirëbesim për zhvillim shoqëror apo kontributet e dhëna në mirëbesim për bamirësi.

C. Në kushtet e veprimit midis privatëve, ofrimi, dhënia, marrja ose kërkimi i shërbimeve të pritjes dhe i dhuratave që janë të zakonshme në bazë të standardeve të pranuar botërisht të sektorit përkatës të ekonomisë nuk përbën Praktika Korruptive nëse veprimi në fjalë nuk shkel ligjin e zbatueshëm.

D. Pagesa e bërë nga persona të sektorit privat, për shpenzime të arsyeshme udhëtimi dhe argëtimi të zyrtarëve publikë, që përputhen me praktikën ekzistuese sipas ligjit përkatës dhe konventave ndërkombëtare nuk konsiderohen si Praktika Korruptive.

E. Grupi i Bankës Botërore nuk i lejon pagesat e lehtësimit. Për qëllimet e vënies në zbatim, interpretimi i “Praktikave Korruptive” në lidhje me pagesat e lehtësimit do të marrë në konsideratë ligjin përkatës dhe konventat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me korrupsionin.

2. Praktikave Mashtruese

“Praktika Mashtruese” është çdo veprim ose mosveprim, përfshirë keqparaqitjen, që me dije ose me pakujdesi keqinformon ose orvatet të keqinformojë një palë për përfitime financiare ose për të evituar një detyrim.

Interpretimi

A. Një veprim, mosveprim ose keqparaqitje do të konsiderohet se bëhet në pakujdesi nëse bëhet me indiferencë të pakujdesshme për faktin nëse është e vërtetë ose e rreme. Thjesht pasaktësia e një informacioni të tillë, e shkaktuar përmes neglizhencës së thjeshtë, nuk mjafton për të përbërë “Praktikë Mashtruese”, për qëllimet e sanksioneve ose rrugëve ligjore të Grupit të Bankës Botërore.

B. Praktikave mashtruese synojnë të mbulojnë veprimet ose mosveprimet që i drejtohen ose atakojnë një subjekt të Grupit të Bankës Botërore. Këtu mbulohen edhe Praktikave Mashtruese që i

drejtohen ose atakojnë një vend anëtar të Grupit të Bankës Botërore në lidhje me dhënien ose vënien në zbatim të një kontrate qeveritare ose kontrate koncesioni në një projekt të financuar nga Grupi i Bankës Botërore. Mashtrimet ndaj të tretëve nuk janë të lejuara, mirëpo nuk janë të sanksionuara konkretisht në operacionet e KFN-së, MIGA-s ose Dorëzanive me Rrezik të Pjesshëm. Në mënyrë të ngjashme, nuk janë të lejuara sjelljet e tjera të paligjshme, mirëpo këto nuk janë të sanksionuara si Praktikë Mashtruese në kuadër të operacioneve të Grupit të Bankës Botërore.

3. Praktikë Kanosëse

“Praktikë Kanosëse” janë dëmtimi ose lëndimi, ose kërcënimi për të dëmtuar ose lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një palë ose pronat e një pale për të ndikuar në mënyrë të parregullt veprimet e një pale.

Interpretimi

A. Praktikë Kanosëse janë veprime të kryera me qëllim manipulimin e tenderëve ose në lidhje me prokurimet publike apo kontratat shtetërore apo në rëndim të një Praktike Konspiracioni ose të një Praktike Mashtrimi.

B. Praktikë Kanosëse janë kërcënimi ose realizimi i veprimeve të paligjshme si për shembull lëndimi ose rrëmbimi i personit, dëmtimi i pronave ose dëmtimi i interesave të njohur me ligj, për të përfutur një avantazh që nuk të takon ose për të evituar një detyrim. Ky term nuk synon të mbulojë negociatat e ashpra, ushtrimin e rrugëve ligjore ose kontraktuese apo konfliktet gjyqësore.

4. Praktikë Konspiracionit

“Praktikë Konspiracionit” është një marrëveshje midis dy apo më shumë palëve, me qëllim arritjen e një qëllimi të parregullt, përfshirë ndikimin në mënyrë të parregullt në veprimet e një pale tjetër.

Interpretimi

Praktikë Konspiracionit janë veprime të kryera me qëllim manipulimin e tenderëve ose në lidhje me prokurimet publike apo kontratat shtetërore apo në rëndim të një Praktike Korruptive ose të një Praktike Mashtrimi.

5. Praktikë Penguese

“Praktikë Penguese” është (i) veprimi me paramendim për të shkatërruar, falsifikuar, ndryshuar apo fshehur provat gjatë një hetimi ose për t’u dhënë hetuesve deklarata të rreme, në mënyrë që të pengohet në mënyrë materiale një hetimi Grupit të Bankës Botërore në lidhje me pretendimet se ka një Praktikë Korruptive, Mashtruese, Kanosëse ose Konspiracioni, dhe/ose se është kërcënuar apo frikësuar një palë në mënyrë që ajo të mos ia paraqesë hetimit ato që di për çështjet në fjalë ose të mos kërkojë hetim, ose (ii) veprimet që synojnë të pengojnë në mënyrë materiale ushtrimin e të drejtës së subjektit të Bankës Botërore për të shikuar informacionin që kërkuar me kontratë në lidhje me hetim të Grupit të Bankës Botërore në lidhje me pretendimet se ka një Praktikë Korruptive, Mashtruese, Kanosëse ose Konspiracioni.

Interpretimi

Çdo veprim që kryen në mënyrë të ligjshme apo të rregullt një palë për të mbajtur ose ruajtur të drejtat që ia japin aktet normative, ligjet ose kushtetuta, si për shembull marrëdhënia e privilegjuar avokat-klient, pavarësisht nëse një veprim i tillë ka si pasojë pengimin e një hetimi, nuk përbën Praktikë Penguese.

Interpretim i përgjithshëm

Një person nuk duhet të mbajë përgjegjësi për veprimet që bën një i tretë që nuk ka lidhje me të, nëse pala e parë nuk ka marrë pjesë në veprimin e ndaluar në fjalë.

LIDHJA 1
MARRËVESHJE E MBËSHTJES QEVERITARE

MINISTRIA E FINANCAVE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
DUKE VEPRUAR NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË SI KËRKUESE DHE
CITIBANK EUROPE PLC, ZYRA E DEGËS NË HUNGARI
SI BANKË HUADHËNËSE

MARRËVESHJE RIMBURSIMI DHE KREDIE

Kjo Marrëveshje Rimbursimi dhe Kredie ("Marrëveshja") lidhet më 6 maj 2009

Ndërmjet:

1. Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë, me zyra në ë¹, ("MOF"); dhe

2. CITIBANK EUROPE PLC, Zyra e Degës në Hungari si Banka Huadhënëse.

Ndërsa:

a) MOF-ja i ka kërkuar dhe Banka Huadhënëse ka rënë dakord të japë Letrën e Kredisë në një shumë deri në 60 000 000 Euro në favor të Përfituesit.

b) MOF-ja ka rënë dakord të rimbursojë Bankën Huadhënëse në lidhje me çdo tërheqje të bërë nga Letra e Kredisë nga Përfituesi.

c) Duke pasur parasysh që Banka Huadhënëse bie dakord të lëshojë Letrën e Kredisë në përfitim të Përfituesit, Palët bien dakord si më poshtë.

I. Interpretimi

1.1 Termat me germa kapitale që përdoren por nuk përkufizohen në këtë Marrëveshje, kanë kuptimet e shprehura më poshtë:

"Norma e Shpenzimeve Shtesë" ka kuptimin që i jepet në Grafikon 1 (Formula e Shpenzimeve të Detyrueshme).

"Paradhënie" është çdo pagesë me Kërkesë e bërë nga Banka Huadhënëse në pajtim me Klausolën 4 (Kërkesat dhe Autoriteti i Pagesës së Bankës Huadhënëse).

"Shqipëri" është Republika e Shqipërisë.

"Periudha e Disponueshmërisë" do të thotë nga kjo datë deri më 15 qershor 2009.

"Përfituesi" është Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SHA (OSSH).

"Ditë Pune" është çdo ditë (përveç të shtunës dhe të dielës) në të cilën bankat janë të hapura për punën e zakonshme në Tiranë dhe Budapest dhe që është një Ditë TARGET.

"Qenie në Vonesë" është një Ngjarje e Qenies në Vonesë ose çdo ngjarje apo rrethanë e specifikuar në Klausolën 10 (Ngjarje të Qenies në Vonesë) që (me kalimin e afatit pa interesa, bërja e njoftimit, marrja e çdo vendimi në bazë të Dokumenteve të Financës ose një kombinim i sa më sipër) do të ishte një Ngjarje e Qenies në Vonesë.

"Kërkesë" është një kërkesë për një shumë e bërë nga Përfituesi në pajtim me Klausolën 6 të Letrës së Kredisë.

"Periudha e Fuqisë" është, në pajtim me Klausolën 5 të Letrës së Kredisë, periudha nga Data e Hyrjes në Fuqi (siç përcaktohet në Klausolën 3 të Letrës së Kredisë) deri më 2 mars 2015.

"EURIBOR", në lidhje me çdo Paradhënie, është:

a) Norma e Shpallur e zbatueshme;

b) (nëse nuk ka Normë të Shpallur për Periudhën e Interesit për atë Paradhënie) kuptimi aritmetik i normave (të rrumbullakosura nga sipër deri në katër presje dhjetore) që i jepet Bankës Huadhënësi me kërkesë të saj të kuotuar nga Bankat e Referencës për bankat drejtuese të tregut ndër-bankar evropian,

në Orën e Specifikuar në Ditën e Kuotimit për ofrimin e depozitave në Euro për një periudhë të krahasueshme për Periudhën e Interesit të Paradhënies përkatëse.

¹ Shënim: të jepet nga MOF-ja

"EURIBOR O/N" është norma e fundit e disponueshme e Normës së Shpallur për ofrimin e depozitave në Euro për një periudhë prej një dite.

"Euro" ose "€" është monedha e ligjshme e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian që aplikojnë monedhën e vetme në pajtim me Traktatin themelues të Komunitetit Evropian, të ndryshuar nga Traktati për Bashkimin Evropian.

"Ngjarje e Qenies në Vonesë" është çdo ngjarje ose rrethanë e specifikuar si e tillë në Klauzolën 10 (Ngjarje e Qenies në Vonesë).

"Qenia në Borxh të Jashtëm" është një qenie në borxh që duhet të paguhet në ose duke iu referuar një monedhe që nuk është monedha e ligjshme për momentin në Shqipëri.

"Letër e Tarifës" është letra e tarifës e kësaj date ose rreth kësaj date ndërmjet Bankës Huadhënëse, MOF-së dhe Përfituesit.

"Njoftimi Përfundimtar i Kërkesës" është njoftimi në formën e Aneksit C.

"Dokument Financiar" është kjo Marrëveshje, Letra e Kredisë, Marrëveshja e Garancisë e IBRD-së, Letra e Tarifës dhe çdo dokument tjetër i destinuar si i tillë nga Banka Huadhënëse dhe MOF-ja.

"IBRD" është Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

"Marrëveshje e Garancisë e IBRD-së" është marrëveshja e datës ose rreth datës së kësaj Marrëveshjeje ndërmjet IBRD-së dhe Bankës Huadhënëse në formën e Aneksit B, në bazë të së cilës IBRD-ja ka rënë dakord t'i japë Bankës Huadhënëse garanci pa kusht dhe me risk të pjesshëm të pakthyeshëm që mbulon principalin dhe shlyerjet e interesit të kërkueshëm por të pashlyer nga MOF-ja sipas kësaj Marrëveshjeje.

"FMN" është Fondi Monetar Ndërkombëtar.

"Periudha e Interesit" është, sipas termave të kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me Periudhën e parë të Interesit në lidhje me një Paradhënie, periudha që fillon në datën e dhënies së një Paradhënieje dhe që mbaron në datën që bie gjashtë muaj më vonë dhe në lidhje me çdo Periudhë pasuese Interesi për çdo Paradhënie, periudha pasuese gjashtë-mujore.

"Data e Pagesës së Interesit" në lidhje me çdo Paradhënie është dita e fundit e secilës Periudhe Interesi në lidhje me të.

"Data e Lëshimit" është data në të cilën Banka Huadhënëse njofton MOF-në, Përfituesin dhe IBRD-në me shkrim që të gjitha parakushtet e parakushtet e parashikuara në Grafikon 2 (Parakushtet) janë përmbushur ose prej tyre është hequr dorë.

"Banka Huadhënëse" është Citibank Europe plc, Zyra e Degës në Hungari dhe secila prej degëve dhe filialeve.

"Letra e Kredisë" është letra zëvendësuese e kredisë e lëshuar ose që duhet të lëshohet nga Banka Huadhënëse në favor të Përfituesit në formën e Aneksit A.

"Letra e Shumës së Kredisë" është shuma mbizotëruese e disponueshme për tërheqje sipas Letrës së Kredisë që në total asnjëherë nuk kalon 60 000 000 Euro.

"Shpenzime të Detyrueshme" është norma e përqindjes në vit e llogaritur nga Banka Huadhënëse në pajtim me Grafikon 1 (Formula e Shpenzimeve të Detyrueshme).

"Marzhi" është 0.90 për qind në vit.

"Shtet Anëtar Pjesëmarrës" është çdo shtet anëtar i Komuniteteve Evropiane që miraton ose ka miratuar Euron si monedhën e tij të ligjshme në pajtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian në lidhje me Bashkimin Monetar Evropian.

"Palë" është secila prej MOF-së dhe Bankës Huadhënëse dhe "Palët" janë MOF-ja dhe Banka Huadhënëse së bashku.

"Dita e Kuotimit" është, në lidhje me çdo periudhë për të cilën duhet të përcaktohet një normë interesi, dy Ditë TARGET para ditës së parë të kësaj periudhe.

"Bankat e Referencës" është zyra qendrore në Londër e Barclays Bank plc dhe National Westminster Bank plc ose ato banka të tjera që mund të caktohen nga Banka Huadhënëse në konsultim me MOF-në.

"Norma e Shpallur" është norma e përqindjes në vit e caktuar nga Federata Bankare e

Bashkimit Evropian për periudhën përkatëse, të treguar në faqen përkatëse të portalit të Reuters-it. Nëse faqja për të cilën është rënë dakord zëvendësohet ose shërbimi pushon së qeni i disponueshëm, Banka Huadhënëse mund të përcaktojë një faqe ose shërbim tjetër që tregon normën e përshtatshme pas konsultimeve me MOF-në.

"Dokumenti i Përcaktuar" ka kuptimin e dhënë në nën-klauzolën 4.2.4(b) të Klauzolës 4 (Kërkesat dhe Autoriteti i Pagesës i Bankës Huadhënëse).

"Ora e Përcaktuar" është ora 11.00 para dite.

"TARGET2" është sistemi i pagesave Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer që përdor një platformë të vetme dhe që ka nisur më 19 nëntor 2007.

"Dita TARGET" është dita në të cilën TARGET2 është i hapur për kryerjen e pagesave në Euro.

"Tatim" është çdo tatim, taksë, tarifë apo detyrim tjetër apo ndalim i një natyre të ngjashme (duke përfshirë çdo gjobë apo interes që paguhet në lidhje me një mospagesë ose vonesë në një pagesë të tillë).

"TVSH" është tatimi i vlerës së shtuar i parashikuar në Ligin për Tatimin e Vlerës së Shtuar të vitit 1944 dhe çdo tatim tjetër i një natyre të ngjashme në çdo juridiksion.

1.2 Nëse në këtë Marrëveshje nuk është parashikuar ndryshe:

1.2.1 njëjësi përfshin edhe shumësin (dhe anasjelltas);

1.2.2 titujt janë vetëm për lehtësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje;

1.2.3 referencat në Klauzola, Anekse dhe Grafikë janë në Klauzolat, Aneksat dhe Grafikët e kësaj Marrëveshjeje përveç kur tregohet ndryshe;

1.2.4 referencat në çdo ligj ose rregullore përfshijnë ndryshimet dhe zëvendësimet dhe shtesat e këtyre ligjeve dhe rregulloreve;

1.2.5 referencat tek një person përfshin pasardhësit e këtij personi dhe personat që ai u ka transferuar të drejta;

1.2.6 një "agjenci" e një shteti ose MOF-ja interpretohet si një referencë tek një nën-ndarje politike, ministri, departament, autoritet ose korporatë statutore (autonome ose jo) e këtij shteti ose çdo korporatë ose subjekt tjetër që kontrollohet (pesëdhjetë për qind ose më shumë të kapitalit aksionar të dhënë ose ekuivalentin e tij) ose është në pronësi të drejtpërdrejtë ose jo të këtij shteti ose qeverisë së tij dhe/ose një apo disa agjencive të tilla;

1.2.7 referencat tek "sendet pasurore" përfshin të gjitha ose një pjesë të biznesit, sipërmarrjes, pronës, sendeve pasurore dhe të ardhurave të tashme ose të ardhshme të një personi (dhe përfshin çdo të drejtë për të rikuperuar ose përftuar secilën sa më sipër);

1.2.8 "të qenit borxh" interpretohet sikur përfshin çdo detyrim (i shkaktuar si parësor ose si dorëzani) për pagesën ose shlyerjen e parave, qoftë i tashëm, i ardhshëm, i pritshëm ose jo (duke përfshirë pa kufizim, çdo detyrim për pagesën e parave në pajtim me një urdhër ose vendim gjykatë);

1.2.9 "muaj" është një periudhë që fillon në një ditë në një muaj kalendarik dhe mbaron në ditën që numerikisht përputhet në muajin tjetër kalendarik, përveç kur:

a) nëse dita që përputhet numerikisht nuk është Ditë Pune, ajo periudhë përfundon në Ditën pasuese të Punës në atë muaj kalendarik në të cilën ajo periudhë duhet të mbarojë nëse ka të tillë dhe nëse nuk ka në Ditën e Punës para saj; dhe

b) nëse nuk ka ditë që të përputhet numerikisht në muajin kalendarik në të cilin mbaron ajo periudhë, kjo e fundit mbaron në Ditën e fundit të Punës në atë muaj kalendarik;

me kusht që rregullat e mësipërme do të zbatohen vetëm për muajin e fundit të çdo periudhe;

1.2.10 një "person" interpretohet si një referencë tek një person, firmë, shoqëri, korporatë, qeveri, shtet ose agjenci shtetërore apo shoqatë ose partneritet (që ka ose jo personalitet të veçantë juridik) të dy ose më shumë sa më sipër;

1.2.11 një "rregullore" përfshin çdo rregullore, rregull, direktivë zyrtare, kërkesë ose udhëzim (që ka ose jo fuqinë e ligjit) të një organi, agjencie, departamenti qeveritar, ndër-qeveritar

ose supra-kombëtar, apo një autoriteti apo organizate me vetë-administrim ose tjetër;

1.2.12 ora gjatë ditës është referencë në orën e Budapestit.

1.3 Një Qenie në Vonesë (e ndryshme nga Ngjarja e Qenies në Vonesë) “vazhdon” nëse nuk është korrigjuar në mënyrë të pranueshme për Bankën Huadhënëse ose nëse nuk është hequr dorë me shkrim nga Banka Huadhënëse dhe një Ngjarje e Qenies në Vonesë “vazhdon” nëse nuk është hequr dorë me shkrim nga Banka Huadhënëse.

1.4 Një person që nuk është Palë nuk ka të drejtë në bazë të Ligjit të Kontratave (të Drejtat e Palëve të Treta) të vitit 1999 për të ekzekutuar ose gëzuar përfitimin nga ndonjë term i kësaj Marrëveshjeje.

2. Lëshimi i letrës zëvendësuese të kredisë

2.1. Në Datën e Lëshimit dhe me kusht që:

2.1.1 Data e Lëshimit të jetë një Ditë Pune brenda Periudhës së Disponueshmërisë;

2.1.2 në këtë kohë të mos ketë Qenie në Vonesë; dhe

2.1.3 të mos jetë e paligjshme në asnjë juridiksion të zbatueshëm për Bankën Huadhënëse përmbushja e ndonjë prej detyrimeve të saj të parashikuara në këtë Marrëveshje,

Banka Huadhënëse i lëshon Letrën e Kredisë Përfituesit në Shumën e plotë të Letrës së Kredisë (përveç kur pakësohet në pajtim me termat e saj).

2.2 Letra e Kredisë është e disponueshme për pagesë në pajtim me termat e Letrës së Kredisë për Përfituesin. Shuma e Letrës së Kredisë, në pajtim me dispozitat e Letrës së kredisë përsa i takon rivendosjes në afat, zvogëlohet në mënyrë të përhershme në masën e çdo tërheqjeje mbi Letrën e Kredisë ose në masën e çdo pakësimi nga Përfituesi dhe konfirmuar nga IBRD-ja në pajtim me afatet e Letrës së Kredisë.

2.3 Letra e Kredisë ka një afat të barabartë me Periudhën e Fuqisë.

2.4 Banka Huadhënëse bie dakord të bëjë çdo njoftim që duhet të bëhet prej saj në pajtim me Letrën e Kredisë.

3. Detyrimet e shlyerjes për tërheqjet dhe interesin

3.1 MOF-ja bën pagesa në lidhje me çdo Paradhënie dhe çdo shumë tjetër të kërkueshme nga Banka Huadhënëse në pajtim me këtë Klausolë 3 dhe Klausolën 6 (Pagesat për Tërheqjet, Tarifatat dhe Interesin) në Euro.

3.2 MOF-ja bie dakord të mënyrë të pakthyeshme dhe pa kushte të shlyejë Bankën Huadhënëse në Euro në pajtim me Klausolën 6 (Pagesat për Tërheqjet, Tarifatat dhe Interesin) të kësaj Marrëveshjeje, dhe këto shlyerje i bëhen Bankës Huadhënëse nga MOF-ja brenda 12 muajve nga data e dhënies së një Paradhënieje nga Banka Huadhënëse. Njoftimi për dhënien e çdo Paradhënieje nga Banka Huadhënëse i jepet MOF-së (dhe për dijeni IBRD-së) nga Banka Huadhënëse brenda pesë Ditëve Pune nga ajo datë.

3.3 Në pajtim me dispozitat e Klausolës 6 (Pagesat për Tërheqjet, Tarifatat dhe Interesin), në çdo Ditë të Pagesës së Interesit brenda 12 muajve pas dhënies së Paradhënies, MOF-ja mund të bëjë pagesa të pjesshme të shumës së kërkueshme në lidhje me Paradhënien, me kusht që shumën e mbetur e Paradhënies të paguhet plotësisht brenda 12 muajve pas Paradhënies përkatëse.

3.4 MOF-ja riimburson Bankën Huadhënëse për të gjitha Tatimet (të ndryshme nga tatimet mbi të ardhurat dhe biznesit në përgjithësi në lidhje me operimin e biznesit të saj dhe në masën që është përjashtuar nga Klausola 3.5) që paguan Banka Huadhënëse si rezultat i pagesave dhe përfitimeve të saj sipas dhe në lidhje me Letrën e Kredisë dhe kësaj Marrëveshjeje ose çdo vendim në lidhje me to. Ky riimbursim bëhet në Euro në pajtim me Klausolën 6 (Pagesat për Tërheqjet, Tarifatat dhe Interesin).

3.5 MOF-ja paguan:

3.5.1 të gjitha Tatimet shqiptare për pullën, regjistrimin dhe të tjera të cilave u nënshtrohet ose mund t’u nënshtrohet kjo Marrëveshje dhe/ose Dokumentet e tjerë Financiarë;

3.5.2 të gjitha Tatimet e tjera për pullën, regjistrimin dhe të tjera të cilave u nënshtrohet ose mund t’u nënshtrohet kjo Marrëveshje dhe/ose Dokumentet e tjerë Financiarë;

3.5.3 të gjitha Tatimet për pullën, regjistrimin dhe të tjera për çdo vendim arbitrazhi, urdhër

apo vendim i dhënë në lidhje me këto;

dhe, herë pas here me kërkesën e Bankës Huadhënëse, zhdëmton Bankën Huadhënëse, riimburson Bankën Huadhënëse për çdo detyrim, shpenzim, pretendim që rrjedh nga mospagesa ose vonesa në pagesën e një Tatimi të tillë. Ky riimbursim bëhet në Euro në pajtim me Klauzolën 6 (Pagesat për Tërheqjet, Tarifatat dhe Interesin).

3.6 Paradhëniet mbledhin interes me bazë ditore nga data e pagesës nga Banka Huadhënëse deri në por duke përjashtuar datën e shlyerjes nga MOF-ja, me një normë përqindjeje në vit që është total ii (a) Marzhit; (b) EURIBOR-it për 6 muaj; dhe (c) Shpenzimet e Detyrueshme, sipas rastit, mbi bazën e një viti me 360 ditë. Ky interes duhet të paguhet nga MOF-ja në Datën përkatëse të Pagesës së Interesit në lidhje me secilën prej këtyre Paradhënieve, në Euro dhe në pajtim me Klauzolën 6 (Pagesat për Tërheqjet, Tarifatat dhe Interesin).

3.7 Nëse ndodh prishja e plotë ose e pjesshme për çdo shkak i Marrëveshjes së Garancisë e IBRD-së (duke përfshirë atë në pajtim me Nenin 4.4 të Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së), atëherë:

a) të gjitha shumatat e pakthyera sipas kësaj Marrëveshje bëhen menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme nga MOF-ja Bankës Huadhënëse me kërkesë të Bankës Huadhënëse; dhe/ose

b) Banka Huadhënëse mund të kërkojë që MOF-ja të realizojë herë pas here bllokimin ose sigurimin e një depozite në Euro në favor të dhe me termat dhe kushtet të pranueshme për Bankën Huadhënëse dhe IBRD-në, në një shumë dhe në momentet e përcaktuara nga Banka Huadhënëse deri në Shumën e Letrës së Kredisë here pas here (dhe MOF-ja e bën këtë).

3.8 Banka Huadhënëse bie dakord të njoftojë MOF-në nëse ajo vepron ose do të veprojë në mënyrë të paligjshme në lidhje me Letrën e Kredisë ose këtë Marrëveshje. Paligjshmëria mund të ketë të bëjë, pa kufizim, me përmbushjen e detyrimeve të Bankës Huadhënëse ose masat e financimit të Bankës Huadhënëse. Nëse Banka Huadhënëse bën një njoftim për paligjshmërinë tek MOF-ja, kjo e fundit në datën që përcaktohet nga Banka Huadhënëse siguron që detyrimet e Bankës Huadhënëse sipas ose në lidhje me Letrën e Kredisë të zbresin në zero ose të sigurohen duke dhënë garanci në para në një shumë që caktohet nga Banka Huadhënëse në Shumën e Letrës së Kredisë herë pas here. MOF-ja bie gjithashtu dakord të shlyejë çdo Paradhënie të mbetur me interesin e mbetur në datën e fundit të Periudhës së Interesit gjatë së cilës është marrë njoftimi, përveç kur Banka Huadhënëse vërteton që, për shkak të një kërkesë ligjore që zbatohet për Bankën Huadhënëse, ajo duhet të paguhet më parë. Në këtë rast, MOF-ja shlyen Paradhëniet në datën e caktuar nga Banka Huadhënëse.

3.9 Nëse MOF-ja nuk paguan një shumë që duhet të paguhet sipas kësaj Marrëveshjeje në datën e duhur (duke përfshirë shumën e kërkueshme në pajtim me këtë Klauzolë 3.9) (një “shumë e papaguar”), MOF-ja do të paguajë interesin për këtë shumë të papaguar për kohëzgjatjen e kësaj mospagese në shumën 1 për qind mbi normën që do të ishte e kërkueshme nëse shumata e papaguar do të ishte një Paradhënie dhe e caktuar për një periudhë interesi të kësaj kohëzgjatjeje që përcaktohet nga Banka Huadhënëse (“Periudha e Interesit për Qenien në Vonesë”). Çdo interes i munguar që paguhet sipas kësaj Klauzole 3.9 do të jetë i pagueshëm me kërkesë të Bankës Huadhënëse dhe do të bashkohet në fund të çdo Periudhe Interesi për Qenien në Vonesë.

3.10 do shumë që paguhet sipas kësaj Marrëveshjeje që nuk paguhet në datën e duhur të saj mbledh interes me bazë ditore nga kjo datë e pagesës deri në datën e pagesës faktike (para dhe pas vendimit) me një normë përqindjeje në vit që është total ii (a) Marzhit; (b) EURIBOR O/N; (c) Shpenzimet e Detyrueshme, sipas rastit, dhe (d) 1% të mbledhur në ato data që mund të përcaktoje Banka Huadhënëse, në diskrecionin e saj të plotë, dhe me një bazë një vit me 360 ditë. Ky interes paguhet në Euro me kërkesë nga Banka Huadhënëse dhe në pajtim me Klauzolën 6 (Pagesat për Tërheqjet, Tarifatat dhe Interesin).

4. Kërkesat dhe autoriteti i pagesës i bankës huadhënëse

4.1 MOF-ja autorizon në mënyrë të pakthyeshme dhe pa kushte Bankën Huadhënëse të bëjë pagesat tek Përfituesi në pajtim me termat e Letrës së Kredisë me paraqitjen e të gjitha dokumenteve të kërkuara, pa:

4.1.1 asnjë referencë ose kërkesë tjetër për aprovim ose autorizim nga MOF-ja ose çdo person tjetër, konfirmim ose verifikim nga MOF-ja ose një person tjetër, apo asnjë hetim, të një Kërkesë ose të detyrimit të Bankës Huadhënëse për të bërë pagesë në lidhje me këtë;

4.1.2 asnjë hetim (përveç që certifikatat dhe dokumentet mbështetëse të paraqitura asaj të duken më pamje sikur përmbushin kërkesat e Letrës së Kredisë) në lidhje me arsyetimin, vlefshmërinë e Kërkesës ose saktësinë e ndonjë shume që pretendohet në Kërkesë ose në një dokument mbështetës ose tjetër ose asnjë pazotësi ose kufizim fuqie të personit ose të çdo personi që nënshkruan Kërkesën ose një dokument tjetër; ose

4.1.3 pa kërkuar prova që një ngjarje e pretenduar në Kërkesë të ketë ndodhur apo që ka ndodhur ose një shumë e pretenduar në Kërkesë si e kërkueshme të jetë faktikisht e tillë,

pavarësisht nëse MOF-ja ose një person tjetër kundërshton ose mund të kundërshtojë vlefshmërinë e Kërkesës ose bërjen e pagesës nga Banka Huadhënëse.

4.2 MOF-ja bie dakord dhe pranon në mënyrë të pakthyeshme dhe pa kusht që:

4.2.1 çdo pagesë e një Kërkesë që Banka Huadhënëse bën në pajtim me dispozitat e Letrës së Kredisë është detyruese dhe e pranohet nga MOF-ja;

4.2.2 nuk shërben si mbrojtje ndaj një pretendimi të Bankës Huadhënëse kundrejt MOF-së sipas kësaj Marrëveshjeje që Banka Huadhënëse mund ose duhej të mos kishte bërë ose kundërshtuar një Kërkesë të bërë nga Përfituesi;

4.2.3 Banka Huadhënëse procedon vetëm me dokumente dhe nuk shqetësohet për ligjshmërinë e një pretendimi ose Kërkesë ose transaksioni përkatës apo ndonjë kompensimi, kundërp pretendimi ose mbrojtje tjetër të mundshme të ndonjë personi; dhe

4.2.4 Pa cenuar ndonjë dispozitë tjetër të kësaj Marrëveshjeje:

a) çdo Kërkesë për Bankën Huadhënëse sipas Letrës së Kredisë që, në pamje të saj, pas shqyrtimit të arsyeshëm nga Banka Huadhënëse, konstatohet të jetë në pajtim me termat dhe dispozitat e Letrës së Kredisë konsiderohet të jetë e vlefshme për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje edhe nëse përfundimisht konstatohet që personi që ka bërë kërkesën në emër të Përfituesit nuk e ka autoritetin përkatës; dhe

b) nëse Letra e Kredisë kërkon që një Kërkesë duhet të shoqërohet nga një dokument ose dokumente (secili një “Dokument i Specifikuar”) atëherë, me kusht që një Dokument i Specifikuar konstatohet pas një shqyrtimi të arsyeshëm të Bankës Huadhënëse në pamje duket sikur përmbush kushtet e Letrës së Kredisë, ai Dokument i Specifikuar konsiderohet për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje të jetë në pajtim me termat e Letrës së Kredisë.

5. Zhdëmtimi dhe përjashtimi nga detyrimet

5.1 MOF-ja zhdëmton Bankën Huadhënëse në mënyrë të pakthyeshme dhe pa kushte nga deh kundrejt të gjitha kërkesave, pretendimeve, detyrimeve (të pritshme ose të paparashikuara, të tashme apo të ardhshme, të bashkuara ose të veçanta, dhe pavarësisht nëse duhet të bëhet njoftim), humbjet dhe dëmi (duke përfshirë pa kufizim të gjitha veprimet, gjykimet, pagesat, shpenzimet dëmet, tatimet dhe detyrimet) që pësohen ose shkaktohen nga Banka Huadhënëse duke vepruar si Bankë Huadhënëse sipas Letrës së Kredisë (“Detyrime të Zhdëmtuara”). MOF-ja bie dakord t’i paguajë Bankës Huadhënëse Detyrimet e Zhdëmtuara menjëherë me kërkesë të parë.

5.2 Pa kufizuar Klauzolën 5.3 më poshtë, Banka Huadhënëse nuk i detyrohet asnjë pale për asnjë veprim të ndërmarrë prej saj sipas ose në lidhje me Letrën e Kredisë ose këtë Marrëveshje, përveç se për shkak të mashtrimit ose qenies në vonesë të qëllimshme nëse Banka Huadhënëse konstatohet të jetë përgjegjëse për këtë mashtrim ose qenie me vonesë të qëllimshme me vendim përfundimtar ose të paankimueshëm ose vendim arbitrazhi të një gjykatë angleze ose gjykate arbitrazhi me juridiksion kompetent.

5.3 Asnjë Palë (e ndryshme nga Banka Huadhënëse) nuk mund të fillojë procedim kundër një nëpunësi ose punonjësi apo agjenti të Bankës Huadhënëse në lidhje me një pretendim që ajo mund të ketë kundër Bankës Huadhënëse ose në lidhje me një veprim ose mosveprim i çdo lloji nga ai nëpunës, punonjës ose agjent në lidhje me Letrën e Kredisë ose këtë Marrëveshje.

6. Pagesat për tërheqjet, tarifat dhe interesat

6.1 Në rast se MOF-ja nuk shlyen një Paradhënie ose një pjesë të saj brenda 11 muajve nga data e kësaj Paradhënieje, Banka Huadhënëse i lëshon MOF-së një Njoftim Kërkese të Fundit ku shprehet shuma që duhet të paguhet dhe që shuma duhet të paguhet nga MOF-ja brenda muajit pasues, dhe për dijeni i dërgohet IBRD-së.

6.2 Në rastin se MOF-ja nuk shlyen për një arsye të caktuar Bankën Huadhënëse shumën e një Paradhënieje brenda 12 muajve pas datës së kësaj Paradhënieje, Banka Huadhënëse ka të drejtë të bëjë një kërkesë për shlyerjen e kësaj Paradhënieje nga IBRD-ja në pajtim me termat e Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së.

6.3 Nëse Banka Huadhënëse konstaton në mënyrë të arsyeshme që si rezultat:

6.3.1 prezantimi ose ndryshimi (ose në interpretimin apo zbatimin) e një ligji apo akti nënligjor pas datës së kësaj Marrëveshjeje;

6.3.2 respektimi i një ligji apo akti nënligjor të bërë pas datës së kësaj Marrëveshjeje (që ka ose jo forcën e ligjit); ose

6.3.3 respektimi i kërkesave nga një bankë qendrore ose autoritet tjetër fiskal, monetar apo tjetër i bërë pas datës së kësaj Marrëveshjeje; shkakton ose ka shkaktuar (a) një ulje në normën e të ardhurave sipas kësaj Marrëveshjeje, Letrës së Kredisë ose të kapitalit të saj të përgjithshëm; (b) një shpenzim shtesë ose të rritur sipas kësaj Marrëveshjeje; ose (c) një ulje të një shume të kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, MOF-ja i paguan me kërkesë Bankës Huadhënëse një shumë të mjaftueshme për të kompensuar Bankën Huadhënëse për një ulje të tillë në normën e të ardhurave, shpenzimet e rritura ose uljen në shumën e kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje. Çdo shumë që paguhet nga MOF-ja sipas kësaj Klauzole 6.3 përjashton çdo shumë që është për shkak të qenies në vonesë të qëllimshme ose neglizhencës së hapur së Bankës Huadhënëse në lidhje me një ligj ose akt nënligjor apo shpenzime të kompensuara nëpërmjet zhdëmtimit të tatimeve ose detyrimit për pagesë sipas Dokumenteve Financiare.

6.4 MOF-ja, me kërkesë të Bankës Huadhënëse, riimburson Bankën Huadhënëse për të gjitha shpenzimet dhe koston (duke përfshirë tarifat ligjore) që shkaktohen në lidhje me ruajtjen dhe/ose realizimin e çdo të drejte të Bankës Huadhënëse sipas Dokumenteve Financiare.

6.5 Asnjë pagesë apo rikuperim tjetër nga Banka Huadhënëse nuk mënjanon detyrimet për shlyerje të MOF-së përveç kur dhe deri sa Banka Huadhënëse të ketë marrë pagesën e shumave të pagueshme të plota në monedhën në të cilën këto shuma ishin të kërkueshme sipas Klauzolës 3 (Detyrimet e Shlyerjes për Tërheqjet dhe Interesin). Në masën që shuma e çdo pagese ose rikuperimi të tillë merret nga Banka Huadhënëse në lidhje me këtë Marrëveshje në një monedhe të ndryshme nga monedha e përcaktuar për pagesën, MOF-ja mbetet e detyruar për mungesën në monedhën në të cilën është e kërkueshme shuma dhe zhdëmton dhe e mban të padëmtuar Bankën Huadhënëse ndaj çdo humbjeje të pësuar ose të shkaktuar si rezultat i kësaj mungese.

6.6 MOF-ja bie dakord me Bankën Huadhënëse ta zhdëmtojë atë ndaj çdo humbjeje të shkaktuar si rezultat i një vendimi ose urdhri të dhënë ose bërë për pagesën e një shume të kërkueshme dhe kur ky vendim ose urdhër është shprehur në një monedhë të ndryshme nga monedha në të cilën ajo duhej të paguhej. Zhdëmtimi i mësipërm përbën një detyrim të veçantë dhe të pavarur të MOF-së dhe zbatohet pavarësisht nga tolerimet që i jepen herë pas here MOF-së dhe vazhdon të mbetet në fuqi plotësisht pavarësisht nga ndonjë vendim apo urdhër sa më sipër.

6.7 Të gjitha pagesat e bëra sipas kësaj Marrëveshjeje bëhen me fondet drejtpërdrejt të disponueshme dhe pa kompensim apo kundërpretendim dhe pa uljen ose mbajtjen për shkak të Tatimeve, përveç kur ulja ose mbajtja kërkohet me ligj ose akt nënligjor, dhe në këtë rast MOF-ja e rrit shumën e pagesës për Bankën Huadhënëse në mënyrë që shuma e marrë nga Banka Huadhënëse të jetë e njëjtë sa ajo që do të merrte në mungesë të kësaj uljeje apo ndalimi. Nëse MOF-ja bën pagesa në lidhje me të cilat kërkohet të bëhet një ulje ose ndalim, ajo paguan shumën e plotë që kërkohet për t'u zbritur ose ndaluar tek organi i tatimeve apo tjetër brenda fatit që lejohet për një pagesë të tillë nën ligjin e zbatueshëm dhe i jep Bankës Huadhënëse, brenda një muaji pasi të ketë bërë këtë pagesë tek autoriteti përkatës, një kopje të vërtetuar të dokumentit origjinal të lëshuar nga

ky organ që provon pagesën tek ky organ të të gjitha shumave që kërkohen për t'u zbritur ose mbajtur.

6.8 E gjithë shuma që konsiderohet të jetë e pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje nga MOF-ja për Bankën Huadhënëse konsiderohet të jetë pa asnjë TVSH. Nëse TVSH-ja aplikohet për ndonjë kontribut të bërë nga Banka Huadhënëse në lidhje me këtë Marrëveshje ose një Dokument Financiar, MOF-ja i paguan Bankës Huadhënëse (përveç dhe në të njëjtën kohë që paguan shumën) një shumë të barabartë me shumën e TVSH-së.

6.9 Nëse kjo Marrëveshje i kërkon MOF-së të riimbursojë Bankën Huadhënëse për ndonjë shpenzim ose kosto, MOF-ja në të njëjtën kohë paguan dhe zhdëmton Bankën Huadhënëse për të gjithë TVSH-në e paguar nga Banka Huadhënëse, në masën që Banka Huadhënëse përcakton në mënyrë të arsyeshme që ajo nuk duhet të kreditojë ose shlyer TVSH-në.

6.10 MOF-ja zhdëmton Bankën Huadhënëse ndaj (a) çdo kostoje, pretendimi, humbjeje, shpenzimi (duke përfshirë tarifat ligjore) ose detyrimi së bashku me çdo shumë përkatëse që secila prej tyre mund të shkaktojë si pasojë e ndodhisë së një Qenieje në Vonesë ose vonesë e MOF-së në përmbushje të një prej detyrimeve të saj që konsiderohet të merret përsipër prej saj në këtë Marrëveshje dhe (b) dhe çdo humbje që mund të pësojë ose shkaktojë Banka Huadhënëse si rezultat i financimit ose marrjes së masave për financimin ose mbajtur një pjesë të një Paradhënieje, por që nuk është dhënë për shkak ta zbatimit të një ose më shumë të këtyre dispozitave.

6.11 Në secilën data në të cilën MOF-së i kërkohet të bëjë një pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje, MOF-ja ia bën këtë Bankës Huadhënëse për vlerën në datën e kërkueshme dhe orën dhe ato fonde që përcaktohen nga Banka Huadhënëse që janë të zakonshme në momentin e kryerjes së transaksioneve në monedhën përkatëse në vendin e pagesës.

6.12 Çdo pagesë e MOF-së për Bankën Huadhënëse sipas Dokumentit Financiar bëhet në llogarinë e mëposhtme:

Përfituesi:	[•]
SWIFT:	[•]
Llogaria:	[•]
CHIPS:	[•]
Hollësi për Pagesën:	[•]

ose në llogari të tjera bankare që mund të përcaktojë Banka Huadhënëse me njoftim paraprak në jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune.

6.13 Çdo pagesë që duhet të bëhet në një ditë që nuk është Ditë Pune bëhet në ditën tjetër të Punës në të njëjtin muaj kalendarik (nëse ka) ose në Ditën para saj të Punës (nëse nuk ka).

6.14 Në masën që shumat e marra nga Banka Huadhënëse pre MOF-së nuk janë të mjaftueshme për të paguar tërësisht shumat e kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, Banka Huadhënëse i përdor fondet e marra nga MOF-ja në rendin e mëposhtëm të prioritetit:

6.14.1 Së pari, për ose drejt pagesës pro rata për çdo shpenzim të papaguar të Bankës Huadhënëse sipas kësaj Marrëveshjeje;

6.14.2 së dyti, për ose drejt pagesës pro rata për çdo interes të mbledhur të kërkueshëm por të papaguar.

6.14.3 së treti, për ose drejt shlyerjes sipas një rendi kronologjik të maturimit (d.m.th, duke zbatuar ato shuma në shlyerjen e Paradhënieve të bëra në ditën më të parë dhe pas kësaj në ditën pasuese më të parë dhe kështu me radhë) të çdo Paradhënieje të dhënë por që nuk është shlyer sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

6.14.4 së katërti, në dhe drejt shlyerjes pro rata për çdo shumë tjetër që është e kërkueshme por nuk është paguar sipas kësaj Marrëveshjeje.

Kushtet e kësaj Klauzole 6.14 mbizotërojnë mbi çdo kontribut të bërë nga MOF-ja. Çdo shumë e marrë nga Banka Huadhënëse prej IBRD-së sipas Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së zbatohet në lidhje vetëm me shlyerjen e Paradhënies dhe Interesit të Mbledhur (këto kushte janë përcaktuar në Marrëveshjet e Garancisë së IBRD-së) të përcaktuar në kërkesën për shlyerjen e

paraqitur nga Banka Huadhënëse për IBRD-në.

7. Përfaqësimet dhe garancitë

7.1 MOF-ja përfaqëson dhe garanton Bankën Huadhënëse që:

7.1.1 MOF-ja është një organ i specializuar i administratës qendrore publike sipas sistemit të Republikës së Shqipërisë dhe nuk i është (dhe nuk mund të jetë) nënshtruar një procedure falimentimi.

7.1.2 Ajo ka tagrat dhe të gjitha miratimet e nevojshme për të marrë përsipër dhe përmbushur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje.

7.1.3 Detyrimet e shprehura të marra përsipër prej saj në secilin Dokument Financiar ku ajo është palë janë detyrime të ligjshme, të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme.

7.1.4 Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje dhe përmbushja e transaksioneve të parashikuara në të nuk dhe nuk do të shkelin ligjin shqiptar, aktet nënligjore apo rendin zyrtar dhe juridik të ndonjë autoriteti shqiptar (duke përfshirë pa kufizim çdo ligj të prokurimit publik) dhe nuk janë në konflikt ose në mospajtim me to dhe nuk do të vendosin apo rezultojnë në krijimin e ndonjë rëndimi me barrë të sendeve pasurore të MOF-së si dhe nuk përbëjnë qenie në vonesë në ndonjë aspekt material sipas termave të ndonjë ligji, kontrate, rëndimi me barrë, dokument besimi, bono, marrëveshje apo instrumente ose masa apo detyrime të tjera ku MOF-ja është palë ose nëpërmjet të cilave MOF-ja ose ndonjë prej sendeve pasurore të saj (të ndryshme nga sendet pasurore në sferën publike) mund t'i nënshtrohet apo që MOF-ja mund të detyrohet.

7.1.5 Asnjë ngjarje nuk ka ndodhur e cila përbën qenie në vonesë në bazë të ose në lidhje me një marrëveshje ose dokument në lidhje me Qenien në Borxh të Jashtëm ku MOF-ja është palë ose ku MOF-ja mund të detyrohet dhe asnjë ngjarje nuk ka ndodhur që, pas njoftimit, parashkrimit ose kusht tjetër mund të përbëjë një qenie në vonesë në bazë të ose në lidhje me një marrëveshje ose dokument të tillë.

7.1.6 Asnjë gjykim, arbitrazh ose procedim administrativ në një gjykatë, organ arbitrazhi apo agjenci (duke përfshirë, por pa u kufizuar në procedimet hetimore) që, nëse vendosen negativisht, mund të priten në mënyrë të arsyeshme të kundërshtojnë ose ndikojnë në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë ose përmbushjen e detyrimeve të MOF-së sipas Dokumentit Financiar ku ajo është palë.

7.1.7

a) Nënshkrimi, dhënia, përmbushja dhe respektimi i kësaj Marrëveshjeje nga MOF-ja përbëjnë veprime private dhe tregtare dhe jo veprime qeveritare publike dhe MOF-ja, në bazë të ligjeve të Shqipërisë, nuk e ka të drejtën e imunitetit përveç asaj të parashikuar në nënparagrafin (b) me poshtë nga dorëzimi i padisë, juridiksioni, padia, vendimi, kompensimi, kundërpretendimi ose procese të tjera ligjore në lidhje me ndonjë prej detyrimeve të MOF-së sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Në masën që në një juridiksion mund të fillohet procedimi që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje dhe MOF-së ose ndonjë prej sendeve pasurore të saj (të ndryshme nga sendet pasurore në sferën publike) mund t'i jepet një e drejtë imuniteti (e pretenduar apo jo), heqja dorë nga imuniteti e parashikuar në këtë Marrëveshje është detyruese në mënyrë të pakthyeshme për MOF-në.

7.1.8 Të gjitha pagesat që bëhen të kërkueshme prej MOF-së në bazë të kësaj Marrëveshjeje mund të bëhen pa u përzier dhe pa zbritje apo ndalime për shkak të Tatimeve të tashme në Shqipëri.

7.1.9 Në çdo procedim të filluar në Shqipëri për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjedhja e ligjit anglez si ligj i zbatuar i kësaj Marrëveshjeje njihet dhe zbatohet për çdo vendim të nxjerrë në Angli për këtë dhe do të njihet dhe zbatohet.

7.1.10 Detyrimet e MOF-së renditen të paktën pari passu me të gjitha detyrimet e tjera të pasiguruar dhe jo të varura.

7.1.11 Nuk ka patur asnjë ndryshim material negativ në gjendjen financiare të MOF-së ose agjencive të saj qysh prej datës 17 mars 2009.

7.1.12 Nuk është e nevojshme në bazë të ligjeve të Shqipërisë që:

a) me qëllim që t'i mundësohet Bankës Huadhënëse të realizojë të drejtat e saj sipas një Dokumenti Financiar; ose

b) për shkak të realizimit të një Dokumenti financiar ose përmbushjen prej saj të detyrimeve sipas një Dokumenti Financiar,

që Banka Huadhënëse të licencohet, kualifikohet apo të fitojë ndryshe të drejtë të zhvillojë biznes në Shqipëri.

7.1.13 Banka Huadhënëse nuk është dhe nuk do të konsiderohet të jetë me qëndrim, vendbanim apo të zhvillojë biznes në Shqipëri thjesht për shkak të nënshkrimit, përmbushjes dhe/ose zbatimit të një Dokumenti Financiar.

7.2 Të gjitha përfaqësimet e parashikuara në Klauzolën 7 bëhen në datën e kësaj Marrëveshjeje, mbeten në fuqi pas nënshkrimit të saj dhe dhënies së çdo Paradhënieje dhe konsiderohen të përsëriten, nëpërmjet referimit të rrethanave ekzistuese të atëhershme nga MOF-ja në Datën e Lëshimit, çdo Datë të Pagesës së Interesit dhe datë të dhënies së një Paradhënieje.

8. Detyrimet për informacion

8.1 MOF-ja i jep Bankës Huadhënëse në një formë të pranueshme për Bankën Huadhënëse brenda 90 ditëve nga kërkesa e Bankës Huadhënëse:

8.1.1 një deklaratë për Qenien në Borxh të Jashtëm të MOF-së dhe agjencive të saj në fund të këtij viti, duke identifikuar çdo hua ose garanci të marra parasysh në këtë deklaram dhe duke deklaruar në lidhje me çdo hua të tillë, burimin, shumën dhe grafikun e shlyerjes;

8.1.2 një deklaram të gjendjes së tashme të balancës së pagesave të MOF-së në lidhje me këtë vit dhe një deklaram të gjendjes së kapitalit në balancën e pagesave të MOF-së në këtë vit përkatës; dhe

8.1.3 një deklaram të sasisë së rezervave të floririt dhe monedhës së huaj në fund të vitit të kërkuar (që është floriri dhe kursi i këmbimit dhe ky term përfshin letrat me vlerë të përcaktuara të Qenies në Borxh të Jashtëm, që konsiderohet dhe mbahet rregullisht si rezervë zyrtare e jashtme e Shqipërisë).

8.2 MOF-ja mund të përmbushë detyrimin e saj sipas Klauzolës 8.1 duke nxjerrë këtë informacion në një faqe elektronike zyrtare të destinuar prej saj ("Faqa e Destinuar"). MOF-ja njofton Bankën Huadhënëse menjëherë sapo të marrë dijeni për ndodhinë nëse:

8.2.1 Faqa e Destinuar (ose çdo seksion në gjuhën angleze) nuk mund të hapet për shkak të një defekti teknik;

8.2.2 Faqa e Destinuar ndryshon ose nuk mund të hapet nga publiku; ose

8.2.3 merr dijeni që Faqa e Destinuar ose çdo informacion i nxjerrë në Faqen e Destinuar është e infektuar nga një virus elektronik ose një program i ngjashëm.

Nëse MOF-ja njofton Bankën Huadhënëse (ose Banka Huadhënëse merr vetë dijeni për këto ngjarje dhe njofton përkatësisht MOF-në) i gjithë informacioni që duhet të jepet prej saj sipas Klauzolës 8.1 pas datës së atij njoftimi jepet në format shkresor nëse përveç dhe derisa Banka Huadhënëse të bindet që rrethanat që shkaktojnë njoftimin nuk vazhdojnë të ekzistojnë.

8.3 (MOF-ja, menjëherë sapo të marrë dijeni, njofton Bankën Huadhënëse për çdo rrethanë që do të pritej në mënyrë të arsyeshme t'i mundësonte IBRD-së të nxirrte një njoftim në pajtim me Nenin 4.1 paragrafi ((b), (c), (d) ose (e)) të Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së). 2

8.4 MOF-ja, herë pas here me kërkesën e Bankës Huamarrëse, i jep Bankës Huamarrëse atë informacion tjetër financiar, statistikor ose të përgjithshëm për MOF-në dhe agjencitë e saj që Banka Huamarrësi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

9. Detyrimet

9.1 MOF-ja merr, përmbush të gjitha kushtet dhe bën gjithçka është e mundur për të mbajtur plotësisht në fuqi të gjitha autorizimet, aprovimet, licencat dhe miratimet e kërkuara nga ligjet dhe aktet nënligjore të Shqipërisë për t'i mundësuar asaj të marrë përsipër dhe të përmbushë

² Shënim: hapur

detyrimet e saj sipas Dokumenteve Financiare ku ajo është palë dhe të sigurojë ligjshmërinë, vlefshmërinë, zbatueshmërinë dhe pranueshmërinë e zbatueshme në Shqipëri të Dokumenteve Financiare ku ajo është palë.

9.2 MOF-ja informon menjëherë Bankën Huadhënëse për ndodhinë e çdo Qenieje në Vonesë dhe, me marrjen e një kërkesë me shkrim nga Banka Huadhënëse, i konfirmon Bankës Huadhënëse që, përveç kur i është njoftuar më parë Bankës Huadhënëse ose njoftuar në këtë konfirmim, asnjë Qenie në Vonesë nuk ka ndodhur.

9.3 MOF-ja siguron kurdoherë që pretendimet e Palëve Financiare kundër saj sipas Dokumenteve Financiare ku ajo është palë renditen të paktën pari passu me pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë të pasiguruar dhe jo të varur.

9.4 MOF-ja, me kërkesë të Bankës Huadhënëse, kryen çdo veprim tjetër ose jep çdo informacion tjetër që mund të jetë i nevojshëm ose i disponueshëm për të realizuar synimin e kësaj Marrëveshjeje dhe për t'i mundësuar Bankës Huadhënëse të marrë mbështetjen e plotë të IBRD-së në pajtim me Marrëveshjen e Garancisë së IBRD-së.

10. Ngjarjet e qenies në vonesë

Të gjitha dispozitat nga Klauzola 10.1 deri 10.11 përshkruajnë rrethana që përbëjnë Ngjarje të Qenies në Vonesë për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

10.1 MOF-ja nuk paguan një shumë që kërkohet prej saj ose nuk jep garanci në para nëse kjo kërkohet sipas nj Dokumenti Financiar në kohën, monedhën dhe mënyrën e përcaktuar në të.

10.2 Çdo përfaqësim ose deklaram i bërë nga MOF-ja në një Dokument Financiar ku ajo është palë ose në një njoftim ose dokument, certifikatë ose deklaram tjetër të dhënë nga MOF-ja në pajtim ose në lidhje me të është ose vërtetohet që nga pikëpamja lëndore është i pasaktë ose i shtrembëruar kur bëhet ose konsiderohet të bëhet.

10.3 MOF-ja nuk përmbush ose nuk respekton rregullisht një prej detyrimeve të saj të shprehur të jetë marrë përsipër prej saj në Klauzolën 8 (Detyrimi për Informacion) ose Klauzolën 9 (Detyrimet).

10.4 MOF-ja nuk përmbush ose respekton rregullisht një detyrim tjetër të shprehur të marrë përsipër prej saj në një Dokument Financiar ku ajo është palë dhe kjo mospërmbushje, nëse mund të korrigjohet sipas mendimit të Bankës Huadhënëse, nuk korrigjohet brenda 20 Ditëve pasuese të Punës pasi Banka Huadhënëse t'i ketë bërë njoftim për këtë MOF-së ose pasi MOF-ja të ketë marrë dijeni për këtë shkelje.

10.5 Një borxh i MOF-së ose e agjencive të saj nuk paguhet kur bëhet i kërkueshëm, një borxh i MOF-së ose i agjencive të saj deklarohet ose ndryshe bëhet i kërkueshëm dhe i pagueshëm para maturimit të parashikuar ose një kreditor apo kreditorët e MOF-së ose të agjencive të saj fitojnë të drejtën të deklarojnë qenien në borxh të MOF-së ose të agjencive të saj të kërkueshëm dhe të pagueshëm para maturimit të parashikuar (ose çdo ngjarje e ngjashme sa më sipër ndodh me Bankën Kombëtare të Shqipërisë ose agjencitë e saj).

10.6 Deklarohet një shtyrje për pagesën e një Borxhi të Jashtëm të MOF-së ose të një agjencie të saj apo MOF-ja ose agjencitë e saj nuk janë në gjendje të paguajnë Borxhin e Jashtëm ku ai bëhet i kërkueshëm ose fillon bisedimet me një ose më shumë prej kreditorëve të saj me qëllim rirregullimin e përgjithshëm ose riplanifikimin e Borxhit të Jashtëm.

10.7 MOF-ja nuk njeh një Dokument Financiar ku ajo është palë ose kryen apo realizon kryerjen e një veprimi ose sendi që provon me shkrim që ajo synon të mos njohë një Dokument Financiar të tillë ose MOF-ja mënjanon, anulon ose prish tërësisht ose plotësisht një Dokument Financiar ku ajo është palë.

10.8 Në çdo moment që kërkohet të bëhet, përmbushet apo kryhet një veprim, kusht apo send me qëllim (a) mundësimin MOF-së të marrë, ushtrojë të drejtat dhe përmbushë detyrimet materiale të shprehura të marra përsipër prej saj në Dokumentet Financiare (se në një prej tyre) ku ajo është palë; (b) sigurimin që detyrimet materiale të shprehura të marra përsipër nga MOF-ja në Dokumentet Financiare (ose në një prej tyre) ku ajo është palë të jenë të ligjshme, detyruese dhe të zbatueshme; ose (c) bërjen e Dokumenteve Financiare (ose të një prej tyre) të pranueshëm në

Shqipëri, nuk bëhet, nuk përmbushet ose nuk kryhet.

10.9 Në çdo moment kur është ose bëhet e paligjshme përmbushja ose respektimi i një ose të gjithë detyrimeve të MOF-së sipas Dokumenteve Financiare (ose një prej tyre) ku ajo është palë ose një prej detyrimeve të MOF-së nuk është ose pushon se qeni i ligjshëm, i vlefshëm, detyrues dhe/ose i zbatueshëm.

10.10 Republika e Shqipërisë pushon se qeni anëtar në gjendej të mirë ose (përveç shkakt të përmirësimit ekonomik) bëhet i papërshtatshëm për të përdorur burimet e FMN-së.

10.11 Ndodhia e një ngjarjeje ose një seri ngjarjesh që sipas mendimit të Bankës Huadhënëse mund të ketë një efekt material negativ për:

10.11.1 gjendjen dhe operacionet financiare të MOF-së ose agjencive të saj; ose

10.11.2 aftësinë e MOF-së për të përmbushur një prej detyrimeve të saj sipas Dokumenteve Financiare ku ajo është palë; ose

10.11.3 vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e Dokumenteve Financiare ose të drejtave apo mjeteve mbrojtëse të Bankës Huadhënëse në to.

10.12 Me ndodhinë e një Ngjarjeje të Qenies në Vonesë dhe nëse në çdo kohë (para ose pas kësaj Ngjarjeje të Qenies në Vonesë për sa kohë një rrethanë e tillë e përmendur në Klauzolat 10.12.1 deri 10.12.3 vazhdojnë ndërsa kjo Ngjarje e Qenies në Vonesë gjithashtu vazhdon):

10.12.1 ndodh prishja e plotë ose e pjesshme për në arsye të caktuar e Marrëveshjes së Garancisë e IBRD-së (duke përfshirë në pajtim me Nenin 4.4 të Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së);

10.12.2 IBRD-ja refuzon një Kërkesë (sipas përkufizimit në Marrëveshjen e Garancisë së IBRD-së) sipas Nenit 5.3 të Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së dhe një Kërkesë e tillë e papërmbushur nuk mund të përmbushet në mënyrë të arsyeshme brenda tridhjetë (30) ditëve nga Kërkesa e parë; dhe/ose

10.12.3 MOF-ja nuk paguan një shumë të kërkueshme në pajtim me një Dokument Financiar në kohen, monedhën dhe mënyrën e përcaktuar në të dhe kjo shumë e papaguar nuk garantohet nga dispozitat e Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së dhe mbetet e papaguar për të paktën tridhjetë (30) ditë pas ditës së kërkueshme,

Banka Huadhënëse, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar MOF-së, mund të:

a) deklarojë Paradhëniet të jenë të kërkueshme dhe pagueshme menjëherë (dhe kjo bëhet e pagueshme së bashku me interesin e mbledhur dhe çdo shumë tjetër që detyrohet MOF-ja sipas kësaj);

b) deklarojë Paradhëniet të jenë të kërkueshme dhe të pagueshme me kërkesën e Bankës Huadhënëse; ose

c) kërkojë që MOF-a të bëjë përpjekjet më të mira për të realizuar që detyrimet e Bankës Huadhënëse sipas Letrës së Kredisë të shkojnë në zero brenda pesë Ditëve Pune nga një njoftim i tillë dhe/ose kërkojë MOF-së të realizojë një depozitë monetare në Euro të bllokohet ose garantohet në favor të dhe me termat dhe kushtet e pranueshme për Bankën Huadhënëse dhe IBRD-në, në një shumë dhe periudha të përcaktuara nga Banka Huadhënëse deri në Shumën e Letrës së Kredisë herë pas here (dhe MOF-ja e bën këtë).

10.13 Nëse, në pajtim me Klauzolën 10.12(b), Banka Huadhënëse i deklaron Paradhëniet të jenë të kërkueshme dhe të pagueshme me kërkesë të Bankës Huadhënëse, në atë moment dhe kurdoherë pas kësaj, Banka Huadhënëse me njoftim me shkrim mund t'i kërkojë MOF-së shlyerjen e Paradhënieve në atë datë që mund të përcaktohet në një njoftim të tillë (dhe pas kësaj kjo bëhet e kërkueshme dhe e pagueshme në atë datë së bashku me interesin e mbledhur dhe shumat e tjera që detyrohet MOF-ja sipas kësaj) ose të tërheqë deklaratën e sj me efekt nga kjo datë që mund të përcaktojë në këtë njoftim.

11. Llogaritja dhe vërtetimet

11.1 Çdo vërtetim ose përcaktim nga Banka Huadhënëse (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, çdo Njoftim të Kërkesës së Fundit) të një norme ose shume sipas kësaj Marrëveshjeje ose Letre Kredie ose për ndonjë datë pagese nga MOF-ja, në mungesë të gabimeve të dukshme, janë

prova përfundimtare për çështjet me të cilat ka të bëjë.

11.2 Pa cenuar Klauzolën 11.1, Banka Huadhënëse në paraqitjen e një pretendimi sipas Klauzolës 5.1 përdor përpjekjet e arsyeshme për të mbështetur këtë pretendim me provat e shumës së pretenduar dhe, sipas rastit, faturat si dhe çdo dokument shoqërues të arsyeshëm, me kusht që asgjë nuk e detyron Bankën Huadhënëse të deklarojë këtë informacion (ose pjesë të këtij informacioni) në masën që ky informacion është tatimor sensitiv, ligjërisht i privilegjuar, konfidencial ose nëse për këtë deklaram është ose pritet në mënyrë të arsyeshme të mund të ngrihet padi nga një palë tjetër (dhe një vërtetim për këtë qëllim nga Banka Huadhënëse, në mungesë të mashtrimit ose gabimi të dukshëm, përbën prove përfundimtare për këtë çështje). Detyrimet e MOF-së për të paguar një shumë të përmendur në Klauzolën 5.1 interpretohet e pavarur dhe jo e kushtëzuar nga kërkesa e Bankës Huamarrëse për të dhënë këtë provë dhe dokumentet shoqëruese.

12. Njoftimet

Të gjitha njoftimet ose komunitet e tjera që duhet të jepen ose bëhen sipas kësaj Marrëveshjeje bëhen në Anglisht dhe me shkrim, drejtohen në vëmendje të personave të treguar më poshtë dhe dorëzohen personalisht ose dërgohen me korrier ose faks.

MOF-ja:³

[•]

Faks: [•]

Drejtuar: [•]

për dijeni IBRD:

Zëvendëspresidentit për Evropën dhe Azinë Qendrore

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Facsimile: +1 202-522-2758

dhe

Menaxherit (Njësia e Financave dhe Garancive)

Departamenti i Ekonomisë Financiare dhe Urban (FEU)

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Facsimile: +1 202 522 0761

Banka Huadhënëse:⁴

Citibank Europe plc, Zyra e Degës në Hungari

[•]

Faks: [•]

Drejtuar: [•]

Përveç kur parashikohet ndryshe, të gjitha njoftimet dhe komunikimet konsiderohen të dorëzuara (i) kur dorëzohen me dorë ose me korrier brenda ditës; (ii) nëse merren në një Ditë Pune për palën marrëse, nëse transmetohen me faks në numrin e faksit të palës marrëse dhe, (iii) nëse merret pas orarit zyrtar ose në një ditë që nuk është Ditë Pune për palën marrëse, në Ditën e Punës pasuese të palës marrëse pas datës së transmetimit me faks në numrin e faksit të palës marrëse. Çdo njoftim i bërë me faks konfirmohet me shkrim, jepet personalisht ose dërgohet me korrier ose me faks të porositur.

³ Shënim: Duhet të jepet informacioni i kontaktit

⁴ Shënim: Duhet të jepet informacioni i kontaktit

Secila Palë ose IBRD-ja mund të ndryshojë adresën, të adresuarin dhe/ose numrin e faksit me njoftim ku duhet të dërgohen ose postohen njoftimet dhe komunikimet. Këto ndryshime të adresës, të të adresuarit dhe/ose numër faksi hyn në fuqi 10 Ditë pune pas dorëzimit të njoftimit në pajtim me këtë Klauzolë 12.

Çdo komunikim ose dokument që duhet të bëhet ose dorëzohet në Bankën Huadhënëse hyn në fuqi vetëm pasi të jetë marrë efektivisht nga Banka Huadhënëse dhe vetëm nëse është shënuar shprehimisht në vëmendjen e departamentit ose punonjësit të përcaktuar më sipër (ose një departamenti apo punonjësi zëvendësues që përcaktohet nga Banka për këtë qëllim).

13. Fuqia e marrëveshjes

13.1 Kjo Marrëveshje është si shtesë dhe nuk cenohet nga asnjë e drejtë tjetër, mjet mbrojtës, rëndim me barrë që Banka Huadhënëse mund të ketë ose mbajë për ndonjë nga detyrimet e MOF-së sipas kësaj Marrëveshjeje.

13.2 Kjo Marrëveshje mbetet plotësisht në fuqi si një detyrim i vazhduar i MOF-së (pavarësisht nga ndonjë zgjidhje e përkohshme e llogarive) deri sa Banka Huadhënëse të jetë shlyer plotësisht dhe përfundimisht për të gjitha shumat e paguara nga Banka Huadhënëse Përfituesit sipas Letrës së Kredisë plus interesat dhe shumat e tjera, nëse ka, të pagueshme në pajtim me këtë Marrëveshje dhe detyrimet e Bankës Huadhënëse sipas Letrës së Kredisë dhe detyrimet e Bankës Huadhënëse sipas Letrës së Kredisë të kenë mbaruar.

13.3 Çdo lirim, zgjidhje, përmbushje ndërmjet Palëve nuk kushtëzohet me garanci, disponim apo mënjanimin, zvogëlimin, anashkalimin, bërjen të pa realizueshme ose dhënie të mëvonshme të një pagesë që i bëhet ose i jepet Bankës Huadhënëse për shkak të një dispozite, kërkesë, miratimi, qoftë për shkak të falimentimit, paaftësisë paguese likuidimit ose tjetër që është në fuqi në çdo kohë ose për shkak të një detyrimi për t'i dhënë fuqi një preference ose detyrimi.

14. Heqja dorë dhe mjetet e mbrojtjes

14.1 Kjo Marrëveshje nuk mund të modifikohet përveç se me shkrim të nënshkruar nga të dy Palët dhe me pëlqimin e IBRD-së në pajtim me termat e Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së.

14.2 Mosushtimi nga Banka Huadhënëse i ndonjë të drejte apo vonesa në ushtimin e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje apo ndryshe nuk është heqje dorë nga këto të drejta dhe asnjë heqje dorë e vetme ose e pjesshme nga ndonjë prej këtyre të drejtave nuk përjashton ndonjë ushtim tjetër ose të mëtejshëm të ndonjë prej tyre. Të drejtat e Bankës Huadhënëse sipas kësaj Marrëveshjeje janë kumulative dhe nuk përjashtojnë asnjë prej të drejtave që parashikohen në ligj.

14.3 Secila prej dispozitave që gjenden në këtë Marrëveshje janë të ndashme dhe të dallueshme nga njëra tjetra dhe, nëse kurdoherë një prej tyre bëhet e pavlefshme, e paligjshme ose e paekzekutueshme, vlefshmëria, ligjshmëria dhe ekzekutueshmëria e secilës prej dispozitave që mbeten në këtë Marrëveshje nuk ndikohen, cenohen apo kufizohen.

15. Transferimi dhe konfidencialiteti

15.1 MOF-ja nuk mund të shesë, delegojë transferojë, premtojë, negociojë, japë pjesëmarrje apo disponojë ndryshe për të gjitha dhe ndonjë prej të drejtave ose përfitimeve sipas kësaj Marrëveshjeje.

15.2 Banka Huadhënëse mund:

15.2.1 mund të transferojë çdo të drejtë të saj; ose

15.2.2 transferojë nëpërmjet zëvendësimit ose detyrimeve të saj,

sipas kësaj Marrëveshjeje tek një bankë tjetër ose institucion financiar ose fond besimi, fond ose subjekt tjetër që është i përfshirë rregullisht ose themeluar për qëllimin e bërjes, blerjes ose investimit të huave, letrave me vlerë ose sende të tjera pasurore financiare.

15.3 Pëlqimi paraprak i MOF-së (që nuk mbahet ose vonohet në mënyrë jo të arsyeshme) kërkohet për çdo transferim ose delegim nga Banka Huadhënëse përveç kur:

15.3.1 delegimi ose transferimi bëhet tek një filial tjetër i Bankës Huadhënëse;

15.3.2 bëhet në një kohë kur po vazhdon Ngjarja e Qenies në Vonesë; ose

15.3.3 (Banka Huadhënëse po delegon ose transferon çdo të drejtë dhe/ose detyrim në rrethanat e parashikuara në Nenin 4.4(b) të Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së).

MOF-ja konsiderohet të ketë dhënë pëlqimin e saj 5 Ditë Pune pas marrjes nga MOF-ja faktikisht ose të konsideruar të një kërkesë të tillë nga Banka Huadhënëse, përveç kur kjo kërkesë refuzohet shprehimisht nga MOF-ja me arsye thelbësore brenda atij afati. Për mënjanimin e dyshimit, Banka Huadhënëse mund të hyjë në çdo nën-pjesëmarrje në lidhje me çdo transaksion sipas të cilit duhet të bëhen pagesa duke iu referuar kësaj Marrëveshje ose MOF-së, pa pëlqimin e MOF-së.

15.4 Në masën më të plotë të lejuar nga ligji, çdo palë të cilës Banka Qendrore i shet, delegon, transferon ose ndryshe disponon të drejtat ose përfitimet sipas kësaj Marrëveshjeje ka të drejtë të gëzojë të gjitha të drejtat dhe privilegjet e Bankës Huadhënëse sipas kësaj Marrëveshjeje në lidhje me pjesën e dhënë asaj.

15.5 Banka Huadhënëse mund t'i deklarojë çdo personi:

15.5.1 të cilit (ose nëpërmjet të cilit) Banka Huadhënëse i delegon ose transferon (ose mund të delegojë ose transferojë) të gjitha ose një prej të drejtave, përfitimeve dhe detyrimeve;

15.5.2 të cilit (ose nëpërmjet të cilit) Banka Huadhënëse hyn (ose mund të hyjë) në një nën-pjesëmarrje në lidhje me ndonjë transaksion sipas të cilit duhet të bëhen pagesat duke iu referuar kësaj Marrëveshjeje ose MOF-së ose që investon drejtpërdrejt ose jo në këtë nën-pjesëmarrje ose transaksion të tillë;

15.5.3 sipas ose në lidhje me një skemë garantimi ose skemë për lëshimin e letrave me vlerë të garantuara me kolateral, detyrimet e borxhit ose një skemë tjetër çdo personi për çdo qëllim në lidhje me Dokumentet Financiare;

15.5.4 nëse kërkohet nga IBRD-ja ose nga kushtet e Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së (duke përfshirë vetë IBRD-në);

15.5.5 të cilit duhet t'i deklarohet informacioni sipas një ligji ose akti nënligjor të zbatueshëm ose kërkesë të një agjencie qeveritare sipas së cilës palës i kërkohet e ka praktikë veprimi;

15.5.6 nëse kërkohet që kjo të bëhet me urdhër gjykatë me juridiksion kompetent qoftë edhe në zbatim të një procedure për zbulimin e dokumenteve apo tjetër;

15.5.7 nëse kjo kërkohet nga një autoritet qeveritar, bankar ose tatimor apo juridiksion kompetent; ose

15.5.8 nëse kërkohet nga auditorët ose këshilltarët ligjorë ose profesionistë të tjerë, atë informacion në lidhje me MOF-në dhe Dokumentet Financiare që Banka Huadhënëse e konsideron të përshtatshme.

16. Kompensimi

Banka Huadhënëse mund të kompensojë çdo detyrim të maturuar që i kërkohet MOF-së sipas Dokumenteve Financiare (në masën që është në pronësi të Bankës Huadhënëse si përfitim) kundrejt çdo detyrimi të maturuar që Banka Huamarrëse i detyrohet MOF-së, pavarësisht vendit të pagesës, degës së rezervimit, monedhës së detyrimit tjetër. Nëse detyrimet janë në monedha të ndryshme, Banka Huadhënëse mund të konvertojë secilin detyrim me normën e tregut të këmbimit në ushtrim normal të biznesit për qëllimin e kompensimit.

17. Kopjet

Kjo Marrëveshje mund të përfundohet në çdo numër kopjes, secila prej tyre ka të njëjtin efekt sikur nënshkrimet në kopje të ishin në një kopje të vetme të Marrëveshjes.

18. Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në pajtim me ligjin anglez.

19. Arbitrazhi

19.1 Në pajtim me Klauzolën 19.4, çdo mosmarrëveshje që rrjedh ose është në lidhje me këtë Marrëveshje (duke përfshirë një mosmarrëveshje në lidhje me detyrimet jo-kontraktore që rrjedhin ose janë në lidhje me këtë Marrëveshje ose një mosmarrëveshje në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose prishjen e kësaj Marrëveshjeje ose të pasojave të pavlefshmërisë së saj) ("Mosmarrëveshje") i referohet dhe zgjidhet përfundimisht me arbitrazh sipas Rregullave të Arbitrazhit të LCIA-s (Gjykata e Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar).

19.2 Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një arbitër i vetëm, selia e arbitrazhit është në Londër, Angli, he gjuha e arbitrazhit është gjuha angleze.

19.3 Për qëllimet e arbitrazhit në pajtim me këtë Klauzolë 19 (Arbitrazhi), Palët heqin dorë nga çdo e drejtë aplikimi për të përcaktuar një çështje ligjore ose të bëjnë ankim për një çështje ligjore sipas Seksioneve 45 dhe 69 të Ligjit të Arbitrazhit 1996.

19.4 Para se Banka Huadhënëse të ketë bërë një Kërkesë për Arbitrazh apo Përgjigje sipas përkufizimit në Rregullat e Arbitrazhit të LCIA (sipas rastit), Banka Huadhënëse me njoftim me shkrim drejtuar MOF-së, mund të kërkojë që të gjitha Mosmarrëveshjet ose një Mosmarrëveshje e caktuar të dëgjohet nga një gjykatë e zakonshme. Nëse Banka Huadhënëse bën një njoftim të tillë, Mosmarrëveshja të cilës i referohet njoftimit vendose në pajtim me Klauzolën 20 (Juridiksioni).

20. Juridiksioni

20.1 Në rast se Banka Huadhënëse nxjerr një njoftim në pajtim me Klauzolën 19.4, zbatohen dispozitat e kësaj Klauzole 20 (Juridiksioni).

20.2 Në pajtim me 20.3, Gjykatat e Anglisë kanë juridiksion ekskluziv për të zgjidhur çdo Mosmarrëveshje. Palët bien dakord që Gjykatat e Anglisë janë gjykatat më të përshtatshme dhe të duhura për të zgjidhur çdo Mosmarrëveshje dhe asnjë Palë nuk do të argumentojë të kundërtën.

20.3 Klauzola 20.2 është vetëm për përfitimin e Bankës Huadhënëse. Kështu dhe pavarësisht na Klauzola 20.2, Banka Huadhënëse mund të fillojë gjykim në lidhje me një Mosmarrëveshje në çdo gjykatë tjetër me juridiksion. Në masën që lejohet nga ligji, Palët Financiare mund të fillojnë gjykime të njëkohshme në disa juridiksione.

20.4 Pa cenuar ndonjë mënyrë tjetër për dorëzimin e padisë të lejuar sipas nj ligji përkatës, MOF-ja

20.4.1 emëron në mënyrë të pakthyeshme Clifford Chance Secretaries Limited of 10 Upper Bank Street, London E14 5JJ si agentin e tyre për dorëzimin e padisë në lidhje me një gjykim para gjykatave angleze në lidhje me çdo Dokument Financiar ku ajo është palë; dhe

20.4.2 bie dakord që mosnjoftimi i padisë tek MOF-ja nga agjenti nuk zhvlerëson gjykimin përkatës.

20.5 Në lidhje me çdo Dokument Financiar ku ajo është palë, MOF-ja (në masën më të gjerë të lejuar nga ligji) në mënyrë të pakthyeshme dhe pa kusht:

20.5.1 heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti (sovrانيتeti apo tjetër) nga juridiksioni i një gjykate, kompensimi ose proces ligjor dhe heq dorë nga çdo e drejtë gjykimi me juri;

20.5.2 heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që ajo ose sendet e saj pasurore kanë ose mund të përftojnë në lidhje me një gjykim të filluar ndaj saj ose sendet e saj pasurore në lidhje me një Dokument Financiar nga Banka Huadhënëse;

20.5.3 bie dakord që asnjë imunitet nga këto gjykime (që konsiderohen të përfshijnë pa kufizim padinë, sekuestrimin para gjykimit, sekuestrime të tjera, marrjen e vendimit, zbatimin dhe ekzekutime të tjera) nuk do të pretendohet nga ose në emër të saj ose në lidhje me sendet e saj pasurore; dhe

20.5.4 bie dakord në përgjithësi në lidhje me këto gjykime për dhënien e mbrojtjes ose çështjen e çdo padije në lidhje me këtë gjykim duke përfshirë pa kufizim bërjen, zbatimin ose ekzekutimin ndaj çdo pasurie (pavarësisht nga përdorimi ose përdorimi i destinuar) të çdo urdhri ose vendimi që mund të bëhet ose jepet në këto gjykime.

Në dëshmi të kësaj, nënshkrimi i përfaqësuesve të autorizuar rregullisht të palëve, në ditën dhe vitin e shkruar më sipër.

ANEKSI A
FORMULARI I LETRËS SË KREDISË
[Versioni përfundimtar i Letrës së Kredisë duhet të futet.]

ANEKSI B
FORMULARI I GARANCISË SË IBRD-SË
[Versioni final i garancisë së IBRD-së të futet këtu]

ANEKSI C
NJOFTIMI I KËRKESËS SË FUNDIT

[Datë]

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë

KËRKESA E FUNDIT PËR PAGESË

MOF-ja dhe ne, Banka Huadhënëse, jemi palë në Marrëveshjen e Riimbursimit dhe Kredisë datë (-) 2009 (“Marrëveshja e Riimbursimit dhe Kredisë”). Termat me Germa kapitale të përdorura por që nuk janë përkufizuar këtu kanë kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Riimbursimit dhe Kredisë.

Më (-), është dhënë një parapagim dhe nuk është riimbursuar akoma plotësisht nga MOF-ja. Shuma e mbetur e kësaj Paradhënieje është (-) Euro. Kjo shumë ka qenë e mbetur qysh prej 11 muajsh. Nëpërmjet kësaj u kërkojmë që të bëni pagesën e kësaj shume së bashku me interesin e mbledhur të saj dhe që ka mbetur i papaguar më ose para (-) që është edhe përvjetori i parë i datës së kësaj Paradhënieje. Ne u kujtojmë që pas këtij përvjetori ne mund të kemi të drejtën sipas Marrëveshjes së Garancisë së IBRD_së të marrim pagesën drejtpërdrejt nga IBRD-ja për shumën e kësaj Paradhënieje që ka mbetur kë atë datë.

Citibank Europe plc, Zyra e Degës në Hungari

Më: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Për dijeni: IBRD

GRAFIKU 1 FORMULA E SHPENZIMEVE TË DETYRUESHME

1. Shpenzimet e Detyrueshme i shtohen normës së interesit për të kompensuar Bankën Huadhënëse për shpenzimet e përmbushjes së kërkesave të Bankës Qendrore Evropiane.

2. Në datën e dhënies së një Paradhënieje të tillë dhe në çdo Datë të Pagesës së Interesit (ose sapo të jetë e mundur pas kësaj) Banka Huadhënëse llogarit, si një normë përqindjeje në vit, një normë (“Shpenzimet e Detyrueshme”) për Bankën Huadhënëse në pajtime paragrafët e mëposhtëm⁵.

3. Shpenzimet e Detyrueshme do të jetë përcaktimi i shpenzimeve të arsyeshme për Bankën Huadhënëse për të përmbushur kërkesat e rezervës minimale të Bankës Qendrore Evropiane (ose një autoritet tjetër që zëvendëson të gjithë ose një prej funksioneve të saj) në lidhje me shumën e përgjithshme të Paradhënieve në datën e llogaritjes.

4. Çdo përcaktim nga Banka Huadhënëse në pajtim me këtë Grafik në lidhje me Shpenzimet e Detyrueshme dhe çdo shumë e pagueshme Bankës Huadhënëse, në mungesë të gabimit të dukshëm, është përfundimtar dhe detyrues për Palët.

5. Banka Huadhënëse herë pas here, pas konsultimeve me MOF-në, mund të përcaktojë dhe njoftojë MOF-në për çdo ndryshim që kërkohet të bëhet në këtë Grafik me qëllim që të përmbushë çdo ndryshim në ligj, akt nënligjor ose kërkesë që vendoset herë pas here nga Banka Qendrore Evropiane (ose një autoritet tjetër që zëvendëson të gjithë ose një prej funksioneve) ose autoritet tjetër i zbatueshëm në lidhje me Paradhëniet e dhëna prej saj dhe çdo përcaktim i tillë, në mungesë të gabimit të dukshëm, është përfundimtar dhe detyrues për palët.

⁵ Shënim: Këshilltari hungarez të sqarojë nëse është përcaktuar një formulë në bazë të Tarifave të Zbatueshme.

GRAFIKU 2 PARAKUSHTET

1. Në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën Huadhënëse, kopje të firmosura të:
 - a) kësaj Marrëveshjeje; dhe
 - b) çdo Dokumenti tjetër Financiar (të ndryshëm nga Letra e Kredisë);me kusht që nëse kjo Marrëveshje nuk firmoset në emër të MOF-së nga Ministri Shqiptar i Financave, një kopje e vërtetuar e urdhrat të Këshillit të Ministrave që autorizon një përfaqësues të emëruar për të ekzekutuar Marrëveshjen në emër të Ministrisë së Financave.
2. Një vërtetim të nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë që përcakton emrin e plotë, pozicionin dhe firmën e përfaqësuesit të Ministrisë së Financave të autorizuar për të nënshkruar dhe dhënë Dokumentet Financiare dhe çdo dokument tjetër që duhet të jepet në pajtim me të dhe që vërteton se çdo kopje dokumenti në lidhje me të, që është përcaktuar në Grafiku 2 është i saktë, i plotë dhe me fuqi të plotët në datën jo më parë se data e kësaj Marrëveshjeje.
3. Një vërtetim të nënshkruar nga (-) që përcakton emrin e plotë, pozicionin dhe firmën e përfaqësuesit të IBRD-së të autorizuar të nënshkruajë dhe japë Marrëveshjen e Garancisë së IBRD-së.
4. Një vërtetim të nënshkruar nga një drejtor i Përfituesit që konfirmon që (në datën e këtij vërtetimi, që nuk është më parë se data e kësaj Marrëveshjeje), nuk ka ndodhur asnjë rrethanë brenda Nenit 4.1(b), (c), (d) ose (e)] të Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së (në rastin e fundit nëse zbatohet për Përfituesin).
5. Një certifikatë të nënshkruar nga një drejtor i CEZ a.s. që konfirmon që (në datën e këtij vërtetimi, që nuk është më parë se data e kësaj Marrëveshjeje), nuk ka ndodhur asnjë rrethanë brenda Nenit 4.1 (e) të Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së (nëse zbatohet për të).
6. Marrja nga Banka Huadhënëse prej IBRD-së të një njoftimi të nënshkruar rregullisht për efektivitetin në pajtim me Nenin 9.1 (Parakushtet e Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së) të Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së.
7. Një mendim të Ministrit të Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë⁶ në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën Huadhënëse.
8. Një mendim të Boga & Associates, këshilltar shqiptar i Bankës Huadhënëse në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën Huadhënëse.
9. Një mendim të Clifford Chance LLP, avokatë anglezë për Bankën Huadhënëse, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën Huadhënëse.
10. Prova që Clifford Chance Secretaries Limited ka rënë dakord të veprojë si agjent i MOF-së për dorëzimin e padisë në Angli (shpenzimi për këtë emërim është në llogari të MOF-së).
11. Prova që tarifat, kostoja dhe shpenzimet të kërkueshme nga Banka Huadhënëse prej MOF-së ose Përfituesit në pajtim me një Dokument Financiar janë paguar ose do të paguhet në Datën e Dhënies.
12. Një kopje e nënshkruar e Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Garancisë së IBRD-së).
13. Një kopje të çdo dokumenti, marrëveshjeje, instrumenti, ligji, dekreti, kontrolli, leje, miratimi, licence, aprovimi, regjistrimi ose deklarimi që Banka Huadhënëse e konsideron të nevojshme për ta bërë këtë Marrëveshje të ligjshme, të vlefshme, detyruese dhe të ekzekutueshme, për ta bërë këtë marrëveshje të pranueshme në prova dhe/ose mundësuar MOF-së për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje.
14. Një kopje të çdo dokumenti, marrëveshjeje, instrumenti, ligji, dekreti, kontrolli, leje, miratimi, licence, aprovimi, regjistrimi ose deklarimi që Banka Huadhënëse e konsideron të

⁶ Shënim: Kjo duhet të mbulojë edhe prokurimin publik

nevojshme për të bërë Dokumentet Financiare të ligjshme, të vlefshme, detyruese dhe të ekzekutueshëm, për të bërë Dokumentet Financiare të pranueshëm në prova, dhe/ose mundësuar Përfituesit të përmbushë detyrimet sipas Dokumenteve Financiare ku ajo është palë.

MINISTRIA E FINANCAVE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DUKE VEPRUAR NË EMËR
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nënshkruar nga: [•]
Emri: [•]
Pozicioni: [•]

CITIBANK EUROPE PLC, ZYRA E DEGËS NË HUNGARI

Nënshkruar nga: [•]
Emri: [•]
Pozicioni: [•]

Nënshkruar nga: [•]
Emri: [•]
Pozicioni: [•]

[Në Krye të Letrës së Bankës Huadhënëse]

LETËR ZËVENDËSUESE E KREDISË

NUMËR: [•]

LËSHUAR: [•] 2009

Drejtuar: Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SHA (OSSH) ("Përfituesi")
I dashur Zotëri/Zonjë,

Letër Zëvendësuese Kredie

Me kërkesë të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë ("**Kërkuesi**"), ne, Citibank Europe plc, Zyra e Degës në Hungari ("**Banka Huadhënëse**") nxjerrim këtë Letër Zëvendësuese Kredie ("**Letër Kredie**") në favor tuaj si Përfitues.

1. Përkufizime dhe Interpretime

Termat me germa kapitale që përdoren por nuk përkufizohen në këtë Letër Kredie, kanë kuptimet e shprehura më poshtë:

"**Ditë Pune**" është çdo ditë në të cilën bankat janë të hapura për punën e zakonshme në Tiranë dhe Budapest dhe që është një Ditë TARGET.

"**Euro**" ose "**EUR**" është monedha e ligjshme e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian që aplikojnë monedhën e vetme në pajtim me Traktatin themelues të Komunitetit Evropian, të ndryshuar nga Traktati për Bashkimin Evropian.

"**Ngjarje e Pushimit të Fuqisë**" është një nga ngjarjet e treguara në Klauzolën 5 (*Ngjarje të Pushimit të Fuqisë*).

"**IBRD**" është Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

"**Marrëveshje e Garancisë e IBRD-së**" është marrëveshja e datës ose rreth datës së kësaj Letre Kredie ndërmjet IBRD-së dhe Bankës Huadhënëse, në bazë të së cilës IBRD-ja ka rënë dakord t'i japë Bankës Huadhënëse garanci pa kusht dhe me risk të pjesshëm të pakthyeshëm që mbulon principalin dhe shlyerjet e interesit që nuk është shlyer nga Kërkuesi sipas Marrëveshjes së Riimbursimit dhe Kredisë.

"**Marrëveshja e Riimbursimit dhe Kredisë**" është marrëveshja e datës ose rreth datës së kësaj Letre Kredie ndërmjet Kërkuesit dhe Bankës Huadhënëse në lidhje me paradhëniet e dhëna Përfituesit sipas kësaj Letre Kredie.

"**TARGET2**" është sistemi i pagesave Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer që përdor një platformë të vetme dhe që ka nisur më 19 nëntor 2007.

"**Dita TARGET**" është dita në të cilën TARGET2 është i hapur për kryerjen e pagesave në Euro.

2. Shuma e Letrës së Kredisë

Kjo Letër Kredie lëshohet në një shumë deri në 60 000 000 Euro dhe kjo shumë mund të ulet në pajtim me termat e kësaj Letre Kredie ("**Shuma e Deklaruar**").

Shuma e Deklaruar, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Letër Kredie, ulet herë pas here në pajtim me Klauzolën 8.

Banka Huadhënëse nuk do të jetë e detyruar të bëjë një pagesë sipas kësaj Letre Kredie nëse si rezultat total ii të gjitha pagesave të bëra sipas kësaj Letre Kredie do të tejkalonte Shumën e Deklaruar. Banka Huadhënëse informon Përfituesin brenda tre Ditëve të Punës nga marrja e kërkesës me shkrim nga Përfituesi për balancën e Shumës së Deklaruar në atë datë, **me kusht që kjo kërkesë nuk mund të bëhet nga Përfituesi më shumë se një herë në muaj.**

Në pajtim me kushtet e kësaj Letre Kredie, Banka Huadhënëse i respekton kërkesat sipas kësaj Letre Kredie sipas radhës së marrjes, në pajtim me parimin “kush vjen i pari, merr shërbimin i pari”.

3. **Fuqia e Letrës së Kredisë**

Kjo Letër Kredie është në fuqi dhe e zbatueshme vetëm pasi Banka Huadhënëse njofton Përfituesin, në formën e Aneksit G, për dijeni drejtuar Kërkuesit dhe IBRD-së, që:

- (i) Data e Hyrjes në Fuqi (sipas përkufizimit në Marrëveshjen e Garancisë së IBRD-së) ka ndodhur;
- (ii) Data e Hyrjes në Fuqi (sipas përkufizimit në Marrëveshjen e Riimbursimit dhe Kredisë) ka ndodhur; dhe
- (iii) kësti i tarifave që paguhet sipas paragrafit 2(a) dhe kësti i parë semestral i tarifave që paguhet sipas paragrafit 2(b)(i) të letrës së datës (-) 2009 dhe të bërë ndërmjet Bankës Huadhënëse dhe Përfituesit që përcakton tarifat që duhet t'i jepen Bankës Huadhënëse në lidhje me këtë Letër Kredie (“**Letra e Tarifave**”) (por jo pjesa e mbetur e këtyre tarifave semestrale që janë të pagueshme në datat e parashikuara në paragrafin 2(b)(ii) të Letrës së Tarifave) dhe kostoja dhe shpenzimet e pagueshme sipas paragrafit 5 të Letrës së Tarifave janë paguar,

(data e përcaktuar në këtë njoftim nga Banka Huadhënëse është “**Data e Hyrjes në Fuqi**”), me kusht që nëse Data e Hyrjes në Fuqi nuk ka qenë deri më 15 qershor 2009, kjo Letër Kredie skadon menjëherë dhe automatikisht.

4. **Skadimi i natyrshëm i Letrës së Kredisë**

Kjo Letër Kredie është e ekzekutueshme nga Data e Hyrjes në Fuqi dhe skadon në orën 4 pas dite (CET) me 2 mars 2015 (“**Data e Skadimit**”), përveç kur është prishur më parë me ndodhinë e Ngjarjes së Pushimit të Fuqisë ose sipas dispozitave të Klauzolës 3 (*Fuqia e Letrës së Kredisë*).

5. **Ngjarjet e Pushimit të Fuqisë**

Kjo Letër Kredie pushon menjëherë së qeni në fuqi nëse kjo Letër Kredie dorëzohet nga Përfituesi tek Banka Huadhënëse, shoqëruar me një certifikatë në formën e Aneksit E, dhe pushon se qeni në fuqi menjëherë pasi Banka Huadhënëse njofton Përfituesin, në formën e Aneksit I, dhe për dijeni Kërkuesit dhe IBRD-së për ndodhinë e një prej dy Ngjarjeve të mëposhtme të Pushimit të Fuqisë:

- (a) tarifat e kërkueshme nga Banka Huadhënëse në pajtim me këtë Letër Tarife nuk janë paguar kur bëhen të kërkueshme dhe mbeten të papaguara për më shumë se tridhjetë ditë pas marrjes nga Përfituesi të një njoftimi nga Banka Huadhënëse që këto tarifa nuk janë paguar në datat e zbatueshme të parashikuara në Klauzolën 3 (iii); ose
- (b) Marrëveshja e Garancisë e IBRD-së pushon së qeni plotësisht në fuqi, për një shkak tjetër nga mashtrimi, neglizhenca e hapur ose qenie në vonesë të qëllimshme nga Banka Huadhënëse.

6. **Kërkesat sipas Letrës së Kredisë**

6.1 Në pajtim me Klauzolën 3 (Fuqia e Letrës së Kredisë) dhe kjo Klauzolë 6, në mungesë të gabimit të dukshëm, të njoftuar dhe përshkruar nga Banka Huadhënëse Përfituesit, fondet sipas kësaj Letre Kredie janë të disponueshëm nëpërmjet paraqitjes dhe dorëzimit tek në nga Përfituesi të:

- (a) një kërkesë, me datën e paraqitjes tek Banka Huadhënëse, në formën e Aneksit A të parashikuar për t’u nënshkruar nga një nënshkrues i autorizuar i Përfituesit që bën një kërkesë dhe që ka dokumentet e përcaktuara në të; ose
- (b) një kërkesë, me datën e paraqitjes tek Banka Huadhënëse, në formën e Aneksit B të parashikuar për t’u nënshkruar nga një nënshkrues i autorizuar i Përfituesit që bën një kërkesë dhe që ka dokumentet e përcaktuara në të; ose

- (c) një kërkesë, me datën e paraqitjes tek Banka Huadhënëse, në formën e Aneksit C të parashikuar për t'u nënshkruar nga një nënshkrues i autorizuar i Përfituesit që bën një kërkesë dhe që ka dokumentet e përcaktuara në të, (secila prej sa më sipër, "**Kërkesë**").
- 6.2 Fondet sipas kësaj Letre Kredie nuk janë të disponueshëm dhe Banka Huadhënëse nuk ka detyrim të bëjë pagesa në lidhje me një Kërkesë të marrë (në momentin e marrjes ose më vonë në rast se fondet bëhen përsëri të disponueshëm) nëse:
- (a) Data e Hyrjes në fuqi nuk ka ndodhur;
 - (b) Banka Huadhënëse ka marrë një njoftim nga IBRD-ja në pajtim me Nenin 4.1 paragrafi (b) deri dhe duke përfshirë (e) ose Nenin 4.4 të Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së dhe nuk ka marrë ndonjë njoftim të mëvonshëm nga IBRD-ja, në lidhje me këtë njoftim, në pajtim me Nenin 4.2 të Marrëveshjes së Garancisë së IBRD-së;
 - (c) tarifat e kërkueshme nga Banka Huadhënëse në pajtim me Letrën e Tarifës nuk janë paguar kur janë bërë të kërkueshme dhe mbeten të papaguara në datën që bëhet Kërkesa si më sipër; ose
 - (d) një Kërkesë merret nga Banka Huadhënëse pas Datës së Skadencës ose kur fuqia e kësaj Letre Kredie pushon ndryshe.
- 6.3 Detyrimi i Bankës Huadhënëse për të paguar sipas kësaj Letre Kredie konsiderohet të jetë i përmbushur nëse pagesa bëhet nga Banka Huadhënëse ose një filial apo degë. Çdo kërkesë origjinale së bashku me katër kopje të dokumenteve të përcaktuara në të duhet të na paraqiten në orën 11 para dite (CET) në zyrat tona në (-), në vëmendje të (-) (ose në një zyrë tjetër që Banka Huadhënëse mund të njoftojë Përfituesin) në një Ditë Pune dhe çdo kërkesë duhet të shoqërohet me prova të pranueshme për Bankën Huadhënëse për autoritetin e nënshkruesit për të nënshkruar një Kërkesë të tillë në emër të Përfituesit (një vërtetim origjinal i lëshuar nga një person i parashikuar si punonjës i Përfituesit duke bashkangjitur një kopje të pjesës së saktë, të vërtetë dhe të përditësuar në gjuhën angleze nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Shqipërisë që tregon që firmatarët e Kërkesës janë drejtorë të ligjshëm të Përfituesit, së bashku me një ekzemplar të firmës së këtyre drejtorëve, për këto qëllime, konsiderohen prova të pranueshme).
- 6.4 Shuma e çdo Kërkesë të dhënë nga Përfituesi tek Banka Huadhënëse do të jetë jo më pak se 100 000 Euro. Kërkesat e respektuara prej nesh sipas kësaj Letre Kredie nuk do të kalojnë 60 000 000 Euro dhe kjo shumë mund të ulet në pajtim me Klauzolën 8. Vetëm një tërheqje sipas kësaj Letre të Kredisë mund të lejohet në çdo periudhë 15 ditore dhe pagesa sipas një ose më shumë Kërkesave është vetëm kundrejt dokumenteve që përputhen tërësisht në të gjitha aspektet me kërkesat, në kuptimin e formularëve të tyre që përcaktohen në Aneksin e këtushëm.
- 6.5 Nëse shuma e parashikuar në Kërkesën e dhënë nga Përfituesi Bankës Huadhënëse është më e ulët se shuma e parashikuar në njoftimin e pretendimit të bashkangjitur kërkesës, ky nuk është gabim i dukshëm dhe Banka Huadhënëse detyrohet vetëm të paguajë shumën e kërkuar dhe jo shumën e parashikuar në njoftimin e pretendimit.
- 6.6 Në rastin e një pagese nga Banka Huadhënëse sipas kësaj Klauzole 6, Banka Huadhënëse paraqet një Njoftim për Tërheqjen në formën e Aneksit D tek Kërkuesi (dhe për dijeni Përfituesit dhe IBRD-së) brenda pesë Ditëve të Punës nga një pagesë e tillë.
7. **Pagesa**
 Secila prej kërkesave tuaja të tërhequra dhe të pagueshme sipas dhe në pajtim me termat dhe kushtet e kësaj Letre Kredie do të respektohet dhe paguhet brenda dhjetë Ditë Pune nga data e kërkesës. Pagesa bëhet në llogarinë e Përfituesit të parashikuar në kërkesë në lidhje me të cilën është bërë një pagesë.
8. **Uljë e Shumës dhe Rivendosja**
- 8.1 Pas respektimit të [do tërheqjeje sipas kësaj Letre Kredie, Shuma e Deklaruar ulet automatikisht me shumën e tërhequr.

- 8.2 Pas marrjes së një njoftimi në formularin e Aneksit H nga Përfituesi dhe IBRD-ja, Shuma e Deklaruar ulet me shumën e njoftuar me fuqi nga marrja e saj.
- 8.3 Pavarësisht uljeve sipas Klauzolës 8.1 më sipër, Letra e Kredisë, në pajtim me dispozitat e kësaj Letre Kredie, ndryshohet prej nesh për të bërë rivendosjen në Shumën e Deklaruar, një shumë e barabartë me shumën principale të shlyer nga Kërkuesi Bankës Huadhënëse në pajtim me Marrëveshjen e Rivendosjes dhe Kredisë. Pas këtij ndryshimi për rivendosjen e Letrës së Kredisë, Banka Huadhënëse i jep përfituesit (dhe për dijeni Kërkuesit dhe IBRD-së) një njoftim në formularin e Aneksit F, dhe këtë njoftim Banka Huadhënëse merr përsipër ta paraqesë brenda katër Ditë Pune pasi kjo shumë t'i jetë paguar nga Kërkuesi Bankës Huadhënëse që tregon Shumën e Deklaruar përkatëse të re. Për mënjanimin e dyshimit:
- (a) Shuma e Deklaruar nuk rivendoset në masën që IBRD-ja ose një person tjetër i ndryshëm nga Kërkuesi ka shlyer Bankën Huadhënëse për shumën e tërhequr ose në masën që Banka Huadhënëse ka marrë një njoftim me formën e Aneksit H nga Përfituesi dhe IBRD-ja; dhe
 - (b) Banka Huadhënëse nuk është e detyruar për momentin të bëjë pagesa në lidhje me një kërkesë të marrë që është për një shumë tej Shumës së Deklaruar në momentin e marrjes së kërkesës, pavarësisht ndonjë rivendosjeje të mëvonshme të Letrës së Kredisë ose të Shumës së Deklaruar në pajtim me këtë Klauzolë 8.
9. **Njoftime**
Të gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera që duhet të bëhen janë në anglisht dhe me shkrim, drejtohen në vëmendje të personave të treguar më poshtë dhe dorëzohen personalisht ose dërgohen me korrier ose faks, **me kusht që** çdo Kërkesë duhet të dorëzohet në pajtim me Klauzolën 6.3.

Kërkuesi:

[•]

Tel: [•]

Faks: [•]

Drejtuar: [•]

IBRD:

Zëvendëspresidenti për Evropën dhe Azinë Qendrore
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America
Facsimile: +1 202-522-2758
dhe

Menaxherit (Njësia e Financave dhe Garancive)
Departamenti i Ekonomisë Financiare dhe Urban (FEU)
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America
Facsimile: +1 202 522 0761

Përfituesi:

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SHA (OSSH)
Rruga: "Vasil Shanto"
Tirana, Albania
Drejtuar: Drejtor i Përgjithshëm

Faks: 355 4 22 62 168
Për dijeni:
Drejtëtorit Ekzekutiv për Financën
Departamenti i Financës
CEZ a.s.
Duhova 2/1444
140 53 Praha 4
Czech Republic
Faks: +420 211 042 040

Banka Huadhënëse:

Citibank Europe plc, Zyra e Degës në Hungari
[•]

Faks: [•]

Drejtuar: [•]

Përveç kur parashikohet ndryshe, të gjitha njoftimet dhe komunikimet konsiderohen të dorëzuara (i) kur dorëzohen me dorë ose me korrier brenda ditës; (ii) nëse merren në një Ditë Pune për palën marrëse, nëse transmetohen me faks në numrin e faksit të palës marrëse dhe, (iii) nëse merret pas orarit zyrtar ose në një ditë që nuk është Ditë Pune për palën marrëse, në Ditën e Punës pasuese të palës marrëse pas datës së transmetimit me faks në numrin e faksit të palës marrëse. Çdo njoftim i bërë me faks konfirmohet me shkrim, jepet personalisht ose dërgohet me korrier ose me faks të porositur, por mosdorëzimi nuk zhvlerëson njoftimin origjinal të dërguar. .

Banka Huadhënëse, Kërkuesi, IBRD-ja ose Përfituesi mund të ndryshojë adresën, të adresuarin dhe/ose numrin e kontaktit me njoftim ku duhet të dërgohen ose postohen njoftimet dhe komunikimet dhe Përfituesi ka për detyrë të njoftojë Bankën Huadhënëse për çdo ndryshim të adresës, telefonit dhe/numrit të kontaktit të IBRD-së. Këto ndryshime të adresës, të të adresuarit dhe/ose numrit të kontaktit hyjnë në fuqi 10 Ditë pune pas dorëzimit të njoftimit në pajtim me këtë Klauzolë 9.

Çdo komunikim ose dokument që i bëhet ose dorëzohet Bankës Huadhënëse do të hyjë në fuqi vetëm pasi të jetë marrë efektisht nga Banka Huadhënëse dhe vetëm nëse shënohet shprehimisht në vëmendje të departamentit ose punonjësit të identifikuar më sipër (ose çdo departament zëvendës ose punonjës që Banka Huadhënëse përcakton për këtë qëllim).

10. Të ndryshme

- 10.1 Kjo Letër Kredie parashikon plotësisht detyrimin tonë dhe ky detyrim nuk do të modifikohet, ndryshohet zgjerohet apo kufizohet në asnjë mënyrë nëpërmjet referencës në ndonjë dokument, instrument apo marrëveshje të përmendur në të, përveç Anekseve të këtushëm dhe kërkesat e përmendura këtu dhe ISP98 të përmendur më poshtë dhe çdo referencë e tillë nuk konsiderohet të përfshijë këtu asnjë dokument, instrument ose marrëveshje përveç Anekseve dhe kërkesave.
- 10.2 Nga kjo Letër Kredie nuk hiqet dorë ose ndryshohet përveç se me shkrim të nënshkruar nga Banka Huadhënëse, Kërkuesi dhe Përfituesi dhe me pëlqimin e IBRD-së.
- 10.3 Pavarësisht ndonjë dispozite të kundërt në ISP98 ose këtë Letër Kredie, Përfituesi nuk mund të delegojë, transferojë negociojë ose disponojë ndryshe të gjithë ose një pjesë të të drejtave ose përfitimeve apo detyrimeve të tij sipas Letrës së Kredisë pa aprovimin e mëparshëm me shkrim (ky aprovim bëhet tërësisht në diskrecionin e tyre) të Bankës Huadhënëse dhe IBRD-së.

- 10.4 Asnjë person nuk ka të drejtë sipas Ligjit të Kontratave (Të Drejtat e të Tretëve) të vitit 1999 për të ekzekutuar ose gëzuar përfitimin e ndonjë kushti të kësaj Letre Kredie.
11. **Ligji i Zbatueshëm dhe Juridiksioni**
- 11.1 Kjo Letër Kredie dhe të gjithë Aneksat rregullohen dhe interpretohen në pajtim me ligjin anglez. Kjo Letër Kredie i nënshtrohet Praktikës Ndërkombëtare të Zëvendësimit, Dhomës Ndërkombëtare për Publikimet e Tregtisë 590 (“**ISP98**”).
- 11.2 Përfituesi i nënshtrohet juridiksionin jo-ekskluziv të gjykatave angleze. Para se të fillojë procedimi gjyqësor për të vendosur një mosmarrëveshje sipas ose në lidhje me këtë Letër Kredie (“**Mosmarrëveshje**”), Banka Huadhënëse me njoftim drejtuar Përfituesit mund të kërkojë që të gjitha Mosmarrëveshjet ose një Mosmarrëveshje specifike t’i referohet dhe vendoset përfundimisht në arbitrazh sipas Rregullave të Arbitrazhit (“**Rregullat**”) e LCIA-së. Do të jetë një arbitër i vetëm i emëruar nga Gjykata e LCIA-së. Selia e arbitrazhit është në Londër, Angli, dhe gjuha e arbitrazhit është anglishtja.
- 11.3 Përfituesi në mënyrë të pakthyeshme dhe pa kushte (në masën më të plotë të lejuar me ligj):
- 11.3.1 heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti (sovrانيتi apo tjetër) nga juridiksioni i një gjykate, kompensimi ose proces ligjor dhe heq dorë nga çdo e drejtë gjykimi me juri;
- 11.3.2 heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që ai ose sendet e tij pasurore kanë ose mund të përftojnë në lidhje me një gjykim të filluar ndaj tij ose sendet e tij pasurore në lidhje me një këtë Letër Kredie nga Banka Huadhënëse;
- 11.3.3 bie dakord që asnjë imunitet nga këto gjykime (që konsiderohen të përfshijnë pa kufizim padinë, sekuestrimin para gjykimit, sekuestrime të tjera, marrjen e vendimit, zbatimin dhe ekzekutime të tjera) nuk do të pretendohet nga ose në emër të tij ose në lidhje me sendet e tij pasurore; dhe
- 11.3.4 bie dakord në përgjithësi në lidhje me këto gjykime për dhënien e mbrojtjes ose çështjen e çdo padije në lidhje me këtë gjykim duke përfshirë pa kufizim bërjen, zbatimin ose ekzekutimin ndaj çdo pasurie (pavarësisht nga përdorimi ose përdorimi i destinuar) të çdo urdhri ose vendimi që mund të bëhet ose jepet në këto gjykime.

Sinqerisht Juaji,

CITIBANK EUROPE PLC, ZYRA E DEGËS NË HUNGARI

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

ANEKS A
Kërkesë e Përfituesit
(Pretendim i Pakundërshtuar)

Drejtuar: [Banka Huadhënëse]

[Datë]

Të dashur zotërinj,

Letër Zëvendësuese Kredie nr (-) dhënë në favor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA (OSSH) (“Letra e Kredisë”)

Ne i referohemi Letrës së Kredisë. Termat e përkufizuara në Letrën e Kredisë kanë të njëjtin kuptim në këtë kërkesë (“**Kërkesa**”).

1. Ne vërtetojmë që shuma në (-) Euro është e kërkueshme sipas Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë të datës (-) (“**Marrëveshja Mbështetëse e Qeverisë**”) e lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë që vepron si garantues (“**Garantues**”) dhe (Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në Shqipëri) (“**Përfituesi**”). Kështu ne kërkojnë pagesën e shumës (-) Euro.
2. Ne bashkëngjitem:
 - (a) një kopje të (njoftimit të pretendimit të datës (-) të paraqitur nga Përfituesi Garantuesit sipas Klauzolës 3.4.1 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë)/(kopje të njoftimit të pretendimit shtesë të datës (-) të dhënë nga (Përfituesi) Garantuesit sipas Klauzolës 3.4.2 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë);
 - (b) një kopje e marrëveshjes së shlyerjes së datës (-) të nënshkruar nga Garantuesi, Pala e Mbështetjes Teknike dhe Përfituesi që përcakton shumën që duhet t’i jepet Përfituesit sipas Klauzolës 4.2 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë; dhe
 - (c) (prova të autoritetit të nënshkruesve të kësaj Kërkesë).
3. Ne vërtetojmë që:
 - (a) (njoftimi i pretendimit)/(njoftimi i pretendimit shtesë) i përmendur në paragrafin 2(a) të kësaj Kërkesë dhe bashkëngjitur është (“**Njoftim i Pretendimit**”)/ (“**Njoftim i Pretendimit Shtesë**”) sipas përkufizimit të Klauzolës 3.4 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë; dhe
 - (b) marrëveshja e shlyerjes e përmendur në paragrafin 2(b) të kësaj Kërkesë dhe bashkëngjitur është “Marrëveshje e Shlyerjes” siç përmendet në Klauzolën 4.2 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë.
4. (Ne vërtetojmë që njoftimi i pretendimit shtesë i përmendur në paragrafin 2(a) të kësaj Kërkesë i referohet Njoftimit të Pretendimit (“**Njoftimi i Pretendimit**” siç përkufizohet në klauzolën 3.4 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë) datë (-) të paraqitur nga Përfituesi tek Garantuesi sipas Klauzolës 3.4 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë dhe që kanë kaluar një qind e njëzet (120) ditë nga data e këtij njoftimi pretendimi sipas parashikimit sipas Klauzolës 3.4 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë.)
5. Ne vërtetojmë që kanë kaluar tridhjetë (30) ditë, sipas parashikimit në Klauzolën 4.2 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë nga data e Kërkesës së Përfituesit (“**Kërkesa e Përfituesit**” sipas përkufizimit të klauzolës 4.2 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë) dhe ne nuk kemi marrë pagesën nga Garantuesi i shumës së parashikuar në marrëveshjen e shlyerjes të përmendur në paragrafin 2(b) të kësaj Kërkesë.
6. Ne vërtetojmë që shuma e kërkuar sipas paragrafit 1 të kësaj Kërkesë nuk është kërkuar në një kërkesë tjetër sipas Letrës së Kredisë.
7. Paga duhet të bëhet në llogarinë e mëposhtme:

Emri: [•]

Numri i Llogarisë: [•]

Banka: [•]

8. Data e kësaj kërkesë nuk është më vonë se Data e Skadencës.

Sinqerisht i Juaji

(Nënshkrues i Autorizuar)

(Nënshkrues i Autorizuar)

Drejtuar

OPERATORI I SISTEMIT TE SHPERNDARJES SHA (OSSH)

Për dijeni: [MOF, IBRD]

ANEKS B
Kërkesa e Përfituesit për Pagesë të Kushtëzuar

Drejtuar: [Banka Huadhënëse]

[Datë]

Të dashur zotërinj,

Letër Zëvendësuese Kredie nr (-) dhënë në favor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA (OSSH) ("Letra e Kredisë")

Ne i referohemi Letrës së Kredisë. Termat e përkufizuara në Letrën e Kredisë kanë të njëjtin kuptim në këtë kërkesë ("**Kërkesa**").

1. Ne vërtetojmë që shuma në (-) Euro është e kërkueshme sipas Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë të datës (-) ("Marrëveshja Mbështetëse e Qeverisë") e lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë që vepron si garantues ("Garantues") dhe (Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në Shqipëri) ("Përfituesi"). Kështu ne kërkojnë pagesën e shumës (-) Euro.

2. Ne bashkëngjitem:

a) një kopje të (njoftimit të pretendimit të datës (-) të paraqitur nga Përfituesi Garantuesit sipas Klauzolës 3.4 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë)/(kopje të njoftimit të pretendimit shtesë të datës (-) të dhënë nga (Përfituesi) Garantuesit sipas Klauzolës 3.4 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë);

b) (një kopje të njoftimit të Garantuesit të pretendimit të kundërshtuar datë (-) të dhënë Garantuesit nga Përfituesi sipas Klauzolës 4.3.2 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë)/(kopje të njoftimit të Pretenduesit për pretendimin e kundërshtuar të datës (-) të dhënë nga Përfituesi Garantuesit sipas Klauzolës 4.3.2 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë);

c) një kopje të (letrës së kredisë/garancisë bankare/garancisë korporative) të datës (-) për shumën e kërkuar të lëshuar në favor të Garantuesit në pajtim me Klauzolën 5 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë; dhe

d) [prova të autoritetit të nënshkruesve të kësaj Kërkese].

11. Ne vërtetojmë që:

a) (njoftimi i pretendimit)/(njoftimi i pretendimit shtesë) i përmendur në paragrafin 2(a) të kësaj Kërkese dhe bashkëngjitur është ("Njoftim i Pretendimit")/("Njoftim i Pretendimit Shtesë") sipas përkufizimit të Klauzolës 3.4 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë; dhe

b) vërtetimi i pretendimit të pretenduar përmendur në paragrafin 2(b) të kësaj Kërkese dhe bashkëngjitur është ("Njoftimi i Garantuesit të Pretendimit të Kundërshtuar")/("Njoftimi i Përfituesit të Pretendimit të Kundërshtuar") sipas përkufizimit në Klauzolën 4.3.2 të Marrëveshjes së Mbështetjes së Qeverisë; dhe

c) (letra e kredisë/garancia bankare/garancia korporative) e përmendur në paragrafin 2(c) të kësaj Kërkese është një "Garanci Riimbursimi" sipas përkufizimit në Klauzolën 5 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë.

4. Ne vërtetojmë që njoftimi i pretendimit shtesë i përmendur në paragrafin 2(a) të kësaj Kërkese i referohet Njoftimit të Pretendimit ("Njoftimi i Pretendimit" siç përkufizohet në Klauzolën 3.4 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë) datë (-) të dhënë nga Përfituesi Garantuesit sipas Klauzolës 3.4 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë dhe që kanë kaluar njëqind e njëzet (120) ditë nga data e këtij njoftimi pretendimi sipas parashikimit sipas Klauzolës 3.4 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë.

5. (Ne vërtetojmë që periudha e pajtimit ("Periudha e Pajtimit" sipas përkufizimit të Klauzolës 4.1 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë) skadon me (-)).

6. (Ne vërtetojmë që kanë kaluar të pakën pesë (5) ditë nga skadimi i Periudhës së Pajtimit sipas parashikimit të Klauzolës 5.2 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë.)

7. Ne vërtetojmë që shuma e kërkuar sipas paragrafit 1 të kësaj Kërkese nuk është kërkuar

në një kërkesë tjetër sipas Letrës së Kredisë.

8. Pjesa duhet të bëhet në llogarinë e mëposhtme:

Emri: [•]

Numri i Llogarisë: [•]

Banka: [•]

9. Data e kësaj kërkesë nuk është më vonë se Data e Skadencës.

Sinqerisht i Juaji

(Nënshkrues i Autorizuar)

(Nënshkrues i Autorizuar)

Drejtuar

OPERATORI I SISTEMIT TE SHPERNDARJES SHA (OSSH)

Për dijeni: [MOF, IBRD]

ANEKS C
Kërkesa e Shpërndarjes e Përfituesit
(Pretendimi i kundërshtuar i zgjidhur me Arbitrazh)

Drejtuar: [Banka Huadhënëse]

[Datë]

Të dashur zotërinj,

Letër Zëvendësuese Kredie nr (-) dhënë në favor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA (OSSH) (“Letra e Kredisë”)

Ne i referohemi Letrës së Kredisë. Termat e përkufizuara në Letrën e Kredisë kanë të njëjtin kuptim në këtë kërkesë (“Kërkesa”).

1. Ne vërtetojmë që shuma në (-) Euro është e kërkueshme sipas Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë të datës (-) (“Marrëveshja Mbështetëse e Qeverisë”) e lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë që vepron si garantues (“Garantues”) dhe (Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në Shqipëri) (“Përfituesi”). Kështu ne kërkojnë pagesën e shumës (-) Euro.

2. Ne bashkëngjitem:

d) një kopje të vendimit përfundimtar të arbitrazhit në bazë të Klauzolës 6.4 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë; dhe

e) prova të autoritetit të nënshkruesve të kësaj Kërkese.

3. Ne vërtetojmë që:

a) vendimi i arbitrazhit i përmendur në paragrafin 2(a) të kësaj Kërkese dhe bashkëngjitur është një “vendim përfundimtar arbitrazhi” sipas Klauzolës 6.4 të Marrëveshjes Mbështetëse të Qeverisë dhe që shuma e kërkuar në këtë Kërkesë nuk përfshin ndonjë pagesë me kusht të bërë në lidhje me pretendimin e zgjidhur nga ky vendim arbitrazhi.

b) kanë kaluar njëzet (20) ditë nga data e vendimit të arbitrazhit të përmendur në paragrafin 2(a) të kësaj Kërkese.

4. Ne vërtetojmë që shuma e kërkuar në paragrafin 1 të kësaj Kërkese nuk është kërkuar në një kërkesë tjetër sipas Letrës së Kredisë.

5. Pagesa duhet të bëhet në llogarinë e mëposhtme:

Emri: [•]

Numri i Llogarisë: [•]

Banka: [•]

6. Data e kësaj kërkese nuk është më vonë se Data e Skadencës.

Juaji Sinqerisht

(Nënshkrues i Autorizuar)

(Nënshkrues i Autorizuar)

Drejtuar

OPERATORI I SISTEMIT TE SHPERNDARJES SHA (OSSH)

Për dijeni: [MOF, IBRD]

ANEKS D
Njoftim Tërheqjeje

[Datë]

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë

Të dashur zotërinj,

Letër Zëvendësuese Kredie nr (-) dhënë në favor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA (OSSH) (“Letra e Kredisë”)

Ne i referohemi Letrës së Kredisë. Termat e përkufizuara në Letrën e Kredisë kanë të njëjtin kuptim edhe këtu.

Ne u njoftojmë që ne kemi marrë një kërkesë për pagesën e (-) Euro nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SHA (OSSH) në pajtim me Klausolën 6 të Letrës së Kredisë. Ne u informojmë juve që ne i paguam (-) Euro Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA (OSSH) në pajtim me këtë kërkesë më (-).

CITIBANK EUROPE PLC, ZYRA E DEGËS NË HUNGARI

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

dhe

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Për dijeni: [Përfituesi, IBRD]

ANEKS E
Vërtetimi i Pushimit të Fuqisë

Drejtuar: [Banka Huadhënëse]

[Datë]

Të dashur zotërinj,

Letër Zëvendësuese Kredie nr (-) dhënë në favor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA (OSSH) ("Letra e Kredisë")

Ne i referohemi Letrës së Kredisë. Termat e përkufizuara në Letrën e Kredisë kanë të njëjtin kuptim edhe këtu.

Të poshtëshënuarit, duke qene punonjës të autorizuar rregullisht të Përfituesit sipas Letrës së Kredisë u vërtetojmë që:

1. Ne u paraqesim juve Letrën e Kredisë bashkangjitur.
 2. Letra e Kredisë pushon së qeni në fuqi në pajtim me kushtet e saj.
 3. Asnjë pagesë nuk kërkohet prej jush në lidhje me dorëzimin e Letrës së Kredisë.
 4. Ne u lirojmë nga të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë sipas kësaj Letre Kredie.
- Shumë sinqerisht, juaji

OPERATORI I SISTEMIT TE SHPERNDARJES SHA (OSSH)

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

dhe

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Për dijeni: [IBRD, MOF]

ANEKS F
Ndryshim për Rritjen e Shumës së Kërkuar
me Riimbursimin e Kërkuesit

Drejtuar: Operatori i Sistemit Te Shpërndarjes SHA (OSSH)

[Datë]

Të dashur zotërinj,

Letër Zëvendësuese Kredie nr (-) dhënë në favor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA (OSSH) (“Letra e Kredisë”)

Ne i referohemi Letrës së Kredisë. Termat e përkufizuara në Letrën e Kredisë kanë të njëjtin kuptim edhe këtu.

Ne u njoftojmë që Banka Huadhënëse është shlyer me një shumë principale prej (-) Euro nga Kërkuesi në pajtim me Marrëveshjen e Riimbursimit dhe Kredisë.

Për pasojë, ne ndryshojmë Letrën e Kredisë për të rivendosur Shumën e Deklaruar të Letrës së Kredisë në (-) Euro.

CITIBANK EUROPE PLC, ZYRA E DEGËS NË HUNGARI

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

dhe _____

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Për dijeni: MOF, IBRD

ANEKS G

Njoftimi i Hyrjes në Fuqi

Drejtuar: Operatori i Sistemit Të Shpërndarjes SHA (OSSH)

[Datë] 2009

Të dashur zotërinj,

Letër Zëvendësuese Kredie nr (-) dhënë në favor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA (OSSH) (“Letra e Kredisë”)

Ne i referohemi Letrës së Kredisë. Termat e përkufizuara në Letrën e Kredisë kanë të njëjtin kuptim edhe këtu.

Ne konfirmojmë që Letra e Kredisë e datës (-) ka hyrë në fuqi më (-) 2009

CITIBANK EUROPE PLC, ZYRA E DEGËS NË HUNGARI

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Për dijeni: Kërkuesi, IBRD

ANEKS H

Njoftim i Reduktimit të Shumës së Deklaruar

Drejtuar: [Banka Huadhënëse]

[Datë]

Të dashur zotërinj,

Letër Zëvendësuese Kredie nr (-) dhënë në favor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA (OSSH) (“**Letra e Kredisë**”)

Ne i referohemi Letrës së Kredisë. Termat e përkufizuara në Letrën e Kredisë kanë të njëjtin kuptim edhe këtu.

Ne konfirmojmë që Shuma e Deklaruar në këtë Letër Kredie duhet të zvogëlohet me (-) Euro.

OPERATORI I SISTEMIT TE SHPERNDARJES SHA (OSSH)

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Rënë dakord dhe pranuar nga

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Për dijeni: MOF

ANEKSI

Njoftim i Pushimit të Fuqisë

Drejtuar: Operatori i Sistemit Te Shpërndarjes SHA (OSSH)

[Datë]

Të dashur zotërinj,

Letër Zëvendësuese Kredie nr (-) dhënë në favor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA (OSSH) (**“Letra e Kredisë”**)

Ne i referohemi Letrës së Kredisë. Termat e përkufizuara në Letrën e Kredisë kanë të njëjtin kuptim edhe këtu.

Një Ngjarje për Pushimin e Fuqisë ka ndodhur në pajtim me Klausolën 5[(a)/(b)] të Letrës së Kredisë (-) 2009.

CITIBANK EUROPE PLC, ZYRA E DEGËS NË HUNGARI

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Për dijeni: MOF, IBRD

MARRËVESHJE MBI MBËSHTETJEN QEVERTARE
MIDIS MINISTRISË SË FINANCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
QË VEPRON NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE
OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SHA (OSSH)

MARRËVESHJE PER MBËSHTETJEN QEVERTARE

Kjo marrëveshje mbi mbështetjen qeveritare ("Marrëveshja") lidhet midis:

1. Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministri [●]
2. i autorizuar në mënyrën e duhur për qëllim të kësaj Marrëveshje, që vepron në cilësinë e përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë,

që më poshtë do t'i referohemi si "**Garantuesi**"; dhe

3. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë, (METE) e përfaqësuar nga Ministri Genc Ruli, i autorizuar në mënyrën e duhur për qëllim të kësaj Marrëveshje, që vepron në cilësinë e përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë,

që më poshtë do t'i referohemi si "**Pala për Mbështetjen Teknike**"; dhe

1. **OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES' SHA ("OSSH")**, një shoqëri aksionare Shqiptare, me seli në Rrugë: "Vasil Shanto", Tiranë, Shqipëri, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Kompanive të Tiranës, nr.38587, me 19 Qershor 2007 me numër K72410014H, dhe përfaqësuar nga [●] i autorizuar në mënyrën e duhur për qëllim të kësaj Marrëveshje,

që më poshtë do t'i referohemi si "**Përfituesi**".

Garantuesit, Palës për Mbështetjen Teknike dhe Përfituesit më poshtë do t'i referohemi individualisht si "**Pala**" dhe bashkërisht si "**Palët**".

NDËRSA:

- (A) METE dhe CEZ, a.s. kanë lidhur një marrëveshje për blerjen e aksioneve ("MBA") datë 11 Mars 2009, me anën e së cilës METE ka rënë dakord të transferojë shtatëdhjetë e gjashtë përqind (76%) të kapitalit të regjistruar të Përfituesit tek CEZ, a.s. ("**Investimi**") sipas kushteve precedentë të përcaktuara në MBA.
- (B) Në lidhje me lëshimin e Garancisë së Riskut të Pjeshtë nga BNRZH për mbulimin e risqeve rregullatorë në lidhje me Investimin, Garantuesit , Palës për Mbështetjen Teknike dhe Përfituesit i kërkohet të lidhin këtë Marrëveshje.

PALËT BIEN DAKORT SI MË POSHTË:

PALËT BIEN DAKORT SI MË POSHTË:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Përkufizime

Në këtë MMQ (përfshirë këtu përkshkrimet në pjesën hyrëse dhe anekset e kësaj marrëveshje), përvec kur parashikohet ndryshe në mënyrë specifike apo në varësi të kuptimit të tekstit, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e dhënë më poshtë:

"Persona të lidhur" do të thotë çdo Person i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, përmes një apo më shumë ndërmjetësish, Kontrollon, Kontrollonhet apo i nënshtrohet Kontrollit të përbashkët të një Personi të caktuar;

"Marrëveshje" do të thotë kjo marrëveshje përfshirë Anekset që i bashkëngjiten;

"Kërkesë Pagese me kusht e Përfituesit" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 5.2.

"Kërkesa e Përfituesit" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 4.2.

"Njoftim i Përfituesit për Pretendimit të Kontestuar" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 4.3.2.

"Kërkesë Pagese e Përfituesit" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 6.4.

"Pretendim" ka kuptimin një pretendim për një Humbje e përcaktuar në Njoftim Pretendimi ose Njoftim Pretendimi Shtesë.

"Data e mbylljes" ka kuptimin data në të cilën transaksioni i parashikuar në MBA është mbyllur.

"Periudha e Pajtitit" ka kuptimin e një periudhe prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e marrjes së Njoftim Pretendimit ose e një Njoftim Pretendimi Shtesë nga Garantuesi gjatë së cilës Palët do të përpiqen ta zgjidhin miqësisht Pretendimin.

"Pagesë me Kushte" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 5.1.

"Pretendim i kontestuar" ka kuptimin pretendim që Palët nuk kanë mundur ta zgjidhin gjatë Periudhës së Pajtitit.

"Garancia e Inkorporuar" ka kuptimin zgjedhja e Përfituesit, ose një garanci e mëmës së CEZ, a.s., ose një garanci e lëshuar nga Përfituesi, kjo garanci e lëshuar nga Përfituesi duhet të jete në formën e titullit ekzekutiv të noterizuar.

"Procedura e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve" ka kuptimin procedura e parashikuar në Nenin 6.

"Pretendim dyfish" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 8.2.

"OSSH" ka kuptimin operatori i sistemit te shpërndarjes.

"ERE" ka kuptimin Enti Rregullator i Energjisë.

"Data e Fundit e Pretendimit" ka kuptimin 2 Mars 2015.

"Sasia e Garantuar" ka kuptimin e sasisë prej gjashtëdhjetë milion Euro (€60,000,000) dhe kjo sasi mund te reduktohet sipas kushteve te LK-se.

"Ngjarje e Garantuar" ka kuptimin (1) një ndryshim, refuzim, ose mospërbushje nga ERE ose Qeveria e Shqipërisë te disa klauzolave te Kuadrit Rregullator qe drejton(i) aprovimin ne kohe aplikimeve te tarifave DSO dhe RPS siç janë dorëzuar nga Përfituesi, sipas Nenit 1.3 te Deklaratës Rregullatore, dhe (ii) formulën e tarifës e DSO dhe formulën e tarifës RPS dhe inputet ne lidhje me to (siç janë përfshirë ne Aneksn 2 me poshtë) duke përfshirë mekanizmin e kompensimit siç paraqitet ne Nenin 5 dhe 6 te Deklaratave Rregullatore por duke përjashtuar ndonjë reference për periudhat rregullatore pas datës 31 Dhjetor 2014; dhe (2) kur kjo rezulton ne Humbje.

"Periudha e Garantuar" ka kuptimin periudha qe fillon me 1 Janar 2009 dhe përfundon me 31 Dhjetor 2014.

"Njoftimi i Garantuesit mbi Pretendimin e Kontestuar" ka kuptimin e parashikuar ne Nenin 4.3.2.

"Periudha e Rishikimit te Garantuesit" ka kuptimin e parashikuar ne Nenin 3.2.

"BNRZH" ka kuptimin Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

"Detyrimi për Dëmshpërblim" ka kuptimin e përcaktuar ne Nenin 2.1.

"Audituesi i Pavarur" ka kuptimin audituesi i pavarur i emëruar bashkarisht nga Garantuesi, Përfituesi dhe Pala për Mbështetjen Teknike sipas Nenit 7.

"Raporti i Audituesit te Pavarur" ka kuptimin raporti i përgatitur nga Audituesi i Pavarur.

"LK" ka kuptimin letër krediti ne formularin e bashkangjitur me poshtë si Shtojca 4 nga Banka lëshuese e LK ne sasinë e barabarte me Sasinë e Garantuar.

" Banka e LK" ka kuptimin Citibank banka lëshuese e LK-se.

"Humbje" ka kuptimin humbje e te ardhurave te Përfituesit brenda Periudhës se Garantuar qe rezulton nga një Ngjarje e Garantuar gjate Periudhës se Garantuar.

"Njoftim Pretendimi" ka kuptimin e përcaktuar ne Nenin 3.4.1.

"Njoftim Ngjarje" ka kuptimin e Nenit 3.1.1.

"Njoftim Pretendimi Suplementar" ka kuptimin e përcaktuar ne Nenin 3.4.2.

"Rregullator" ka kuptimin ERE ose ndonjë rregullator tjetër i energjisë industriale ose departament, organ, agjensi, ose autoritet tjetër rregullator i Republikës se

Shqipërisë ose çdo nënndarje e saj e krijuar ne baze te ligjit ne fuqi te Republikës se Shqipërisë, i cili ka autoritet te aprovoje tarifat dhe çmimet e elektricitetit, te lëshoje licensa dhe te zgjidhe mosmarrëveshje midis te licensuarve dhe klientëve.

"Kuatridhe rregullator" ka kuptim ne dokumentet e mëposhtëm, te cilat janë bashkangjitur ne Aneksn 1:

- Vendimi i ERE Nr. 18 qe i përket "Tarifës se Prodhimit te Energjisë", date 14 Shkurt 2008;
- Vendimi i ERE Nr. 19 qe i përket "Aprovimit te Tarifës se Transmetimit 2008", date 14 Shkurt 2008;
- Vendimi i ERE Nr. 20 qe i përket "Aprovimit te Tarifës se Shërbimit te Shpërndarjes 2008", date 14 Shkurt 2008;
- Vendimi i ERE Nr. 21 qe i përket "Aprovimit te Tarifave te 2008", date 14 Shkurt 2008;
- Vendimi i ERE Nr. 75 qe i përket "Aprovimit te Tarifës WPS", date 26 Qershor 2008;
- Vendimi i ERE Nr. 79 qe i përket "Metodologjia e Llogaritjes se Tarifës te Operatorit te Sistemit te Shpërndarjes se Energjisë ", date 26 Korrik 2008;
- Vendimi i ERE Nr. 80 qe i përket "Shitje me pakice për Metodologjinë e Llogaritjes se Tarifës se Rregulluar te Klientit" date 26 Qershor 2008;
- Procedurat e tenderi te OSSH ne lidhje me përzgjedhjen e bankave qe japin borxhe te reja qe do te aprovohen nga ERE nga data e mbylljes se privatizimit te OSSH;
- Procedurat e tenderit te OSSH ne lidhje me përzgjedhjen e furnitorit te elektricitetit duke mbuluar humbjet qe do te aprovohet nga ERE ne daten e mbylljes se privatizimit te OSSH;
- Vendimi i Këshillit te Ministrave Nr. 143 date 11 Shkurt 2009;
- Letër mbështetëse lëshuar nga METE ne lidhje me kompensimin qeveritar te OSSH për humbjet financiare ne 2009 qe kane rezultuar nga vendime te mundshme te specifikuara te ERE te datës 9 Mars 2009.
- Deklarate Rregullatore e aprovuar nga ERE ne 3 Mars 2009.

"Deklarate Rregullatore" or **"DR"** ka kuptimin deklarata rregullatore e lëshuar nga Rregullatori ne 3 Mars 2009.

"Sasia e Rimbursimit" ka kuptimin e përcaktuar ne Nenin 5.3(b).

"Garancia e Rimbursimit" ka kuptimin e një letër krediti, një garanci bankare ose një Garanci e Korporuar e pranueshme për Garantuesin që lëshohet për llogari të Përfituesit për të siguruar çdo Page të Kushtëzuar në përputhje me Nenin 5, afatet dhe kushtet e të cilit janë parashtruar në Aneksin 3.

"FPP" ka kuptimin furnitori publik i pakicës.

"Marrëveshje Rregullimi" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 4.2.

"Sasia e Palës së Tretë" ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 8.3.1.

1.2 Interpretimet

Në këtë Marrëveshje me përjashtim të rastit kur përcaktohet ndryshe shprehimisht apo në varësi të përmbajtjes:

- (a) referencat në termin Nenet nënkupton referencat në nenet e kësaj Marrëveshjeje, dhe referencat në termin Shtojcat nënkupton shtojcat e kësaj Marrëveshjeje;
- (b) një referencë në çdo Legjislacion, rregullore, akt apo klauzolë ligjore do të interpretohet si një referencë në gjendjen e tyre aktuale, duke pasur parasysh ndryshimet, modifikimet apo zëvendësimet e herë-pas-herëshme të tyre;
- (c) referencat ndaj një personi do të interpretohen në mënyrë të tillë që të përfshijnë çdo individ, firmë, shoqëri, organ qeveritar, apo çdo entitet tjetër të themeluar si një entitet me personalitet të veçantë si dhe do të përfshijë çdo shoqëri pasuese (me anë të bashkimit apo në ndonjë formë tjetër) të kësaj shoqërie;
- (d) numri njëjës përfshin dhe shumësin dhe anasjelltas dhe;
- (e) titujt e Neneve dhe të Anekseve janë vendosur vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do ndikojnë në ndonjë mënyrë në interpretimin e tyre;

2. DETYRIMI PËR DËMSHPËRBLIM

2.1 Në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje, Garantuesi do të shpërblejë Përfituesin për çdo Humbje ("Detyrimi për Dëmshpërblim"), me kusht që detyrimi total i Garantuesit për çdo Humbje, individuale ose agregate, nuk do ta kalojë Shumën e Garantuar.

2.2 Detyrimi për Dëmshpërblim mund të përmbushet ose drejtpërdrejtë nga një pagesë e Garantuesit ose nga një Bankë që lëshon LK me tërheqjen e LK-së.

3. PROCEDURA E DËMSPËRBLIMIT

3.1 Njoftimi i Ngjarjes

3.1.1 Menjëherë pasi Përfituesi vëren ndonjë rrethanë e cila mund të bëhet një Ngjarje Garancie, dhe në çdo rast brenda tridhjetë (30) ditëve nga data që kjo rrethanë është bërë publike, (duke përfshirë por që nuk kufizohet me publikimin në Fletoren Zyrtare, publikimin në faqen e internetit të METE, ose komunikimit me Përfituesin) Përfituesi duhet të jetë i ndërgjegjshëm për zhvillimin e rrethanës përkatëse, dhe Përfituesi do t'i dërgojë Garantuesit dhe Palës së Suportit Teknik një njoftim me shkrim sipas Nenit 8.4 më poshtë dhe një kopje BNRZH, duke paraqitur një përmbledhje të fakteve të njohura dhe fakteve të tjera që lidhen me rrethanën, çdo dokument plotësues në lidhje me këtë rrethanë, çdo ligj, vendim ose urdhëresë e lëshuar nga një palë e tretë (duke përfshirë Rregullatorin) në lidhje me këtë rrethanë si dhe vlerësimin e Humbjeve të cilat mund të shkaktohen nga rrethana përkatëse, pa cënuar të drejtën e Përfituesit për të pretenduar njëherazi shumën aktuale të Humbjes ("Njoftimi i Ngjarjes").

3.1.2 Mos-sigurimi ose vonesat nga ana e Përfituesit për të siguruar Njoftimin e Ngjarjes brenda afatit të përcaktuar në Nenin 3.1.1 do t'i heqë të drejtën Përfituesit për dëmshpërblim nga çdo Humbje e shkaktuar para datës së sigurimit të Njoftimit të Ngjarjes, përveç ngjarjeve që ndodhin nga data 1 Janar 2009 dhe Datës së Mbylljes, por nuk do t'i heqë Përfituesit të drejtën për dëmshpërblim nga Humbjet e shkaktuara pas datës që Njoftimi i Ngjarjes është dërguar.

3.2 Periudha e Rishikimit të Garantuesit

Brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e Njoftimit të Ngjarjes ("Periudha e Rishikimit të Garantuesit"), Garantuesi, së bashku me Palën e Suportit Teknik do të rishikojë përmbajtjen e Njoftimit të Ngjarjes, me qëllim që të vlerësojë nëse rrethana e përshkruar në të mund të bëhet një Ngjarje Garancie duke i dhënë shtysë një Detyrimi për Dëmshpërblim. Së bashku me Palën e Suportit Teknik, garantuesi do të bëjë përpjekjet maksimale, brenda kompetencave të tij ligjore, për të parandaluar, lehtësuar apo hequr pasojat e kundërta të ngjarjeve të parqitura në Njoftimin e Ngjarjes, duke përfshirë por që nuk kufizohet me, efektet e ligjeve, vendimeve apo urdhëresave që shkaktuan rrethanën përkatëse.

3.3 Konsultimi me Përfituesin

Gjatë Periudhës së Rishikimit të Garantuesit, Garantuesi dhe Pala e Suportit Teknik do të konsultohen me Përfituesin sa herë të jetë e nevojshme, për aspektet e përshkruara Njoftimin e Ngjarjes, me qëllim zgjidhjen e diferencave të mundshme dhe do të mbajnë të informuar IBRD për progresin në konsultimet e Palëve.

3.4 Njoftimi i Pretendimit

3.5

3.5.1 Nëse ndodh një Ngjarje Garancie, Përfituesi do t'i dërgojë Garantuesit dhe Palës së Suportit Teknik një njoftim me Shkrim ("Njoftimi i Pretendimit") sipas Nenit 8.4

më poshtë, dhe një kopje IBRD-së. Njoftimi i Pretendimit do të paraqesë Humbjen dhe një përmbledhje të fakteve të njohura dhe që kanë lidhje me të, duke përfshirë çdo dokument plotësues që lidhet me këtë rrethanë, si dhe fakte që tregojnë se Njoftimi i Ngjarjes i është dërguar Garantuesit nëse Njoftimi i Pretendimit dërgohet pas Njoftimit të Ngjarjes; megjithatë Njoftimi i Ngjarjes nuk është e nevojshme të dërgohet para dërgimit të Njoftimit të Pretendimit, por në këtë rast Humbja do të ndodhë vetëm nga data e Njoftimit të Pretendimit.

3.5.2 Nëse Përfituesi vazhdon të ketë Humbje për të cilën është dërguar Njoftimi i Pretendimit, Përfituesi mund të pretendojë dëmshpërblim për Humbje shtesë. Përfituesi do t'i japë Garantuesit dhe Palës së Suportit Teknik një njoftim me shkrim ("**Njoftimi i Pretendimit Plotësues**") sipas Nenit 8.4 më poshtë, dhe një kopje BNRZH-së. Njoftimi i Pretendimit Plotësues do të paraqesë humbjen shtesë dhe do t'i referohet Njoftimit të Pretendimit në lidhje me Ngjarjen e Garancisë prej nga rrjedh Njoftimi i Pretendimit Plotësues dhe do të shpërndahet jo më shpejt se njëqind e njëzetë ditë (120) nga Njoftimi i Parë i Pretendimit që lidhet me po të njëjtën Ngjarje Garancie. Nëse afati prej njëqind e njëzetë ditësh tejkalon periudhën e mbetur deri në mbarimin e Periudhës së Garancisë, atëherë afati për dërgimin e Njoftimit të Pretendimit Plotësues, do të reduktohet me qëllim që ky afat të mbarojë në Datën e Përfundimtare të Pretendimit.

3.5.3 Për të shmangur dyshimet, Detyrimi për Dëmshpërblim mund të burojë vetëm në lidhje me një Humbje për të cilën Përfituesi i ka dërguar Garantuesit Njoftimin e Pretendimit, ose sipas rastit Njoftimin e Pretendimit Plotësues, para Datës Përfundimtare të Pretendimit.

4. ZGJIDHJA E PRETENDIMEVE

Të gjitha pretendimet do të zgjidhen në përputhje me Nenin 4.

4.1 Periudha e Pajtitimit

Palët do të tentojnë të zgjidhin miqësisht Pretendimin brenda një periudhe (60) ditore nga marrja e Njoftimit të Pretendimit ose Njoftimit të Pretendimit Plotësues ("**Periudha e Pajtitimit**").

4.1.1 Gjatë Periudhës së Pajtitimit, secila nga Palët mund t'i kërkojë ("**Kërkesa e Auditimit**") Audituesit të Pavarur të:

- (a) Kryejë një kontroll të Ngjarjes përkatëse të Garancisë dhe Humbjes që rezulton nga Njoftimi i Pretendimit/Njoftimi i Pretendimit Plotësues; dhe
- (b) të përgatisë Raportin e Audituesit të Pavarur.

Kërkesa për Auditim duhet të dërgohet nga Pala që bën këtë Kërkesë Auditimi, në përputhje me Nenin 4.1.1 brenda njëzetë (20) ditëve nga shpërndarja e Njoftimit përkatës të Pretendimit ose Njoftimit të Pretendimit Plotësues drejt Palëve të tjera dhe një kopje IBRD-së. Raporti i Audituesit të Pavarur do t'i shpërndahet Palëve brenda njëzetë (20) ditëve nga marrja e Kërkesës së Auditimit. Palët do t'i dorëzojnë IBRD-së një Kopje të Raportit të Audituesit të Pavarur.

4.2 Pretendimet e Pakundërshtuara

Në rast se Palët do të zgjidhin Pretendimin brenda Periudhës së Pajtitimit, ata do të zbatojnë një marrëveshje rregullimi duke paraqitur shumën e rënë dakord për Detyrimin e Dëmshpërblimit ("**Marëveshja e Ndreqjes**"). Me zbatimin e Marrëveshjes së Ndreqjes, Përfituesi do t'i dorëzojë sipas Nenit 8.4 Garantuesit, Palës së Suportit Teknik dhe IBRD-së, një kërkesë me shkrim duke paraqitur shumën e rënë dakord (**Kërkesa e Përfituesit**). Garantuesi do t'i paguajë Përfituesit shumën e paraqitur në Kërkesën e Përfituesit brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e Kërkesës së Përfituesit. Me moskryerjen e kësaj pagese Përfituesi do t'i dërozojë Kërkesën e tij të Përfituesit Bankës së LK, një kopje Garantuesit, Palës së Suportit Teknik dhe BNRZH-së. Përfituesi do t'i bashkëngjisë Kërkesës së tij të Përfituesit që i dërgohet Bankës së LK-së, një kopje të Njoftimit të Pretendimit dhe të Marrëveshjes së Ndreqjes si dhe një certifikatë duke deklaruar se Garantuesi nuk ka paguar shumën përkatëse. Nëse Garantuesi do të paguajë shumën e Përfituesit pasi Kërkesa e Përfituesit të jetë dorëzuar tek Banka e LK-së, Përfituesi menjëherë do të njoftojë Bankën e LK-së dhe do të tërheqë Kërkesën e Përfituesit.

4.3 Pretendimet e Kundërshtuara

4.3.1 Në rast se Palët nuk arrijnë të zgjidhin Pretendimin brenda Periudhës së Pajtitimit ("**Pretendimi i Kundërshtuar**"), kjo çështje do të kthehet në mosmarrëveshje, vetëm nëse Palët bien dakord ndryshe për të zgjidhur Periudhën e Pajtitimit, dhe do të zgjidhet përmes Procedurës së Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve në përputhje me Nenin 6 më poshtë.

4.3.2 Garantuesi do t'i dërgojë Përfituesit dhe Palës së Suportit Teknik, një kopje IBRD-së, dhe një njoftim me shkrim sipas Nenit 8.4 më poshtë, duke pranuar ekzistencën e një Pretendimi të Kundërshtuar, brenda pesë (5) ditëve nga mbarimi i Periudhës së Pajtitimit ("**Njoftimi i Garantuesit për Pretendimin e Kundërshtuar**"). Nëse Përfituesi nuk arrin të marrë një kopje të Njoftimit të Garantuesit për Pretendimin e Kundërshtuar brenda pesë (5) ditëve, Përfituesi do t'i dërgojë një njoftim ("**Njoftimi i Përfituesit për Pretendimin e Kundërshtuar**") Palëve të tjera dhe një kopje IBRD-së.

4.3.3 Cdo pjesë e Pretendimit që nuk është e kundërshtuar ose zgjidhet më pas, do të zgjidhet sipas Nenit 4.2 më sipër.

5. PAGESAT ME KUSHT

5.1 Palët bien dakord që në rastin e Pretendimit të Kundërshtuar, ose një pretendimi për të cilin Njoftimi i Pretendimit u dërgua pas mbarimit të Periudhës së Garancisë, por jo më vonë se Data Përfundimtare e Pretendimit, me qëllim zvogëlimin e ekspozimit të Përfituesit ndaj Humbjes, Përfituesi mund të kërkojë pagesa me kusht nga Banka e LC-së ("**Pagesë me Kushte**").

5.2 Përfituesi do t'i paraqesë Bankës së LC-së një kërkesë me shkrim për një Pagesë me Kusht, duke paraqitur shumën e Pretendimit të Kundërshtuar, një kopje të Raportit të Audituesit të Pavarur (nëse është lëshuar ndonjë Raport i Audituesit të Pavarur gjatë Periudhës së Pajtitimit), një kopje të Njoftimit të Garantuesit për Pretendimin e Kundërshtuar ose të Njoftimit të Përfituesit për Pretendimin e Kundërshtuar sic zbatohet në rastin e një Pretendimi të Kundërshtuar, një kopje të dërguar rregullisht të Njoftimit të Pretendimit dhe origjinalin e një Garancie Rimbursimi në shumën e Pretendimit të Kundërshtuar ("**Kërkesa e Përfituesit për Pagesë me Kusht**"). Në të

njëjtën kohë, Përfituesi do t'i sigurojë një kopje të Kërkesës së Përfituesit për Pagesë me Kusht, Garantuesit, BNRZH-së dhe Palës së Suportit Teknik. Kërkesa e Përfituesit për Pagesë me Kusht do të dërgohet brenda pesë (5) ditëve nga mbarimi i Periudhës së Pajtimit në rastin e Pretendimit të Kundërshtuar; vetëm nëse Kërkesa e Përfituesit për Pagesë me Kusht nuk mund të dërgohet më vonë se Data e Pretendimit Përfundimtar.

5.3 Nëse në lidhje me Pretendimin e Kundërshtuar ose një Pretendim për të cilin Njoftimi i Pretendimit u dërgua pas mbarimit të Periudhës së Garancisë por jo më vonë se Data e Pretendimit Përfundimtar, Pagesa me Kusht i është bërë Përfituesit sipas Nenit 5.1 dhe vendimi për Zgjidhje përfundimtare të Mosmarrëveshjes, dërgohet sipas Procedures së mëposhtme për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve ose nënshkruhet një Marrëveshje Rregullimi, e cila:

- (b) përcakton detyrimin e Garantuesit në lidhje me Pretendimin dhe ky detyrim është më i vogël se shuma e plotë e pagesës me kusht, që bëhet në lidhje me Pretendimin, ose
- (c) përcakton se Garantuesi nuk ka detyrim në lidhje me Pretendim,

Garantuesi ka të drejtë të përshpejtojë rimbursimin e Pagesës me Kusht, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e njoftimit të Palëve për vendimin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes ose zbatimit të Marrëveshjes së Rregullimit, në lidhje me Pagesat me Kusht që bëhen përtej detyrimit të përcaktuar në pikën (a) më sipër, ose shumës së plotë të këtyre pagesave me kusht që bëhen sipas pikës (b) ("**Shuma e Rimbursimit**"), bashkë me interesat në të, nga data e këtyre pagesave me kusht deri në datën e rimbursimit në të njëjtën normë interesi me normën e interesit që aplikohet në rimbursim dhe marrëveshjem e kredisë që lidhet ndërmjet Garantuesit dhe Bankës së Letër Kredisë.

5.4 Garancia e Rimbursimit mund të tërhiqet nga Garantuesi në limit të Shumës së Rimbursimit në rast se Përfituesi nuk arrin të paguajë Shumën e Rimbursimit brenda një periudhe tridhjetë (30) ditore sic paraqitet në Nenin 5.3 (b). Nëse pagesa nga Përfituesi për Garantuesin e Shumës së Rimbursimit bashkë me interesat e saj, bëhet nga Përfituesi brenda Periudhës së Garancisë, balanca e Shumës së Garancisë do të rivendoset me vlerën e Shumës së Rimbursuar, LK-ja do të rritet me këtë shumë dhe Garancia e Rimbursimit do t'i kthehet Përfituesit menjëherë.

5.5 Përfituesi mund të sigurojë Garancinë e Rimbursimit në formën e një Garancie të Korporatës nëse shuma e Pretendimit është pesë milion EUR ((€ 5.000.000) ose më pak: me kusht që të gjitha Pretendimet e siguruara nga kjo Garanci (të) e Korporatës, në cdo kohë të mos tejkalojnë shumën e dhjetë milion EUR (€ 10.000.000). Për të shmangur dyshimin, nëse një Pretendim p.sh., është gjashtë milion EUR (€ 6.000.000), Përfituesi duhet të sigurojë këtë Pretendim me anë të një garancie bankare ose letër kredie.

6. PROCEDURA E ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE

6.1 Kjo Marrëveshje do të drejtohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

- 6.2 Mosmarrëveshjet e Palëve në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Kontrate, ose Pretendimeve të Kundërshtuara të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht ndërmjet Palëve, do të zgjidhen përfundimisht me arbitrazh sipas Nenit 6.3.
- 6.3 Çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë nga një gjykatë arbitrazhi e përbërë nga tre (3) arbitra, një (1) i zgjedhur nga Garantuesi, një (1) nga Përfituesi dhe një (1) i arbitër i zgjedhur me konsensusin e dy arbitrave të emëruar nga Palët). Vendi i arbitrazhit do të jetë qyteti i Vjenës në Austri. Gjuha e arbitrazhit do të jetë Anglisht. Vendimi i Arbitrave do të jetë përfundimtar, detyrues dhe i zbatueshëm. Pala në humbje do të paguajë kostot në lidhje me procesin e arbitrazhit.
- 6.4 Nëse Garantuesi nuk paguan menjëherë shumën e deklaruar në vendimin përfundimtar të arbitrazhit, Përfituesi, jo më vonë se brenda njëzetë (20) ditëve nga data e vendimit përfundimtar, do t'i dërgojë një kërkesë me shkrim për kryerjen e pagesës, Bankës së LK-së, duke bashkëngjitur një kopje të vendimit përfundimtar të arbitrazhit në Pretendimin e Kontestuar dhe duke paraqitur shumën që do t'i paguhet Përfituesit pas zbritjes së ndonjë shume të marrë sipas Pagesës me Kusht ("**Kërkesa e Pagesës së Përfituesit**"). Në të njëjtën kohë, Përfituesi do t'i sigurojë Garantuesit, IBRD-se dhe Palës së Suportit Teknik, një kopje të Kërkesës së Pagesës së Përfituesit.

7. AUDITUESI I PAVARUR

7.1 Emërimi

Me qëllim lehtësimin e përpjekjeve të Palëve për t'u pajtuar ose për të zgjidhur miqësisht Pretendimin, duke pranuar se këto çështje kërkojnë eksperiencë të gjerë dhe njohuri të specializuara, Palët, brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga kjo datë, do të emërojnë së bashku nga lista e pranuar ndërmjet tyre në Deklaratën e Ndrejjes, një firmë eksperte, të pavarur dhe me reputacion të mirë, për të vepruar si Auditues i Pavarur. Me pranimin e emërimit si dhe me pranimin e Kërkesës për Auditim për një Raport të Pavarur Auditimi sa më poshtë, Audituesi i Pavarur i zgjedhur nga Palët, do të konfirmojë me shkrim pavarësinë e tij kundrejt Palëve. Audituesi i Pavarur do të japë në mënyrë të pavarur Raportin e Audituesit të Pavarur dhe ekskluzivisht në bazë të kërkesës për Auditim sipas Nenit 4.1.1.

7.2 Pasojat Jo-Detyruese

Përmbajtja e Raportit të Audituesit të pavarur nuk do të jetë detyruese ose përfundimtare për Palët.

8. TË NDRYSHME

8.1 Transferimet

Përfituesi nuk mund të transferojë me marrëveshje ose e thënë ndryshe, një pjesë ose të gjitha të drejtat, detyrimet ose përgjegjësitë e tij sipas kësaj Kontrate pa miratimin paraprak me shkrim të Dorëzanësit, i cili pa-shkak nuk duhet ta vonojë ose mbajë këtë miratim, përndryshe ky transferim do të konsiderohet i pavlefshëm.

8.2 Pretendime të dyfishta

Përfituesi, sipas Marrëveshjes, nuk ka të drejtë të ngrejë Pretendime ose të kërkojë lëshimin e parave sipas LK-së për aq sa ky Pretendim do të lejojë Përfituesin të paguhet më tepër se një herë për të njëjtën çështje ("Pretendim i Dyfishtë"). Nëse Përfituesi nuk rikthen çdo shumë të tillë, e cila është sipas Pretendimit të Dyfishtë, ai do t'i kthejë Garantuesit një shumë që është e barabartë me tepricën.

8.3 Rikuperimi nga Palët e Treta

8.3.1 Ky paragraf gjen zbatim nëse:

- (d) paratë i lëshohen Përfituesit sipas një Pretendimi;
- (e) në çdo kohë pas marrjes së parave, Përfituesi faktikisht merr çdo shumë e cila nuk do të mund të merrej por nga rrethana prej nga lindi Pretendimi ("Shuma e Palës së Tretë"); dhe
- (f) fatura e Shumës së Palës së Tretë nuk u morr parasysh në llogaritjen e humbjes së të ardhurave, prej nga iu lëshuan paratë Përfituesit.

8.3.2 Nëse ky paragraf gjen zbatim, Përfituesi, brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e Shumës së Palës së Tretë do t'i paguajë Garantuesit një shumë të barabartë me Shumën e Palës së Tretë të marrë nga Përfituesi.

8.4 Njoftimet

8.4.1 Të gjitha njoftimet, kërkesat, ose të tjera komunikime që kërkohen ose që mund të jepen sipas kushteve të kësaj Kontrate, do të bëhen me shkrin, në gjuhën Angleze dhe do të: (i) dërgohen dorazi, (ii) me faks, (iii) me postë (iv) ose me postë rekomande, në adresën e përcaktuar më poshtë:

Garantuesi

Pala për Mbështetjen Teknike

Ministri Genc Ruli
Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikes e Republikës së Shqipërisë
Blvd. Dëshmorët e Kombit, Nr. 2, Tirane – Shqipëri
Fax : +355 4 234 818

Përfituesi

8.4.2

8.4.3 Adresa mund të ndryshohet nga secila nga Palët, Banka e LK-së dhe BNRZH, herë pas here, me anë të një njoftimi me shkrim që i dërgohet secilës nga Palët, Bankës së LK-së dhe BNRZH-së. Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera që mund të kërkohen ose të jepen sipas kushteve të kësaj Kontrate, duhet të jepen dhe të merren në: (i) datën e dorëzimit në rast se dërgohen dorazi ose me postë, (ii) në datën

e dërgimit të faksit, vetëm nëse gjenerimi i konfirmimit të datës së faksit mbahet nga dërguesi dhe i jepet marrësit sipas kërkesës së tij, në rastin e dërgimit me faks, (iii) në datën e nënshkrimit të konfirmimit të marrjes në dorëzim, nëse dërgohet me postë rekomande ose të regjistruar, postë e parapaguar, kthim i faturës së kërkuar.

8.5 Konfidencialiteti

Vetëm nëse parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje ose kërkohet për qëllimin e autorizimit të Garantuesit për të zbatuar detyrimet e tij sipas Marrëveshjes, Palët do të pranojnë të ruajnë konfidencialitetin dhe nuk do të zbulojnë termat dhe afatet specifike të kësaj Kontrate për Periudhën e Garancisë plus dy (2) vjet.

8.6 Heqja Dorë nga Imuniteti i Vendimarrësit

Secila nga palët, Garantuesi dhe Pala e Suportit Teknik përfaqëson dhe garanton se përfshirja e tyre në këtë Marrëveshje dhe përmbushja e detyrimeve të saj janë tregtare me shumë se sa publike ose vendime qeveritare dhe ata nuk kanë të drejtë të pretendojnë imunitet nga seancat ligjore për asetet e tyre në territoret e vendimarrësit ose e thënë ndryshe sipas çdo ligji ose juridiksioni ku mund të ngrihet një padi për zbatimin e detyrimeve që dalin nga kjo Marrëveshje. Për aq sa Garantuesi osë Pala e Suportit Teknik ose ndonjë prej aseteve të tyre mund të kërkojnë të drejtën e imunitetit nga, seancat ligjore, seancave shtesë para gjykimit, të tjera seanca ose zbatimet në territorin e sovranit ose e thënë ndryshe, çdo Garantues dhe Palë e Suportit Teknik, në këtë mënyrë heqin dorë nga të drejtat për imunitet në lidhje me detyrimet që dalin nga ose që lidhen me këtë Marrëveshje.

8.7 Kostot

Secila nga Palët do të paguajë kostot e veta në lidhje me këtë Marrëveshje, që përfshin por që nuk kufizohet me Auditin e Pavarur, rishikimin, pajtimin, kostot dhe tarifat për Garancinë e Rimbursimit. Kostot dhe tarifat që lidhen me arbitrat do t'i faturohen Palës humbëse. Kontrata do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët e kësaj Kontrate. Kjo Marrëveshje nënshkruhet në 6 Maj 2009 në tre (3) ekzemplarë origjinale dhe hartohet në gjuhën Angleze.

ANEKSI 1
KUADRI RREGULLATOR

[Te plotesohet nga CEZ]

ANEKSI 2

INPUTI PËR OSSH DHE FORMULA FPP

Inputi për OSSH dhe formulën FPP përfshijnë:

Për Formulën OSSH

- Përcaktimin e bazës rregullatore të asetit (BRA) për 2009 dhe vitet në vazhdim deri në 2014 siç përcaktohet në Paragrafin 6 të Vendimit Nr. 79 të datës 26 Qershor 2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE dhe në Paragrafin 4.1 të RS.
- Metodologjinë e llogaritjes së mesatares së kostos së ponderuar të kapitalit (MKPK) duke përfshirë trajtimin e tatimit para-fitimit në kapital (ARoE) deri në 31 Dhjetor 2014, siç paraqitet në Paragrafin 4.2 të RS dhe Vendimit Nr. 79 të datës 26 Qershor 2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE.
- Pranimin e kostos së kapitalit prej 16.44% para-tatim deri në 2014 sic paraqiten në Paragrafin 4.2 të RS.
- Kalimin e plotë në tarifën e zbatuar me mënyrën e llogaritjes MPKP të kostos së borxhit të ri (duke përfshirë financimin e aksionarëve) të kërkuar sipas procedurave të specifikuara ashtu sic paraqiten në paragrafin 4.2 të RS.
- Aplikimin prej 60% të raportit të ingranazhit për OSSH sic paraqitet në paragrafin 4.3. të RS.
- Përcaktimin e kostove të operacionit (OPEX) të OSHSH në 2009 dhe vitet në vazhdim deri në 2014, siç paraqitet në paragrafin 5 të Vendimit Nr. 79 të datës 26 Qershor 2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE dhe Paragrafit 4.4 të RS.
- Kërkesa për Kapital Qarkullues për OSSH sic paraqitet në Paragrafin 4.4 të RS.
- Niveli fillestar dhe objektivat e ardhshme për reduktimin e humbjeve OSHSH nga shpërndarja dhe ndryshimet e tyre që mund të rezultojnë nga Humbja dhe Studimet e Audituesit sic paraqiten në Paragrafin 4.5 të RS.
- Kalim i plotë përmes kostos së energjisë për të mbuluar humbjet nga shpërndarja për energjinë e prokuruar në tregun e hapur sipas procedurave të tenderit të aprovuara nga ERE, sic paraqitet në Paragrafin 4.5 të RS.
- Barazimi në zero i faktorit-X baraz për tre periudhat e para rregullatorë dhe njohja nga ERE e çdo fitimi që buron nga reduktimi i kostove operacionale (duke përjashtuar humbjet) siç paraqiten në Paragrafin 4.6 të RS.

Për Formulën e FPP

- Njohja e objektiveve të provigjoneve të borxhit të keq siç mund të rishikohet si rezultat i Studimit të Borxhit të Keq, siç paraqitet në Paragrafin 5.2 të RS.
- Pranimi i marzhit të fitimit të FPP 2.2% për blerjet vjetore të energjisë nga shitja me shumicë e furnitorit publik (WPS) deri në 2014 siç paraqitet në Paragrafin 5.3 të RS.

- Kalim i plotë për kostot e prokurimit të energjisë së WPS-së siç paraqiten ne Paragrafin 5.3 të RS.
- Përshtatja e tarifave për konsumatorët përfundimtar për të kompensuar diferencat ndërmjet parashikimeve dhe të ardhurave aktuale që dalin nga rrethanat e përcaktuara ne Paragrafin 5.3 të RS.
- Mos pretendimi i fitimeve të rritura, përpara interesave dhe tatimeve të OSSH, në lidhje me periudhën që fillon në 1 Janar 2009 dhe mbaron në datën e mbylljes së transaksionit që lidhet me privatizimin e OSSH-së sipas Letrës së Mirëkuptimit të lëshuar nga METE në 9 Mars 2009.

ANEKSI 3

[LOGO E LETRËS SË ČEZ, A. S.]

Për: Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë (“Përfituesi”)

Data: [●], 2009

Të nderuar Zotërinj!

GARANCIA E RIMBURSIMIT (GARANCI E KORPORATËS MËMË)

Të nderuar Zotërinj!

Ne jemi informuar nga shoqëria e kontrolluar prej nesh “Operatori I Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A, një shoqëri e themeluar ne përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, me seli në Rrugë: “Vasil Shanto”, Tiranë, Shqipëri, NIPT K 72410014 H, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Tiranës (Shoqëria), që ju, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e Republikës së Shqipërisë keni nënshkruar një Marrëveshje të Mbështetjes Qeveritare (MMQ) më datë 6 Maj 2009 (Transaksioni)

Duke patur parasysh që ju si Përfituesi palë e Transaksionit me Shoqërinë, ne ČEZ, a.s., një shoqëri aksionere themeluar në përputhje me legjislacionin e Republikës Çeke, me seli në Pragë 4, Duhová 2/1444, Zip Code: 140 53, me Nr. Identifikimi: 452 74 649, regjistruar në Regjistrin Tregtar mbajtur pranë Gjykatës Bashkiake të Pragës, Seksioni B, Dosja 1581 (Garantuesi), me anë të këtij dokumenti marrim përsipër dhe biem dakort siç parashikohet më poshtë:

1. Si mjet sigurimi për çdo dhe të gjitha detyrimet e pagesave sipas Nenit 5 të MMQ në lidhje me Kërkesën për Pagesën më Kusht të Përfituesit (siç përcaktohet në MMQ datë [] (Detyrimet) Garantuesi në mënyrë të pakushtëzuar dhe të pandryshueshme i garanton Përfituesit në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate pagesën e saktë dhe të përpiktë të Detyrimeve për tu paguar dhe premton t'i paguajë Përfituesit të gjitha shumat që duhen paguar dhe nuk janë paguar nga Shoqëria sipas Nenit 5 të MMQ.
2. Kjo Dorëzani do të kufizohet deri në shumën apo shumat që nuk kalojnë në total EUR[●] (deri në: [●] Euros), përfshirë kryegjënë, interesat dhe të gjithë pagesat dhe shpenzimet e tjera.
3. Detyrimi jonë për të bërë pagesën sipas kësaj Garancie do të reduktohet me shumën e cdo pagese që do tu bëhet juve nga ana jonë sipas kësaj kontrate.
4. Ne marrim përsipër të bëjmë pagesat përkatëse, duke patur parasysh që kushtet dhe afatet e kësaj kontrate janë zbatuar, Brenda (15) ditësh pune nga data që ne marrim një kërkesë me shkrim në përputhje me kërkesat e Garancisë. Për qëllim të kësaj Garancie termi “ditë pune” nënkupton një ditë që nuk është

pushim zyrtar dhe në të cilat bankat janë të hapura për aktivitetin e përgjithshëm në Republikën Çeke.

5. Për qëllime të kësaj Garancie:

- a. Dispozitat e Nenit 5 të MMQ në lidhje me pagesat që janë për tu bërë sipas atij Neni, do të zbatohet “mutatis mutandis”, për pagesat që janë për tu bërë sipas kësaj kontrate.
- b. Nëse, pasi ne kemi bërë ndonjë pagesë sipas kësaj kontrate, ne përcaktojmë se (i) çdo deklaratë e përcaktuar në Listën 1, në lidhje me atë pagesë është shkelur, ose (ii) çdo deklaratë bërë nga ju sipas Listës 1 ka qënë jo korrekte ose ka qënë e rreme në çdo kuptim, ju do të na ktheni çdo pagesë të tillë pa vonesa të pajustificuara, pas kërkesës me shkrim nga ana jonë.

6. Kjo Garanci do të jetë e vlefshme më ____ 2009. Asnjë kërkesë sipas kësaj Garancie nuk do të jetë e vlefshme ose do të sjellë ndonjë detyrim për anën tonë përveçse kur ajo është bërë dhe është marrë nga ne, në përputhje me dispozitat e kësaj Garancie më ose përpara ____ 200- ose në ndonjë datë tjetër në të cilën Garancia do të ketë përfunduar në përputhje me kushtet e saj. Pas kësaj kohe kjo Garanci do të pushojë së pasuri fuqi dhe ne nuk do të kemi asnjë detyrim bazuar në të, deri në atë masë që çdo kërkesë që ju do të na dërgoni ne sipas kësaj Garancie përpara datë së skadimit do të jetë e vlefshme dhe deri sat ë gjitha shumat e kërkuara të jenë paguar tërësisht nga ne. Të gjitha këto kërkesa do të jenë me shkrim dhe do të jenë të vlefshme në momentin e marrjes në dorëzim nga ana jonë.

- 7. Vlefshmëria e kësaj Garancie gjithashtu mund të mbarojë në çdo kohë para datës së treguar mbi datën e skadimit, nëse ne do të marrim kopjen origjinale të kësaj Garancie bashkë me deklaratën tuaj me shkrim që ju nuk insistoni për vlefshmëri të mëtejshme të kësaj Garancie.
- 8. Ju do të ktheni kopjen e kësaj Garancie brenda 5 ditëve nga data që detyrimi jonë sa më poshtë nuk është më i vlefshëm, me kushtin që të mos ketë pagesa të pashlyera. Detyrimi jonë sipas kësaj Garancie do të pushojë në datën e mbarimit të saj edhe nëse kopja origjinale e kësaj Garancie nuk na kthehet ne.
- 9. Cdo njoftim ose kërkesë e bërë nga palët më poshtë do të jetë efektiv vetëm në gjuhën Angleze dhe me shkrim dhe që i drejtohet palëve ne adresën e mëposhtme:

Nëse i drejtohet Garantuesit :

ČEZ, a.s.
Departamenti financiar
Duhová 2/1444
140 53 Praha 4
Czech Republic

Në vëmendje të: Drejtorit Ekzekutiv të Financës

Nëse i drejtohet Përfituesit :

Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë



Tirane

Republika e Shqipërisë

Ne vëmendje te: _____

10.

11. Ne çdo kohë, sipas zgjedhjes tonë ne do të kemi alternativën për të zbatuar të gjitha të drejtat që zotërohen nga ne si siguri ose e thënë ndryshe kundrejt Shoqërisë ose të tjerëve.

12. Çdo ndryshim i kushteve të kësaj Garancie do të bëhet me shkrim dhe do të firmoset nga ju dhe nga ne dhe do të pranohet në formë të shkruar nga Shoqëria. Përfitimi i kësaj Garancie mund të mos transferohet tek ndonjë person tjetër.

13. Kjo garanci dhe të gjitha marrëdhëniet ligjore që lidhen me të do të interpretohen dhe drejtohen nga legjislacionin i Republikës Ceke. Vendi i takimit është Praga.

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR kjo Garanci zbatohet rregullisht nga përfaqësuesit e autorizuar të Garantuesit në datën e parë të shkruar më sipër.

Nga: _____

Emri:

Titulli:

Nga: _____

Emri:

Titulli:

Pranuar dhe miratuar nga:

Nga: _____

Emri:

Titulli:

Nga: _____

Emri:

Titulli:

Programi 1

ČEZ, a.s.
Departamenti Financiar
Duhová 2/1444
140 53 Praha 4
Czech Republic

Ne vëmendje te: Drejtorit Ekzekutiv te Financës

[data]

Te nderuar Zotërinj

Kërkesë për pagesën e detyrimit te garancisë

1. I referohemi Garancisë se lëshuar nga ČEZ, a.s. date [●] ("Garancia"). Termat dhe shprehjet e përcaktuara ne Garanci do te kenë te njëjtin kuptim si ne këtë kërkesë.
2. Ne i referohemi Marrëveshjes për Mbështetjen Qeveritare date [●] e lidhur midis Ministrisë se Financave te Republikës se Shqipërisë, Ministrisë se Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës se Republike se Shqipërisë dhe Operatori I Sistemit Te Shpërndarjes SHA ("Kompania").
3. Me anën e kësaj kërkesë ju njoftojmë se Kompani nuk ka arritur te përmbushë Detyrimet dhe për këtë arsye kërkojmë qe ju te na paguani Shumën totale prej EUR [●] (Euro [●]) ne përputhje me afatet e përcaktuara ne Garanci.
4. Ne ju konfirmojmë se (i) te gjitha kushtet dhe kërkesat e nevojshme ne lidhje me MMQ janë përmbushur; (ii) çdo periudhe faljeje për sa i përket asaj ka skaduar; (iii) Kompania nuk ka kontestuar detyrimin e saj; dhe (iv) afatet e MMQ janë te njëjta me ato te datës se Garancisë ose, ne rast se ato nuk janë, çdo amendim i atyre afateve është aprovuar nga ju.
5. Pagesa e kërkuar te derdhet ne llogarinë tone bankare Nr. ([●]) pranë bankës (detajet e plot atë llogarisë bankare net e cilen do te paguhet shuma e kërkuar).

Për llogari te
(Përfituesi)

ANEKSI 4
LETRA E KREDITIT

[Te plotësohet nga Banka]

ANEKSI 5
FORMATI I NJOFTIMEVE

Formati për Njoftimin e Ngjarjes

Për: Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, dhe

Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë

dhe: BNRZH

[Datë]

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes mbi Mbështetjen Qeveritare midis Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes' Sha ("OSSH"), datë 6 Maj 2009, ku Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë vepron si Garantues.

Termat e përcaktuara në këtë format kane të njëjtin kuptim siç janë përdorur në Marrëveshjen Mbështetëse Qeveritare.

Ne po ju paraqesim një Njoftim Ngjarjeje.

Ne po ju bashkëngjisim dokumentacionin e mëposhtëm që evidenton mundësinë e ngjarjes së ardhshme të një Humbjeje:

1. një përmbledhje të fakteve të njohura dhe që kane të bëjnë me rrethanën përkatëse,
2. çdo dokumentacion mbështetës përkatës në lidhje me këtë rrethane,
3. çdo veprim, vendim ose urdhër të lëshuar nga një pale e trete (duke përfshirë Rregullatorin) në lidhje me këtë rrethane,
4. Humbjen e llogaritur e cila mund të shkaktohet si pasoje e ndodhisë së rrethanës përkatëse.

Ne deklarojmë se ky Njoftim Ngjarjeje është bërë brenda tridhjetë (30) ditësh nga data kur ne jemi vene në dijeni për këtë ngjarje.

Ky Njoftim Ngjarje nuk na pengon që ne vazhdim të pretendojmë shumën aktuale të Humbjes.

I juaji sinqerisht,

[Nënshkruesi i autorizuar për OSSH]

Formati për Njoftimin e Pretendimit/ Formati për Njoftimin e Pretendimit Suplementar

Për: Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, dhe

Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë

dhe: BNRZH

[Date]

Te nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes mbi Mbështetjen Qeveritare midis Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe Operatori I Sistemit Te Shpërndarjes' Sha ("OSSH"), date 6 Maj 2009, ku Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë vepron si Garantues.

Termat e përcaktuara në këtë format kanë të njëjtin kuptim siç janë përdorur në Marrëveshjen Mbështetëse Qeveritare

Ne po ngremë një pretendim / pretendim suplementar për dëmshpërblimin e Humbjes/Humbjes shtese si pasojë e Ndarje (s) (ve) të Garantuar: [●].

Ne besojmë se Humbja kap shifrën [●]. Përlllogaritja jone bazohet në llogaritjen e bashkangjitur me poshtë. [Ky pretendim është shtese e Pretendimit të dorëzuar sipas Njoftimit të Pretendimit date [●] dhe ka të bëjë me Humbje shtese]

Ne raportuam rrethanat të cilat ne besojmë se janë bërë një Ndarje e Garantuar në Njoftimin e Ndarjes që ne ju kemi dorëzuar me [●].

Ne po ju bashkëngjisim dokumentacionin e mëposhtëm që evidenton ndodhinë e Ngjarjes së Garantuar:

1. një përmbledhje të fakteve të njohura dhe që kanë të bëjnë me pretendimin, çdo dokumentacion mbështetës përkatës në lidhje me këtë rrethanë ,
2. Njoftimin e Ngjarjes [vetëm në rast se Njoftimi i Pretendimit është dhënë pas Njoftimit të Ngjarjes],
3. përlllogaritje të detajuara të Humbjes.

Ne deklarojmë se ky Njoftim Pretendimi / Njoftim Pretendimi Suplementar është dorëzuar brenda afateve përpara Datës së Pretendimit Përfundimtar të përcaktuar në Marrëveshjen Mbështetëse Qeveritare.

I juaji sinqerisht,

[Nënshkruesi i autorizuar për OSSH]

Format për Njoftimin e Përfituesit mbi Pretendimin e Kontestuar

Për: Bankën,

Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, dhe

Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë

BNRZH

.....[Date]

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes mbi Mbështetjen Qeveritare midis Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës së Republikës së Shqipërisë dhe Operatori i Sistemit Te Shpërndarjes' Sha ("OSSH"), date 6 Maj 2009, ku Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë vepron si Garantues.

Termat e përcaktuara në këtë format kanë të njëjtin kuptim siç janë përdorur në Marrëveshjen Mbështetëse Qeveritare.

Ne lidhje me Njoftimin e Pretendimit date [●] / Njoftimin e Pretendimit Suplementar date [●] të dorëzuar nga OSSH, duke marrë parasysh se Palët nuk arritën ta zgjidhin Pretendimit brenda Periudhës së Pajtitimit, ne po ju paraqesim ekzistencën e Pretendimit të Kontestuar.

Ne po ju dërgojmë një Njoftim Përfituesi mbi Pretendimin e Kontestuar që vjen si pasojë e mosparaqitjes nga ana e Garantuesit të Njoftimit të Garantuesit të Pretendimit të Kontestuar brenda pesë (5) ditësh nga skadimi i Periudhës së Pajtitimit.

I juaji sinqerisht,

[Nënshkruesi i autorizuar për OSSH]

Format për Njoftimin e Garantuesit mbi Pretendimin e Kontestuar

Për: OSSH

dhe: Bankën,

BNRZH

.....[Date]

Te nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes mbi Mbështetjen Qeveritare midis Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës së Republikës së Shqipërisë dhe Operatori i Sistemit Te Shpërndarjes' Sha ("OSSH"), date 6 Maj 2009, ku Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë vepron si Garantues.

Termat e përcaktuara në këtë format kanë të njëjtin kuptim siç janë përdorur në Marrëveshjen Mbështetëse Qeveritare.

Në lidhje me Njoftimin e Pretendimit date [●] / Njoftimin e Pretendimit Suplementar date [●] të dorëzuar nga OSSH, duke marrë parasysh se Palët nuk arritën ta zgjidhin Pretendimit brenda Periudhës së Pajtimit, ne po ju paraqesim ekzistencën e Pretendimit të Kontestuar.

I juaji sinqerisht,

[Nënshkruesi i autorizuar për Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë]

Format për Kërkesën e Përfituesit

Për: Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, dhe

Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë

dhe: BNRZH

..... [Datë]

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes mbi Mbështetjen Qeveritare midis Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës së Republikës së Shqipërisë dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes' Sha ("OSSH"), datë 6 Maj 2009, ku Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë vepron si Garantues.

Termat e përcaktuara në këtë format kanë të njëjtin kuptim siç janë përdorur në Marrëveshjen Mbështetëse Qeveritare.

Garantuesi do të paguaje OSSH shumë prej [●] brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e mësipërme, në rast mospagese Përfituesi mund të drejtojë Kërkesën e Përfituesit pranë Bankës.

Në vijim po ju bashkëngjisim:

1. një kopje të Njoftimit të Pretendimit që i është dërguar Garantuesit, dhe
2. një kopje të Marrëveshjes së Rregullimit.

I juaji sinqerisht,

[Nënshkruesi i autorizuar për OSSH]

Formati për Kërkesën e Pagesës me Kusht të Përfituesit

Për: Bankën

dhe: Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, dhe

Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë

BNRZH

..... [Date]

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes mbi Mbështetjen Qeveritare midis Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës së Republikës së Shqipërisë dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes' Sha ("OSSH"), datë 6 Maj 2009, ku Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë vepron si Garantues.

Termat e përcaktuara në këtë format kanë të njëjtin kuptim siç janë përdorur në Marrëveshjen Mbështetëse Qeveritare.

Sasia e Pretendimit të Kontestuar është [●]. Për këtë arsye i kërkojmë Bankës të na paguaje shumën prej [●].

Ne vijim po ju bashkëngjisim:

1. një kopje të Njoftimit Pretendimit që i është dërguar Garantuesit, dhe
2. një kopje të Raportit të Audituesit të Pavarur (nëse është lëshuar një Raport i Audituesit të Pavarur gjatë Periudhës së Pajtitimit),
3. një kopje të Njoftimit të Garantuesit mbi Pretendimin e Kontestuar (ose Njoftimin e Përfituesit mbi Pretendimin e Kontestuar sipas rastit),
4. një kopje e dorëzimit në kohë të Njoftimit Pretendimit,
5. një Garanci Rimbursimi origjinale në shumën e Pretendimit të Kontestuar.

Ne e dorëzojmë këtë Kërkesë Pageje e Kushtëzuar e Përfituesit pesë (5) ditë pas skadimit të Periudhës së Pajtitimit.

I juaji sinqerisht,

[Nënshkruesi i autorizuar për OSSH]

Format për Kërkesën e Pagesës nga Përfituesi

Për: Bankën

dhe: Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, dhe

Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë

BNRZH

..... [Date]

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes mbi Mbështetjen Qeveritare midis Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës së Republikës së Shqipërisë dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes' Sha ("OSSH"), datë 6 Maj 2009, ku Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë vepron si Garantues.

Termat e përcaktuara në këtë format kanë të njëjtin kuptim siç janë përdorur në Marrëveshjen Mbështetëse Qeveritare.

Në vërtetë se shumë prej [●] do të paguhet brenda afatit të Marrëveshjes Mbështetëse Qeveritare. Për këtë arsye i kërkojmë Bankës të na paguaje shumën prej [●].

Në po ju bashkëngjisim një kopje të vendimit përfundimtar të arbitrazhit mbi Pretendimin e Kontestuar duke parashtruar sasinë që duhet të paguhet.

Në po ju dërgojmë këtë Kërkesë Pagesë të Përfituesit pas mospagimit të shumës nga ana e Garantuesit brenda njëzet (20) ditësh nga data e vendimit përfundimtar.

I juaji sinqerisht,

[Nënshkruesi i autorizuar për OSSH]

Citibank Europe Plc. T +361374-5000
Hungaria Branch Office F +36 1374-5100
H-1051 Budapest, www.citibank.hu
7 Szabadsag ter, Bank Center
Mailing address: P.O. Box 123,
Budapest 1367, Hungari

Operatori i Sistemit te Shperndarjes Sh.A (OSSH)
Rruga: Vasil Shanto
Tirane,
Republika e Shqiperise

Per dijeni: Drejtori i Pergjithshme

Ministria e Financave e Republikes se Shqiperise
Bul: Deshmoret e Kombit, Nr.1
Tirane
Republika e Shqiperise

Per dijeni: Ministri i Financave

I dashur Zoteri,

Letra e Tarifes se Angazhimit dhe Tarifes se Leshimit

Duke iu referuar Marreveshjes se Rimbursimit dhe Kredise ne shumen 60.000.000, Euro ndermjet Citibank Europe, plc, Hungarian Branch Office si banke leshuese (Banka Huadhenese) dhe Ministrise se Financave te Republikes se Shqiperise, qe vepron ne emer te Republikes se Shqiperise (MOF) ne daten ose referuar dates se kesaj letre (Marreveshja e Rimbursimit dhe Kredise) dhe letres se kredise te leshuar nga Banka Huadhenese ne favor te Operatorit te Sistemit te Shperndarjes (OSSH) (Kompania) (Letra e Kredise).

1. Detyrimet paguese te Ministrise se Financave dhe Kompanise ne kete leter jane te perbashketa dhe individuale.
2. Ne baze te marreveshjes te Marreveshjes se Rimbursimit dhe Kredise, keni rene dakort ti paguani Bankes Huadhenese:
 - a) nje tarife angazhimi 1% mbi 60.000.000 Euro, pra 600.000 Euro te pagueshme ne daten, e cila eshte me e hershmja e (i) mbylljes se privatizimit te Kompanise ne perputhje me kushtet e Marreveshjes se Blerjes se Aksioneve te dates 11 Mars 2009 ndermjet CEZ, a.s., dhe Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes te Repulikes se Shqiperise dhe (ii) 29 Maj 2009; dhe
 - b) nje tarife leshimi ne shumen 0.195% mbi 60.000.000 Euro, pra 117.000 Euro te pagueshme:

- (i) ne daten e Letres se Kredise te nenshkruar nga Citibank dhe; discharge
- (ii) pas kesaj, per tu paguar ne çdoperiudhe prej tre muajsh nga data e Letres se Kredise te nenshkruar nga Citibank deri sa detyrimet tona sipas Letres se Kredise te jene permbushur plotesisht ne menyre te pakthyeshme dhe te pakushtezuar, dhe detyrimet e MOF sipas Marreveshjes se Rimbursimit dhe Kredise te jene permbushuar plotesisht ne menyre te pakthyeshme dhe te pakushtezuar.

Per shmangie te ndonje dyshimi, tarifa e angazhimit e referuar ne nen paragrafin e mesiperm (a) eshte e pagueshme pavaresisht nese Data e Leshimit ka ndodhur apo jo.

3. Te gjitha pagesat do te behen nga ana juaj ne llogarine e meposhtme:

Perfituesi: Citibank Europe Plc., Hungaria Branch Office
 SWIFT: CITIGB2L
 Llogaria: Citibanka N.A., London 5513480
 IBAN: GB55CITI 18500805513480

- 4. Te gjitha pagesat te behen nga ana juaj te qarta dhe pa ndonje zbritje per ose ne llogari te ndonje takse, apo ndonje pretendimi.
- 5. Ju do te paguani me perpikmeri sipas kerkeses se Bankes Leshuese, shumen e te gjitha kostove dhe shpenzimeve (duke perfshire tarifat ligjore) deri ne 60,000 Euro te shkaktuara ne menyre te arsyeshme nga ai ne lidhje me negocimin, pergatitjen, printimin dhe firmosjen e Dokumentave Financiar.
- 6. Te gjitha pagesat e shprehura ne kete leter qe jane per tu paguara nga ana juaj do te konsiderohen te perjashtuara nga TVSH-ja. Nese TVSH-ja eshte e ngarkueshme ndaj ndonje oferte te bere nga ne, ne lidhje me kete leter ose ndonje Dokument Financiar, ju do te na paguani (pervec dhe ne te njejten kohe me pagesen e shumes) nje shume te barabarte me shumen e TVSH-se.
- 7. Kjo leter mund te perfundohet ne çdo numer kopjesh, secila prej tyre ka te njejtin efekt sikur nenshkrimet ne kopje te ishin ne nje kopje te vetme te kesaj letre.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë

Hyri në shtyp më 14.5.2009
Doli nga shtypi më 14.5.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADELPRINT
Tiranë, 2009

Çmimi 84 lekë